

AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

Manuali i Mbikëqyrjes për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimin e Terrorizmit

Manuali i Mbikëqyrjes për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimin e Terrorizmit

Tabela e Përmbajtjes

Page

Përmbajtja

1. Hyrje & Historiku	4
1.1 Hyrje	4
1.2 Historiku	5
2. Metodologjia	7
2.1 Pasqyrë e përgjithshme e një Kuadri Inspektimi PPP/FT të fokusuar në Rrezik	7
2.2 Zbutja e Rreziqeve	7
2.3 Cikli i Mbikëqyrjes PPP/FT	10
3. FAZA I: Vlerësimi i Rrezikut, Mbledhja e Informacioneve përpara Inspektimit dhe Analiza	
Paraprake	11
3.1 Mbledhja e Informacioneve para Inspektimit	11
3.2 Kuadri PPP/FT të subjektit	13
3.3 Kuadri i Zbutjes së Rreziqeve të subjektit	13
4. FAZA II: Qëllimi dhe Planifikimi i Inspektimit	14
5. FAZA III: Inspektimi offsite & onsite në terren & Punët në terren	17
5.1 Kuadri dhe Politikat e Përputhshmërisë PPP/FT	18
5.2 Lidhja e vlerësimit të Rrezikut me Kuadrin e Përputhshmërisë PPP/FT	20
5.3 Përgjegjësitë	20
5.4 Punonjësi i pajtueshmërisë PPP/FT	21
5.5 Trajnimi	23
5.6 Kujdesi i duhur dhe dokumentet e nevojshme për identifikimin e konsumatorit	24
5.7 Kategorizimi i Rrezikut në lidhje me konsumatorët/klientët dhe transaksionet	25
5.8 Kujdesi i duhur dhe i zgjeruar	26
5.9 Personat e Ekspozuar Politikisht (Neni 8, paragrafi 1, i Ligjit PPP/FT)	27
5.10 Monitorimi nga Punonjësi PPP/FT/Përputhshmërisë	31
5.11 Raportet e Transaksioneve Para fizike (RTPF-të)	32
5.12 Detyrimi për të ruajtur të dhënat – Mbajtja e Regjistrimeve	32
5.13 Vlerësimi Paraprak	33
5.14 Përgatitja e Konkluzioneve dhe Finalizimi i Inspektimit	33

Manuali i Mbikëqyrjes për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit e Terrorizmit

5.15	Diskutoni Konkluzionet me Inspektorin Përgjegjës dhe Identifikoni Veprimet e Nevojshme	35
5.16	Përgatitja e komenteve për Raportin e Inspektimit PPP/FT	35
6.	FAZA IV: Draft Raportet e Inspektimeve dhe Letra për Drejtuesit	37
6.1	Draft Raporti i Inspektimit	37
6.2	Letra për Drejtuesit	37
7.	FAZA V: Inspektimi i vijueshmërisë.....	38
8.	Ilustrime.....	38
	Ilustrim 1: Dokumentacioni i Inspektimit.....	38
	Ilustrim 2: Qëllimi dhe Planifikimi i Inspektimit.....	39
	Ilustrim 3: Memorandumi i Planifikimit të Inspektimit.....	42
	Ilustrim 4: Matrica e rrezikut PPP/FT të Subjektit	43
	Ilustrim 5: Lista e Plotë e Planifikimit të Inspektimit – Offsite/Onsite Jashtë terrenit/Në terren	46
	Ilustrim 6: Draft-Letra për Drejtuesit	49
	Ilustrim 7: Lista e Plotë e Inspektimit PPP/FT	50
	Ilustrim 8: Shënimet/Gjetjet e Inspektimit	60
	Ilustrim 9: Hartimi i Konkluzioneve & Finalizimi i Shënimeve të Inspektimit	63
	Ilustrim 10: Fjalori i termave	66

Manuali i Mbikëqyrjes për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit

1. Hyrje & Historiku

1.1 Hyrje

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF) u krijua në vitin 2006, si një institucion publik i pavarur, i cili është përgjegjës për rregullimin dhe mbikëqyrjen e sistemit financiar jobankar dhe operatorëve të atij sektori. AMF raporton në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë.

Fushat kryesore të veprimtarisë së AMF-së janë rregullimi dhe mbikëqyrja e:

- Tregut të sigurimeve dhe operatorëve të tij;
- Tregut të titujve dhe operatorëve të tij;
- Tregut të pensioneve vullnetare dhe operatorëve të tij; dhe e
- Veprimtarive të tjera financiare jobankare.

Qëllimet e saj kryesore janë mbrojtja e interesave të konsumatorit, promovimi i qëndrueshmërisë, transparenca dhe besueshmëria në fushat e sigurimeve, titujve dhe pensioneve private vullnetare.

AMF është autoriteti mbikëqyrës për shoqëritë e përfshira në sigurimet ose risigurimet e Jetës, agjentët dhe ndërmjetësit e tyre, në fondet e pensioneve dhe fondet e investimeve. Për të realizuar rolin e saj mbikëqyrës, AMF kryen inspektime periodike në vend për të verifikuar respektimin nga subjektet e sipërpërmendura të detyrimeve të vendosura në dispozitat ligjore dhe raportimin në autoritetin përgjegjës për çdo dyshim, informacion ose të dhënë në lidhje me parandalimin dhe luftën për parandalimin e pastrimit të parave ose parandalimin e financimit të terrorizmit, për veprimtaritë të cilat bien nën juridiksionin e saj.

AMF do të ndërmarrë gjithashtu masat e nevojshme për të parandaluar një person të papërshtatshëm që të kontrollojë dhe të marrë pjesë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë në menaxhimin, administrimin ose funksionimin e një subjekti. Ajo gjithashtu bashkëpunon me Drejtorinë e Përgjithshme për Parandalimin e Pastrimit të Parave ("DPPPP/FTP") dhe siguron asistencë me ekspertë për identifikimin dhe investigimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, në përputhje me Memorandumin e Mirëkuptimit, të datës 8 maj 2015, ndërmjet AMF-së dhe DPPPP/FTP-së, duke përfshirë bashkëpunimin në hartimin dhe shpërndarjen e programeve trajnuese për parandalimin dhe luftën kundër pastrimit të parave e financimit të terrorizmit.

Ligji nr. 9917, datë 19 maj 2008 – "Për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit" (Ligji për Parandalimin e Pastrimit të Parave"), kërkon që institucionet financiare të zhvillojnë disa forma të programit të luftës për parandalimin e pastrimit të parave e financimit të terrorizmit. Objektivat e AMF-së për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit mund të përcaktohen si:

- Ndërtimi i besueshmërisë së publikut në sistemin financiar Shqiptar dhe kapaciteteve të tij për të drejtuar dhe lehtësuar shqetësimet për pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit, si dhe për të mbrojtur reputacionin e sistemit financiar;

Manuali i Mbikëqyrjes për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit

- Garantimi që siguresit dhe bizneset të cilave u shërbejnë janë në dijeni për rrezikun e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit me të cilin ata përballen; dhe
- Garantimi që siguresit veprojnë në përputhje me ligjin për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, si dhe në përputhje me aktet nënligjore në zbatim të këtij Ligji.

1.2 Historiku

Subjektet që mbikëqyren nga Autoriteti me qëllim parandalimin e pastrimit të parave dhe/ose financimit të terrorizmit përcaktohen në nenin 3, gjerat e) dhe ë), të Ligjit nr. 9917, datë 19.05.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, si dhe në nenin 3 të Rregullores 58, datë 30.06.2015, “Mbi masat e vigjilencës së duhur dhe të zgjeruar nga subjektet e ligjit mbi parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, e ndryshuar, të cilët janë:

- Bursat dhe çdo subjekt tjetër (agjent, broker, shoqëri brokerimi, etj.) që ushtron veprimtari për emetimin, këshillimin, ndërmjetësimin, financimin dhe çdo shërbim tjetër që ka lidhje me tregtimin e titujve;
- Shoqëritë që merren me sigurimin e jetës ose risigurimit, agjentët apo ndërmjetësit e tyre, si dhe fondet e pensionit.

Faktorët e rrezikut

Të gjitha subjektet janë të ekspozuara ndaj kërcënimit se mund të shfrytëzohet nga kriminelët në përftim të tyre, me qëllim PP/FT.

Produktet e sigurimeve mund të përdoren për të lehtësuar pastrimin e parave. Për shembull, paraja mund të përdoret për të blerë një ose më shumë polica për sigurimin e jetës, të cilat më pas anulohen me shpejtësi nga mbajtësi i policës (i njohur gjithashtu si “dorëzim i parakohshëm”) kundrejt një penalteti^[1]. Shoqëria e sigurimeve i rimbursen paratë blerësit në formën e çekut. Policat e sigurimit pa vlera monetare ose karakteristika investimesh janë me rrezik më të ulët, por mund të përdoren për të pastruar para ose për të financuar terrorizmin nëpërmjet paraqitjes së dëmeve të zmadhuara ose false nga mbajtësi i policës tek siguresi i tij, të cilat nëse paguhen, do t’i mundësojnë të siguruarit rimarrjen e një pjese ose të të gjitha pagesave të investuara fillimisht.

Mënyrat e tjera ku produktet e sigurimeve mund të përdoren për të pastruar paratë përfshijnë:

- Huamarrjen kundrejt dorëzimit në para fizike të vlerës së policave për sigurimin e përhershëm të Jetës;
- Shitja e kësteve në produkte të lidhura me investime (si pensionet vjetore);

^[1] Pastruesit e parave janë të gatshëm të pranojnë një penaltet për dorëzim të parakohshëm ose “të pastrojnë” paratë që rrjedhin nga fitimet ilegale, d.m.th., paratë e pista.

Manuali i Mbikëqyrjes për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimin e Terrorizmit

- Përdorimin e të ardhurave të sigurimeve nga dorëzimi i parakohshëm i një police, për të blerë asete financiare;
- Blerjen e policave të cilat lejojnë transferimin e interesave të përfituara pa dijeninë dhe miratimin e lëshuesit (p.sh. financimet e dorës së dytë dhe politikat mbartëse të policave të sigurimit);
- Blerjen e produkteve të sigurimeve nëpërmjet metodave të pazakonta, siç janë paratë dhe ekuivalentët e parave;
- Blerjen e produkteve me karakteristika përfundimin e sigurimit pa u shqetësuar për realizimin e investimit të produktit.

Normat e sigurimeve zbatohen vetëm në një gamë të kufizuar të produkteve –“produktet e mbuluara”– mund të përbëjnë një rrezik më të lartë abuzimi nga pastruesit e parave dhe nga financuesit e terrorizmit. Një “produkt i mbuluar” për qëllimet e një programi të përputhshmërisë PPP/FT përfshin:

1. Një policë të përhershme për sigurimin e jetës, e ndryshme nga polica e sigurimit të jetës në grup;
2. Çdo kontratë me anuitete/pagesa vjetore, e ndryshme nga kontrata në grup për anuitete/pagesa vjetore; dhe
3. Çdo produkt tjetër sigurimi me karakteristika të parasë fizike ose të investimit.

Kur një agjenti sigurimesh ose brokeri i duhet të krijojë një program përputhshmërie PPP/FT nën një kërkesë të veçantë bazuar në rregulloren/specifikat/kërkesat PPP/FT (p.sh.kërkesat/kriteret e brokerit ndaj/kundrejt shoqërisë ose letrave me vlerë), shoqëria e sigurimeve përgjithësisht mund “të mbështetet” në programin e përputhshmërisë për të drejtuar çështjet në kohën e shitjes së produktit të mbuluar. Megjithatë, shoqëria mund të ketë nevojë të vendosë politika, procedura dhe procese specifike për shitjet e policave të saja me qëllim që të japë informacion tek shoqëria e sigurimit për përputhshmërinë PPP/FT të siguruesit.

Gjithashtu, në qoftë se një shoqëri ose agjent i shoqërisë, zbulon veprimtari të pazakonta ose të dyshimta në lidhje me shitjet e sigurimeve, ai mund të dorëzojë një RAD të përbashkët mbi veprimtarinë e zakonshme me shoqërinë e sigurimit

Edhe Fondet i Investimeve apo pensionet vullnetare mund të përdoren për të lehtësuar pastrimin e parave apo financimin e terrorizmit si p.sh.: Konsumatori kërkon të riblejë ose shlyej një investim brenda një periudhe të shkurtër pas investimit fillestar ose para datës së pagimit pa një arsyetim të qartë, në veçanti kur kjo rezulton me humbje financiare ose pagesa të tarifave të larta të transaksionit; Krijimi i shpeshtë dhe i papritur i marrëdhënieve të ngjashme të biznesit, pa marrë parasysh vlerësimet ekonomike si p.sh hyrja në disa marrëveshje të anëtarësimit në fondet vullnetare të pensioneve brenda një periudhe të shkurtër kohe (me një ose më shumë shoqëri administrimi) etj.

Raste të tjera, në të cilat vërehen situata të dyshimta, që lidhen me tregun e titujve, janë p.sh. transferimi i fondeve në institucione të tjera financiare ose depozituese, të ndryshme nga ku janë pranuar këto fonde fillimisht dhe veçanërisht kur janë të përfshira shtete të ndryshme; Strukturimi i depozitave të klientit, bëhet në mënyrë të tillë që tërheqje ose blerje të instrumenteve monetare të realizohet nën një sasi të

Manuali i Mbikëqyrjes për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit

caktuar për të shmangur kërkesat e raportimit ose regjistrimit; Klienti përdor llogari personale/individuale për qëllime biznesi; kryhet pagesa për palë të treta me të cilët klienti nuk ka lidhje të dukshme etj.

Tipologjitë e keqpërdorimit në të gjitha subjektet, për të realizuar PP/FT, janë të trajtura me thellësisht në anekset përkatëse, bashkëngjitur Rregullores 58/2015.

2. Metodologjia

2.1 Pasqyrë e Përgjithshme e një Kuadri Inspektimi PPP/FT/FT¹ të Fokusuar në Rrezik

Për të realizuar këto objektiva, AMF ka miratuar një përjasje me bazë rreziku² për mbikëqyrjen e PPP/FT/FT për subjektet e mbikëqyrura. Objektivi i këtij Manuali është që AMF të këtë referencë për trajnimin dhe masat për të siguruar kuadrin e punës të mbikëqyrjes në vend në termat PPP/FT. Ky manual i mbikëqyrjes financiare nuk mund të ofrojë zgjidhje të gatshme, për të gjitha çështjet e përditshme PPP/FT/FT, që hasen në mbikëqyrjen e siguruesve. Përkundrazi, qëllimi i saj është të sigurojë një nivel të përshtatshëm të drejtimit për të ndihmuar në krijimin e përjasjeve/zgjidhjeve praktike në morinë e çështjeve PPP/FT-në, që mund të hasin subjektet e mbikëqyrura.

Ky manual përfshin dhe mbështet plotësisht udhëzimet e dhëna nga AMF “Manuali i Mbikëqyrjes së Fokusuar në Rrezik” (“Manuali i Mbikëqyrjes së Shoqërive të Sigurimit dhe Manuali i Mbikëqyrjes së Fondeve të Pensioneve) dhe i referohet këtij të fundit kur është e nevojshme.³

2.2 Zbutja e Rreziqeve

Për të zvogëluar rreziqet e pastrimit të parave, shoqëria e sigurimeve, shoqëria administruese e fondeve të pensioneve dhe fondeve të investimeve duhet të adoptojë politika, procedura dhe procese të cilat përfshijnë:

- Identifikimin e llogarive me rrezik të lartë;
- Kujdesin e duhur për konsumatorin, duke përfshirë rritjen e kujdesit të duhur për llogaritë me rrezik të lartë;

¹ PPP/FT- shkurtim i shprehjes “Parandalimi i Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit”

² Udhëzuesi për matjen e rrezikut nga Pastrimi i Parave dhe Financimi i Terrorizmit, bashkëngjitur Rregullores nr.58, datë 30.06.2015 “Mbi masat e vigjilencës së duhur dhe të zgjeruar nga subjektet e ligjit mbi parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, e ndryshuar.

³ Manuali i Përgjithshëm i Mbikëqyrjes të AMF-së, synon mbështetjen dhe promovimin e një përjasjeje të përgjithshme ndaj risqeve të shfaqura në industritë që drejton AMF. Për një rishikim të avantazheve dhe çështjeve që lindin nga kjo përjasje ndaj mbikëqyrjes së riskut, referohuni Manualit të Përgjithshëm të Mbikëqyrjes. <http://www.amf.gov.al>

Manuali i Mbikëqyrjes për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimin e Terrorizmit

- Hartimin dhe përdorimin e produktit; llojet e shërbimeve të ofruara; dhe aspektet unike ose rreziqet në tregjet e synuara;
- Kompensimin e punonjësve dhe bonuset, të cilat janë të lidhura me shitjet dhe performancën.
- Monitorimin, duke përfshirë rishikimin e përfundimeve të parakohshme të policave dhe raportimin e transaksioneve të pazakonta e dyshuese (p.sh., një pagesë të madhe, të vetme të primit, blerjen nga një konsumator të një produkti i cili duket se bie jashtë gamës normale të transaksioneve financiare të konsumatorit, garancitë financiare të parakohshme, transaksionet e shumëfishta, pagesat në dukje pa lidhje ndaj palëve të treta dhe kreditë me kolaterale).
- Kriteret për mbajtjen e regjistrave.

Një inspektim PPP i fokusuar në rrezik ndryshon nga përqasja e përgjithshme vetëm për faktin se merr në konsideratë specifikat PPP, sipas lidhjes së tyre me industrinë e sigurimeve, veçanërisht sa më poshtë vijon:

- Arrihet qëllimi i PPP-së, d.m.th. produktet të cilat janë subjekt i Ligjit PPP (referojuni seksionit në “Mjedisi i Shoqërive të Kualifikuara për Inspektimin PPP” më poshtë);
- Rreziku PPP i pandarë për siguresit, si rreziku PPP në mbulimin e produkteve të sigurimit, madhësinë e portofolit, veprimet detyruese të mëparshme, numrin e raporteve për transaksionet monetare (RTD) dhe raportet për aktivitetin e dyshimtë (RAD), etj.; dhe
- Niveli i kuadrit dhe kontroleve PPP të ngritura tashmë nga siguresit. Për një pamje të përgjithshme të kuadrit të punës tipik PPP, shih “Elementet e një Programi PPP” më poshtë.

Subjektet e Kualifikuara për Inspektimin PPP/FT

Si kujtesë, megjithëse Ligji PPP/FT kërkon programe PPP/FT për të gjitha institucionet financiare, Ligji zbatohet vetëm për ato shoqëri sigurimesh të cilat ofrojnë produkte “**të mbuluara**”. Këto produkte përfshijnë: (a) polica të sigurimeve për jetën me çfarëdo lloj vlere të dhënë në para fizike; (b) çfarëdo kontratë pensionesh të përvitshme, të ndryshme nga kontratat për pensionet e përvitshme në grup; dhe (c) çdo produkt tjetër sigurimi me karakteristikat e vlerës së parasë fizike ose të investimeve. Përgjithësisht, sigurimet e jetës dhe të produkteve të pensioneve të përvitshme paraqesin rreziqet më domethënëse për pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit në industrinë e sigurimeve, pasi këto produkte e lejojnë konsumatorin të vendosë shuma të mëdha fondesh në sistemin financiar, me mundësinë për transferimin e këtyre fondeve në një person apo ent tjetër, duke maskuar kështu origjinën e tyre të vërtetë.

Çdo shoqëri sigurimesh që lëshon ose nënshkruan një produkt të mbuluar duhet të zhvillojë dhe zbatojë një program PPP/FT, të hartuar në mënyrë të pranueshme për të parandaluar shoqërinë e sigurimeve që të shfrytëzohet për lehtësimin e pastrimit të parave ose aktivitetet e financimit të terrorizmit. Siguresi duhet të zbatojë një program në të gjithë shoqërinë, d.m.th. një program, i cili nuk zbatohet në produktet e mbuluara nga siguresi.

Elementet e Programit PPP/FT – “Katër Shtyllat”

Manuali i Mbikëqyrjes për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit

Programi PPP/FT, përmban minimalisht elementët që vijojnë, të njohur gjithashtu si “Katër Shtyllat”:

- Politikat, Procedurat dhe Kontrollat e Brendshme – menaxhimi i lartë/Bordi dhe palët e tjera përgjegjëse, duhet t’i komunikojnë në mënyrë të qartë politikat dhe praktikat e veta stafit dhe palëve të treta në mënyrë të vazhdueshme, me qëllim që të zhvillohet një “kulturë” e përputhshmërisë. Politikat dhe procedurat duhet të jenë në përputhje me zhvillimet ligjore dhe industriale.
- Përcaktimi i punonjësit PPP/FT/të Përputhshmërisë ose personave të tjerë përgjegjës – përgjegjës për zbatimin dhe monitorimin e programit të saj PPP/FT, duke përfshirë aktivitetet e bursës si dhe çdo subjekti tjetër që lidhet me tregun e titujve, shoqëritë e sigurimit të jetës ose risigurimit si dhe ndërmjetësit e tyre, dhe fondet e pensionit.. Punonjësi i përputhshmërisë duhet të sigurojë që programi është i përditësuar sipas nevojës dhe që personat përkatës janë arsimuar dhe trajnuar.
- Trajnimi për personat e duhur – duke përfshirë punonjësin e përputhshmërisë. Punonjësit me përgjegjësi sipas programit duhet të trajnohen në përgjithësi me kërkesat e programit dhe të rreziqeve për pastrimin e parave, në mënyrë që të mund të identifikohen “red flags” për aktivitetet e dyshimta të lidhura me produktet e mbuluara. Subjekti që ofron produkte më komplekse, ndoshta do të duhet të ofrojë programe trajnuese më të plota për punonjësit. Subjekti, gjithashtu duhet të sigurojë që agjentët e tyre (si bankat dhe përfaqësuesit ligjorë) janë trajnuar në mënyrën e duhur për rreziqet e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.
- Testimi/auditimi i pavarur – testimi i programeve me bazë periodike për të siguruar që ai përputhet me kërkesat e rregullave dhe rregulloreve të zbatueshme dhe që programi funksionon sipas hartimit të tij duke përfshirë testimin për përcaktimin e përputhshmërisë nga të gjitha subjektet e lartpërmendura. me detyrimin e tyre sipas programit.

Përfshirë këto kritereve minimale, shoqërive të sigurimeve ju është dhënë fleksibiliteti për të hartuar programet e tyre në përputhje me rreziqet specifike të lidhura me biznesin e tyre të veçantë. Programi duhet të jetë me shkrim, i miratuar nga menaxhimi i lartë dhe nga Boardi dhe t’i vihet në dispozicion AMF-së, DPPP/FTP-së ose të emëruarve të tyre, sipas kërkesës.

Programi duhet të përfshijë politikat, procedurat dhe kontrollat e brendshme, bazuar në vlerësimin e rrezikut të subjektit për rreziqet e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, të lidhura me produktet e mbuluara prej saj. Vlerësimi i subjektit mbi informacionet e lidhura me konsumatorin, duke përfshirë metodat e pagesës, është një përbërës kryesor i një programi efektiv PPP/FT. Subjekti, duhet të zbatojë gjithashtu politika dhe procedura të cilat i mundësojnë asaj gjetjen, monitorimin dhe raportimin e aktiviteteve të dyshimta në lidhje me transaksionet e mundshme të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Një shoqëri sigurimesh është gjithashtu përgjegjëse për integrimin e agjentëve dhe brokerave të saj në programin PPP/FT:

1. Të marrë prej tyre informacionin e duhur (domethënës) në lidhje me konsumatorët;

Manuali i Mbikëqyrjes për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit


2. Të përdorë këtë informacion në vlerësimin e rreziqeve të pastrimit të parave të paraqitura nga biznesi i saj;
3. Të identifikojë çdo “red flags” i cili mund të paraqesë aktivitet të dyshimtë.

2.3 Cikli i Mbikëqyrjes PPP/FT

Inspektimet PPP/FT të kryera nga AMF mund të shihen në pamjen e modelit si një “cikël jete”, nëpërmjet të cilit hapat dhe procedurat e ndryshme përsëriten rregullisht, duke gjeneruar në këtë mënyrë performancë të qëndrueshme dhe përmirësime të rezultateve në fund të çdo cikli të ri:

Më poshtë paraqitet cikli i inspektimit të siguruesit, i cili është i njëjtë me ciklin e inspektimit në subjektet e tjera⁴.

Insurer inspection cycle



Description of process steps

- A** • Based on the AML Risk Profile and methodology, define inspection plan
• Communicate plan internally
- B** • Gather information and documents
• Analyze information
• Refine risk profile, update risk matrix
• Plan on-site, Management review and approval of inspection plan
- C** • Perform field work (interviews, sample checks, system review etc.)
• Discuss findings with insurer
- D** • Complete inspection file
• Management review of inspection file
• Draft internal inspection report
• Send Management letter to company
• Reply from company
- E** • Insurer remediates

Cikli i inspektimit të Siguruesit⁵

- A. Plani i Inspektimit & Komunikimi
- B. Përgatitja në vend
- C. Zbatimi në vend
- D. Raportimi
- E. Korrigjimi

⁴ Sipas nenit 3, të Rregullores nr. 58, datë 30.06.2015, “Mbi masat e vigjilencës së duhur dhe të zgjeruar nga subjektet e ligjit mbi parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, e ndryshuar.

Manuali i Mbikëqyrjes për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimin e Terrorizmit

Përshkrimi i hapave të procesit

- A • Bazuar në metodologji dhe në Profilin e Rrezikut PPP/FT, përcaktoni planin e inspektimit
 - Komunikoni planin në nivel të brendshëm
- B • Mblidhni informacione dhe dokumenta
 - Analizoni informacionet
 - Përpunoni profilin e rrezikut, përditësoni matricën e rrezikut
 - Bëni planifikimin në vend, analizën e Menaxhimit dhe miratimin e planit të inspektimit
- C • Realizoni punën në terren (intervista, verifikime mostrash, analizë sistemi, etj.)
 - Diskutoni konkluzionet me Siguruesin
- D • Plotësoni dosjen e inspektimit
 - Analizë Menaxhimi e dosjes së inspektimit
 - Hartoni raportin e brendshëm të inspektimit
 - Dërgoni letrën e Menaxhimit tek shoqëria
 - Përgjigja nga shoqëria
- E • Siguruesi bën korrigjimet

3. FAZA I: Vlerësimi i Rrezikut, Mbledhja e Informacioneve përpara Inspektimit dhe Analiza Paraprake

3.1 Mbledhja e Informacioneve para Inspektimit

Objekti: Mblidhni të gjitha dokumentat dhe informacionet të cilat janë të përshtatshme për vlerësimin e rreziqeve PPP/FT të **subjektit** dhe më pas kryeni një analize paraprake në mënyrë që të përcaktohet qëllimi dhe të planifikohet inspektimi në vend.

Nëpërmjet shkresës për kërkesën e inspektimit paraprak dhe pyetësorit për **subjektin**, merrni dokumentat dhe informacionin e mëposhtëm:

Vlerësimi i Rrezikut PPP/FT të Siguruesit

Objekti: Merret dhe vlerësohet profili i rrezikut PPP/FT të subjektit dhe vlerësohet përshtatshmëria e procesit të vlerësimit të rrezikut PPP/FT të subjektit.

1. Merrni dhe shqyrtoni vlerësimin e rrezikut PPP/FT të subjektit. Përcaktoni nëse subjekti i ka përfshirë të gjitha fushat e rrezikut, duke përfshirë madhësinë, vendndodhjet gjeografike, partnerët/ndërmjetësit/kanalet e shpërndarjes (p.sh. brokerat, bankat, agentët), produktet e reja/ekzistuese, shërbimet ose konsumatorët, entet, aktivitetin ndërkufitar/kompleksitetin, luhatshmërinë bazë të konsumatorëve, Primin e Shkruar Bruto (“PShB”) nga konsumatorët me rrezik të lartë (p.sh. personat e ekspozuar politikisht ose “PEP-të”). Përcaktoni nëse janë të përshtatshme proceset e subjektit për rishikimin periodik dhe përditësimin e vlerësimit të rrezikut PPP/FT.

Manuali i Mbikëqyrjes për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimin e Terrorizmit

2. Në qoftë se subjekti nuk i ka vlerësuar rreziqet e saj PPP/FT, ajo duhet të këshillohet që ta bëjë këtë. Si zëvendësim, Inspektori mund të vlerësojë rreziqet PPP/FT të subjektit duke marrë informacionin e mëposhtëm:
 - Numrin e punonjësve;
 - Vendndodhjet gjeografike;
 - Numrin total të klientëve/konsumatorëve dhe policave⁶, volumin total të të gjithë Primit të Shkruar Bruto të Siguruesit (PShB);
 - Numrin e policave⁷ dhe PShB-në totale për produktet përkatëse (d.m.th., produktet e mbuluara, subjekt i Ligjit PPP/FT);
 - Produktet e reja të futura nga subjekti që nga inspektimi i fundit PPP/FT;
 - Numrin e konsumatorëve të cilët nuk janë rezidentë në Shqipëri, sipas vendeve;
 - Volumin dhe numrin e policave me rrezik/transaksioneve, të ndodhura jashtë Shqipërisë;
 - Tregues për partnerët / ndërmjetësit / kanalet shpërndarëse;
3. Informacion i mëtejshëm i marrë në konsideratë për vlerësimin e rrezikut PPP/FT për subjektin:
 - Konkluzionet (në lidhje me PPP/FT-në) e gjetura nga audituesit e brendshëm dhe të jashtëm që nga inspektimi i fundit PPP/FT nga AMF;
 - Konkluzionet e gjetura nga Drejtoria e Përgjithshme që nga inspektimi i fundit PPP/FT nga AMF;
 - Numrin e raporteve për aktivitetet e dyshimta (RAD) ose raportet e transaksioneve të dyshimta (RTD) të depozituara që nga inspektimi i fundit PPP/FT nga AMF dhe PShB-të e përfshira në këto raste;
 - Numrin e raporteve për transaksionet në para fizike ose RTPF-të (d.m.th. raportet e transaksioneve në para fizike në përputhje me Ligjin PPP/FT) të depozituara që nga inspektimi i fundit PPP/FT nga AMF dhe PShB-të e përfshira në këto raste;
 - Numrin e stafit të Përputhshmërisë, dedikuar PPP/FT-së (me kohë të plotë dhe/ose të pjesshme).
4. Inspektorët duhet të dokumentojnë dhe diskutojnë profilin e rrezikut PPP/FT të subjektit dhe zbutjen e masave të marra, si dhe të gjitha mangësitë e identifikuara në procesin e vlerësimit të rrezikut PPP/FT të subjektit me menaxhimin e subjektit dhe me Punonjësin e Përputhshmërisë/PPP/FT.

⁶ Vetëm për shoqëritë e sigurimit të Jetës

⁷ Vetëm për shoqëritë/agentët e sigurimit të Jetës.

Manuali i Mbikëqyrjes për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimin e Terrorizmit

3.2 Kuadri PPP/FT të Subjektit

Objekti: Mblidhni të gjitha dokumentat dhe informacionet të cilat janë të përshtatshme për vlerësimin e nivelit të kuadrit PPP/FT të subjektit (d.m.th. politikat, procedurat dhe proceset për lehtësimin e rreziqeve PPP/FT të subjektit, shihmë poshtë), realizohet një analizë paraprake në mënyrë që të përcaktohet fushëveprimi dhe planifikimi i inspektimit në vend.

Nëpërmjet shkresës së kërkesës për inspektim paraprak dhe pyetësorit për subjektin, merren dokumentat dhe informacioni i mëposhtëm:

- Politikat dhe Procedurat PPP/FT;
- Përgjegjësitë e Menaxhimit, linjat e biznesit dhe Përputhshmëria;
- Trajnimi i brendshëm PPP/FT, i kryer brenda 12 muajve të fundit;
- Trajnimet e jashtme PPP/FT (p.sh. seminare, konferenca, evente të sponsorizuara për auditorin etj.) të ndjekura brenda 12 muajve të fundit;
- Përshkrimi i kategorive të rrezikut në termat e konsumatorëve dhe transaksioneve. Konsumatorët që paraqesin rrezik më të lartë duhet të përcaktohen në përputhje me Ligjin PPP/FT; subjekti duhet të përcaktojë kategoritë e mëtejshme të rrezikut në përputhje me vlerësimin e rrezikut të tij;
- Lista ose përshkrimi i kontrolleve PPP/FT që kanë të bëjnë me verifikimin e identitetit të konsumatorit dhe me përcaktimin e pronësisë së përfitimeve;
- Lista ose përshkrimi i kontrolleve PPP/FT që kanë të bëjnë me identifikimin e konsumatorëve me rrezik të lartë dhe të transaksioneve me rrezik të lartë (p.sh. monitorimi i transaksioneve);
- Përshkrimi i procesit që ka të bëjë me rritjen e kujdesit të duhur (*Shih*, Neni 7 i Ligjit PPP/FT) d.m.th., thellimi i Njohurive për Konsumatorin Tuaj ("NjKT") (d.m.th. për konsumatorët me rrezik të lartë në përputhje me Nenin 8 të Ligjit PPP/FT dhe transaksionet me rrezik të lartë në përputhje me Nenin 9 të Ligjit PPP/FT) dhe treguesit të informacionit të marrë nga konsumatorët në termat e thellimit të NjKT;
- Lista ose përshkrimi i monitorimit PPP/FT të kryer nga Përputhshmëria;
- Përshkrimi i dokumentacionit dhe mbajtja e regjistrave në termat PPP/FT;
- Përshkrimi i raporteve të brendshme PPP/FT (p.sh. raportet e menaxhimit/Bordit), të lëshuara rregullisht.

3.3 Kuadri i Zbutjes së Rreziqeve të subjektit

Objekti: Mblidhni të gjitha dokumentat dhe informacionet të cilat kanë lidhje me vlerësimin e nivelit të masave të siguruesit (kuadri i punës) të marra për të zbutur rreziqet e pastrimit të parave. Për të zbutur

Manuali i Mbikëqyrjes për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimin e Terrorizmit

rreziqet e pastrimit të parave, subjekti duhet të përshtasë politika, procedura dhe procese të cilat përfshijnë:

- Identifikimin e llogarive me rrezik të lartë;
- Kujdesin e duhur ndaj konsumatorit, duke përfshirë Rritjen e Kujdesit të Duhur për llogaritë me rrezik të lartë;
- Trajnimin e punonjësve;
- Projektimin dhe përdorimin e produktit, llojet e shërbimeve të ofruara dhe aspektet unike të rreziqeve në tregjet e synuara;
- Në vijim të Nenit 6, paragrafi 1 të Ligjit PPP/FT, procedurat që i përkasin rreziqeve për verifikimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit përpara futjes së produkteve të reja;
- Kompensimin e punonjësve dhe rregullimet e bonuseve të cilat janë të lidhura me shitjet dhe performancën;
- Monitorimin, duke përfshirë rishikimin e përfundimeve të parakohshme të policave dhe raportimin e transaksioneve të pazakonta e dyshuese (p.sh. një pagesë të madhe, të vetme të primit, blerjen nga konsumatori të një produkti i cili duket se bie jashtë gamës normale të transaksioneve financiare të konsumatorit, garancitë financiare të parakohshme, transaksionet e shumëfishta, pagesat ndaj palëve të treta në dukje pa lidhje dhe kreditë me kolaterale);
- Kërkesat për mbajtjen e regjistrave.

4. FAZA II: Qëllimi dhe Planifikimi i Inspektimit

Objektivi:

- Identifikimi i rreziqeve PPP/FT të subjektit;
- Zhvillimi i qëllimit të inspektimit; dhe
- Dokumentimi i planit.

Ky proces përfshin përcaktimin e nevojave të stafit inspektues, ekspertizën teknike dhe përzgjedhjen e procedurave të inspektimit që do të kryhet.

Për të lehtësuar procesin e të kuptuarit nga inspektori të profilit të rrezikut të subjektit dhe për të përcaktuar qëllimin e inspektimit PPP/FT, inspektori duhet të përmbushë hapat e mëposhtëm në ndërthurje me rishikimin e vlerësimit të rrezikut PPP/FT të subjektit:

- Të rishikojë raportet e mëparshme të inspektimit, dokumentacionit përkatës dhe reagimit të drejtuesve/ për të gjitha çështjet e identifikuar më parë me AMF-në ose me Drejtorinë e Përgjithshme të PPP/FT; të identifikojë procedurat e përfunduara të inspektimit; të marrë

Manuali i Mbikëqyrjes për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimin e Terrorizmit

informacionin e kontaktit; të identifikojë raportet dhe proceset që subjekti përdor për të zbuluar aktivitetin e pazakontë dhe; të identifikojë operacionet e subjektit të cilat më përpara janë cilësuar me rrezik të lartë. Në vazhdim, të kontaktojë Përgjegjësin e Përputhshmërisë dhe/ose Menaxhimit sipas rastit, për të diskutuar si vijon:

- Vlerësimin e rrezikut PPP/FT;
- Programin e përputhshmërisë PPP/FT;
- Ndryshimet në politikat, procedurat dhe kontrollet PPP/FT të subjektit;
- Vazhdimin e çështjeve të identifikuara më përpara nga AMF dhe/ose Drejtoria e Përgjithshme e PPP/FT;
- Ndryshimet në panoramën e produktit të siguruesit dhe shifrat në lidhje me konsumatorët, PShB, konsumatorët/klientët me rrezik të lartë, etj.;
- Monitorimin e aktivitetit të dyshimtë dhe sistemet e raportimit; dhe
- Nivelin dhe shtrirjen e sistemeve të automatizuara PPP/FT.

Për temat e mësipërme, për udhëzime referojuni përmbledhjes së duhur dhe seksioneve të procedurave të inspektimit në Manual.

- Të hartojë një listë të zërave PPP/FT që do të përfshihen në shkresën e kërkesës për inspektim të integruar. Në qoftë se pjesa PPP/FT e inspektimit është një inspektim i veçuar, të dërgojë shkresën e kërkesës te Punonjësi i Përputhshmërisë ose te Punonjësi i caktuar i subjektit Të rishikojë dokumentat e shkresës së kërkesës të dhëna nga subjekti. *Referojuni "Zërave të Shkresës së Menaxhimit" në Seksionin e Fazës IV, faqe 33.*
- Të rishikojë korrespondencën ndërmjet subjektit dhe AMF-së, nëse nuk është tashmë e kompletuar nga inspektori në detyrë ose nga personeli tjetër i caktuar. Në vazhdim, të rishikojë korrespondencën që subjekti ka marrë nga ose ka dërguar në agjencitë e tjera rregullatore dhe të zbatimit të ligjit në lidhje me përputhshmërinë PPP/FT. Komunikimet, në veçanti ato që janë marrë nga Drejtoria e Përgjithshme e PPP/FT mund të dokumentojnë çështje në lidhje me inspektimin, si vijon:
 - Depozitimin e gabimeve për RAD dhe RTD e marra në formë elektronike nga Drejtoria e Përgjithshme e PPP/FT ;
 - Gjobat e vëna ose që janë në proces nga Drejtoria e Përgjithshme e PPP/FT;
 - Fletëthirrjet për proceset në zbatim të ligjit ose sekuestrimet.
- Të rishikojë informacionin për RAD dhe RTD të marrë nga baza e të dhënave të raportimit PPP/FT brenda AMF-së. Të kërkojë të dhënat përkatëse nga Drejtoria e Përgjithshme e PPP/FT, nëse është e mundur. Numri i RAD dhe RTD të depozituara duhet të merret për një periudhë kohore të

Manuali i Mbikëqyrjes për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimin e Terrorizmit

caktuar, siç përcaktohet nga inspektori. Të marrë në konsideratë informacionin në vijim dhe të analizojë të dhënat për strukturat jo të zakonshme:

- Volumi i aktivitetit dhe nëse ai është i përpjesëtueshëm me profesionin e konsumatorit ose llojin e biznesit;
- Numri dhe vëllimi i transaksioneve në dollarë, që përfshin konsumatorët me rrezik të lartë;
- Volumi i RAD-eve dhe RTD-eve në lidhje me përmasat e subjektit, asetet ose rritjen e depozitave dhe vendndodhjen gjeografike.

Inspektorët nuk duhet t'i tërheqin vëmendjen një subjekti vetëm se numri i RAD-eve dhe RTD-eve të depozituara është më i vogël se RAD-et ose RTD-et e depozituara nga subjektet “e të njëjtit lloj”. Por, si pjesë e inspektimit, inspektorët duhet të rishikojnë ndryshimet e rëndësishme në volumin e natyrës së RAD-eve dhe RTD-eve të depozituara dhe të vlerësojnë arsyet e mundshme për këto ndryshime.

- Të rishikojë raportet e auditit të brendshëm e të jashtëm dhe dokumentacionin për përputhshmërinë PPP/FT, sipas nevojës, për të përcaktuar gjithëpërfshirjen dhe cilësinë e auditimeve, konkluzionet, reagimet e menaxhimit dhe veprimet korrigjuese. Një rishikim i qëllimit të pavarur të auditimit, procedurave dhe kualifikimeve do të japë informacion të vlefshëm për përshtatshmërinë e programit të përputhshmërisë PPP/FT.
- Sanksionet: Ndërkohë që sanksionet rregulluese nuk janë pjesë e vlerësimit PPP/FT, përputhshmëria me sanksionet e zbatueshme përfshihet shpesh në inspektimet PPP/FT. **Shënim:** Shqipëria përgjithësisht ndjek programin e sanksioneve të Kombeve të Bashkuara. Ndërkohë që identifikimi i shkeljeve të sanksioneve nuk është roli kryesor i AMF-së, AMF do të vlerësojë mjaftueshmërinë e një subjekti për zbatimin e politikave, procedurave dhe proceseve për të siguruar përputhshmërinë me ligjet dhe rregulloret Shqiptare dhe të OKB-së për sanksionet.⁸ Për të thjeshtuar kuptueshmërinë e inspektorit për profilin e rrezikut të subjektit dhe për të vendosur në mënyrë të përshtatshme qëllimin e inspektimit të sanksioneve, inspektori duhet të kryejë hapat në vijim:
 - Të rishikojë vlerësimin e rrezikut për sanksionet e subjektit. Vlerësimi i rrezikut, i cili mund të jetë i inkorporuar në vlerësimin e përgjithshëm të rrezikut PPP/FT, duhet të marrë në konsideratë llojet e ndryshme të produkteve, shërbimeve, konsumatorëve, enteve, transaksioneve dhe vendndodhjeve gjeografike në të cilat subjekti është angazhuar, duke përfshirë ato që janë përpunuar nga, nëpërmjet ose në subjekt për të identifikuar ekspozimin e mundshëm ndaj sanksioneve;
 - Të rishikojë testimin e pavarur të subjektit për programin e përputhshmërisë së saj me sanksionet;

⁸ Kjo do të bëhet si pjesë e vlerësimit të AMF-së për njohjen e konsumatorëve të shoqërisë tuaj dhe të procedurave të duhura.

Manuali i Mbikëqyrjes për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimin e Terrorizmit

- Të rishikojë korrespondencën e marrë në lidhje me përputhshmërinë me sanksionet dhe sipas nevojës, fushën e penalteteve civile në faqen zyrtare në internet për sanksionet e OKB-së. http://ëëë.un.org/sc/committees/list_compens.shtml për të përcaktuar nëse subjekti ka shkresa paralajmëruese, gjopa ose penaltete të vendosura nga sanksionet që nga inspektimi më i fundit⁹.

Shënim: Në vazhdim të sa më sipër, në subjektet më komplekse, më të mëdha, inspektorët mund të realizojnë lloje të ndryshme inspektimesh nëpërmjet planit të mbikëqyrjes ose ciklit për vlerësimin e sanksioneve të përputhshmërisë. Këto rishikime mund të fokusohen në një ose më shumë linja biznesesh.

Në bazë të procedurave të mësipërme të inspektimit dhe në lidhje me rishikimin e vlerësimit të rrezikut PPP/FT të subjektit, zhvillohet një plan fillestar inspektimi. Inspektori duhet të dokumentojë planin në mënyrën e duhur, si dhe të gjitha ndryshimet e planit që kanë ndodhur gjatë inspektimit. Fushëveprimi dhe procesi i planifikimit duhet të sigurojë që inspektori ka dijeni për programin e përputhshmërisë PPP/FT të subjektit, programin e përputhshmërisë me sanksionet, historikun e përputhshmërisë dhe profilin e rrezikut (d.m.th. produktet, shërbimet, konsumatorët, entet, transaksionet dhe vendndodhjet gjeografike).

Sipas nevojës, mund të realizohen procedura kryesore shtesë dhe inspektim i zgjeruar. Ndërkohë që plani i inspektimit mund të ndryshojë në çdo kohë si rezultat i gjetjeve në vend, vlerësimi fillestar i rrezikut do t'i mundësojë inspektorit të krijojë një ide të pranueshme për rishikimin PPP/FT. Në mënyrë që të kryhet procesi i inspektimit, inspektorët duhet të mbajnë komunikim të hapur me menaxhimin e subjektit dhe të diskutojnë shqetësimet përkatëse siç mund të krijohen.

5. FAZA III: Inspektimi offsite & onsite në terren & Punët në terren

AMF do të zhvillojë inspektimin e plotë PPP/FT. Inspektimi PPP/FT i një siguruesi që lëshon produkte të mbuluara duhet të përfshijë procedurat e mëposhtme për të drejtuar përputhshmërinë për parandalimin e pastrimit të parave.

Objekti i punës në terren është vlerësimi i:

1. Mjaftueshmërisë së kuadrit të punës të subjektit për përputhshmërinë PPP/FT;
2. Mjaftueshmërisë së përgjithshme dhe efektshmërisë së përputhshmërisë së programit PPP/FT, duke përfshirë politikën, procedurat dhe proceset. Në mënyrë tipike, ky vlerësim do të përfshijë

⁹Sanksionet e Kombeve të Bashkuara nuk zbatohen direkt në sistemin tonë të brendshëm, por Këshilli i Ministrave mund të vendosë që t'i bëjë ato të detyrueshme. Gjatë periudhës nga hartimi deri në miratimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave, Ministri i Financave mund të japë urdhëra bllokues. Për më shumë detaje, referohuni Ligjit nr. 157/2013 "Për masat kundër financimit të terrorizmit"

Faqja zyrtare në internet e sanksioneve të OFAC-së: http://ëëë.treasury.gov/resource-center/sanctions/SDN-List/Pages/fuzzy_logic.aspx

Manuali i Mbikëqyrjes për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimin e Terrorizmit

një deklaratë të qartë për mjaftueshmërinë e përgjithshme të përputhshmërisë së programit PPP/FT, efektshmërinë dhe përputhshmërinë me kërkesat rregullatore të zbatueshme;

3. Nëse një vlerësim i rrezikut PPP/FT ka qenë i krijuar në mënyrën e duhur;
4. Nëse është realizuar siç duhet raportimi PPP/FT;
5. Nëse janë zbatuar kriteret për mbajtjen e regjistrave;
6. Përshtatshmërinë e politikave procedurave dhe proceseve dhe nëse ato përputhen me Ligjin PPP/FT dhe kërkesat e brendshme;
7. Nëse personeli i përmbahet politikave, procedurave dhe proceseve PPP/FT të subjektit;
8. Nëse është realizuar testimi (monitorimi) i duhur i transaksioneve, me rëndësi të veçantë në operacionet me rrezik të lartë (produktet e mbuluara, shërbimet, konsumatorët dhe vendndodhjet gjeografike);
9. Nëse subjekti po kryen trajnim PPP/FT për personelin e duhur dhe janë në zbatim procedurat për të siguruar që palët e treta përkatëse (brokerat, agjentët dhe bankat) janë trajnuar, duke përfshirë gjithëpërfshirjen e tyre, saktësinë e materialeve, programin e trajnimit dhe ndjekjen e frekuentimit. Subjekti duhet të ketë regjistra për të verifikuar që trajnimi PPP/FT është kryer dhe që punonjësit e kanë përfunduar trajnimin;
10. Integritetin dhe saktësinë e Sistemeve të Menaxhimit të Informacionit (SMI) të përdorur për programin e përputhshmërisë PPP/FT. SMI përfshin raportet e përdorura për të identifikuar transaksionet e mëdha monetare, transaksionet e dyshimta, transaksionet monetare ditore të bashkuara, transaksione për transfertat e fondeve dhe raporte analitike dhe të tendencës; dhe
11. Ndjekjen e çështjeve dhe mangësive të identifikuara më përpara dhe verifikimi nëse menaxhimi i ka korrigjuar ato.

Në qoftë se për të identifikuar ose mbledhur transaksionet e mëdha nuk është përdorur një sistem i automatizuar, përcaktohet nëse auditimi apo rishikimi i pavarur përfshin një test të thjeshtë kontrolli të dokumentacionit përkatës për të përcaktuar nëse transaksionet e dyshimta ose të pazakonta janë identifikuar dhe raportuar saktësisht.

5.1 Kuadri dhe Politikat e Përputhshmërisë PPP/FT

Objekti: Të vlerësohet përshtatshmëria e kuadrit të punës të subjektit me përputhshmërinë PPP/FT. Të përcaktohet nëse subjekti ka zhvilluar, administruar dhe mbajtur një kuadër pune efektiv për përputhshmërinë PPP/FT dhe me të gjitha rregulloret në zbatim të tij.

Procedura e Inspektimit

Inspektimi PPP/FT i një siguruesi që lëshon produkte të mbuluara duhet të përfshijë procedurat në vijim për t'u drejtuar për parandalimin e pastrimit të parave:

Manuali i Mbikëqyrjes për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimin e Terrorizmit

1. Zhvillimin e një interviste të shkurtër me punonjës të Përputhshmërisë ose me ndonjë person tjetër, të përgjegjshëm për zbatimin dhe monitorimin e përputhshmërisë me programin PPP/FT të subjektit. Në qoftë se Punonjësi i Përputhshmërisë i delegon disa përgjegjësi te punonjësit e tjerë, është e përshtatshme që të zhvillohen gjithashtu intervista me ta. *(Shih faqe 19, Punonjësi i Përputhshmërisë PPP/FT)*;
2. Marrjen e një kopje të programit të shkruar PPP/FT dhe verifikimin nëse ajo përfshin përbërësit e nevojshëm të diskutuar më sipër. Gjithashtu verifikohet nëse programin e kanë miratuar edhe Bordi i Mbikëqyrjes edhe menaxhimi i lartë;
3. Merret një kopje e vlerësimit të rrezikut të subjektit, planet e testimeve të pavarura dhe rezultatet e testimeve të kryera; rishikohen të gjitha çështjet e rëndësishme. Menaxhimi nxitet që të dokumentojë me shkrim vlerësimin e tij për rrezikun, me qëllim që të japë një bazë të qartë për politikën dhe procedurat e subjektit. Inspektorët duhet të marrin në konsideratë nëse është i përshtatshëm procesi i vlerësimit i rishikimit dhe përditësimit periodik të rrezikut të saj;
4. Programi PPP/FT i subjektit duhet të jetë në përpjesëtim të drejtë me rreziqet që paraqiten nga madhësia e subjektit, nga natyra dhe volumi i produkteve të mbuluara që ajo ofron dhe nga kanalet e shpërndarjes që ajo përdor për të tregtuar produktet e mbuluara. Në vlerësimin e rrezikut të saj, çdo subjekt duhet të identifikojë dhe vlerësojë rreziqet për pastrimin e parave të cilat mund të lidhen me kategoritë e rrezikut të saj (d.m.th. kombinimi unik i produkteve të mbuluara, shërbimeve, konsumatorëve dhe vendndodhjeve gjeografike të tyre, kanalet e shpërndarjes, kontrollet e brendshme, etj.). Subjekti duhet të bëjë një analizë më të detajuar të këtyre kategorive ashtu si zbatohen ato nga subjekti me qëllim që të vlerësohet rreziku sipas e çdo kategorie të tij;
5. Inspektori duhet të rishikojë vlerësimin e rrezikut për përgjithshmërinë, për të përcaktuar nëse menaxhimi ka marrë në konsideratë dhe ka vlerësuar në mënyrën e duhur të gjitha kategoritë përkatëse të rrezikut. Për shpeshtësinë e testimit të pavarur në vlerësimin e rrezikut duhet të përfshihet baza logjike;
6. Testimi i Pavarur: Një konsulent ose kontabilist i jashtëm mund të ketë qenë i caktuar ose mund të caktohet për të realizuar testimin e kuadrit të punës PPP/FT të subjektit. Qëllimi kryesor i testimit të pavarur zakonisht është përcaktimi i mjaftueshmërisë së programit PPP/FT të subjektit, duke përfshirë nëse ajo operon në përputhje me kërkesat e Ligjit PPP/FT dhe me politikën e procedurat e vetë subjektit. Fusha dhe cilësia e rishikimit/eve të pavarur/a mund të ndikojë në efektshmërinë e programit PPP/FT të subjektit.

Rishikimi i politikës së shkruar e të miratuar të përputhshmërisë PPP/FT të menaxhimi/bordit të subjektit, për të siguruar që ajo përmban elementet e kërkuara, më poshtë¹⁰:

¹⁰ Krahasoni edhe me Nenin 11, paragrafi 1/a të Ligjit PPP

Manuali i Mbikëqyrjes për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimin e Terrorizmit

- “Rëndësia në krye”, d.m.th. deklarata e politikës së përgjithshme nga menaxhimi i lartë dhe nga Bordi për parimet e subjektit në luftën për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;
- Përkufizimi i përgjegjësive (p.sh. Bordi Mbikëqyrës, Drejtori, Punonjësi i Përputhshmërisë PPP/FT kur është person i caktuar posaçërisht ose personave përgjegjës për menaxhimin e përputhshmërisë PPP/FT).
- Sistemi i procedurave dhe kontrolleve të brendshme, për të siguruar në vijimësi përputhshmërinë PPP/FT, veçanërisht në lidhje me:
 - Nenet 4 – 5: Kujdes i Duhur dhe dokumentacioni i nevojshëm për identifikimin e konsumatorit;
 - Nenet 8 – 9: Kategorizimi i rrezikut në lidhje me konsumatorët dhe transaksionet;
 - Nenin 7: Kujdes i duhur në rritje;
 - Monitorim nga Punonjësi i Përputhshmërisë PPP/FT;
 - Nenet 12 – 15: Detyrimet për Raportimin;
 - Nenin 16: Detyrimi për mbajtjen e të dhënave.
- Trajnimi dhe arsimimi periodik për personelin përkatës;
- Raportimi i duhur PPP/FT tek Bordi Mbikëqyrës ose te menaxhimi i lartë.

5.2 Lidhja e vlerësimit të Rrezikut me Kuadrin e Përputhshmërisë PPP/FT

Krahas detyrimit për zbatimin e politikave, Neni 6 i Ligjit PPP/FT parashikon gjithashtu se siguresit duhet të përfshijnë në pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit rreziqet që lindin nga zhvillimi i produkteve të reja, praktikat e biznesit, kanalet e dorëzimit dhe përdorimi i teknologjive të reja ose në zhvillim. Në bazë të procedurave të inspektimit, të realizuara në procesin e planifikimit dhe të fushëveprimit duke përfshirë rishikimin e vlerësimit të rrezikut, përcaktohet nëse subjekti ka identifikuar në mënyrë të përshtatshme rrezikun brenda operacioneve të shoqëruara me shoqërinë (produktet, shërbimet, konsumatorët, entet dhe vendndodhjet gjeografike) dhe e ka përfshirë rrezikun në programin e përputhshmërisë PPP/FT.

5.3 Përgjegjësitë

Politika e brendshme PPP/FT duhet të vendosë qartë përgjegjësitë e funksioneve përkatëse, veçanërisht në lidhje me:

- Bordin Mbikëqyrës ose menaxhimin e lartë, që ka në mënyrë tipike përgjegjësinë përfundimtare në terma PPP/FT-së, duke përfshirë, për shembull:
 - Të sigurojë që politika është zbatuar dhe komunikuar;

Manuali i Mbikëqyrjes për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimin e Terrorizmit

- Të emërojë një Punonjës të Përgjithshëm ose të Përputhshmërisë PPP/FT, në varësi të madhësisë së subjektit dhe rrezikut;
 - Të bëjë të disponueshme burimet për të siguruar përputhshmërinë me Ligjin PPP/FT dhe Politikën PPP/FT;
 - Të sigurojë që menaxhimi dhe punonjësit janë të arsimuar/trajnuar siç duhet;
 - Të marrë masat e duhura në rastet e mospërputhshmërisë me kriteret e Ligjit PPP/FT dhe të Politikës PPP/FT;
 - Të jetë dakord me përjashtimet për Politikën PPP/FT.
- Funksionet e biznesit (siç janë nënshkrimi, administrimi i konsumatorit, dëmet/dorëzimet), në mënyrë tipike kanë përgjegjësinë e kryerjes së kontrolleve PPP/FT në vijën e parë të mbrojtjes, veçanërisht në lidhje me:
 - Identifikimin dhe verifikimin e konsumatorit për zotërimin e përfitimeve;
 - Identifikimin e konsumatorëve dhe të transaksioneve me rreziqe të rritura;
 - Kujdesin e duhur në rritje; dhe
 - Kërkesat e dokumentacionit.
 - Funkzioni i Përputhshmërisë PPP/FT (Punonjësi i Përputhshmërisë PPP/FT), në mënyrë tipike ka përgjegjësi të:
 - Mbështesë biznesin dhe menaxhimin në zbatimin e Politikës PPP/FT dhe të proceseve e kontrolleve përkatëse;
 - Identifikojë ligjet dhe rregulloret konfliktuale/kontradiktore të mundshme;
 - Fillojë vlerësimin periodik të rrezikut të shoqërisë;
 - Japë këshilla, udhëzime dhe trajnime për funksionet e biznesit, për hartimin dhe zbatimin e kontrolleve PPP/FT;
 - Monitorojë përputhshmërinë me dispozitat e Politikës PPP/FT;
 - Raportoje transaksionet përkatëse në para fizike si dhe rastet e dyshimta në përputhje me Nenin 12 të Ligjit PPP/FT.
 - Auditi i brendshëm ka përgjegjësinë e bërjes së testimeve të pavarura dhe të vlerësimit të hartimit, zbatimit dhe kryerjes nga shoqëria të vlerësimit të rrezikut PPP/FT, kuadrit të punës, kontrolleve, monitorimit dhe raportimit.

5.4 Punonjësi i pajtueshmërisë PPP/FT

Objektivi: Të vlerësohet nëse funksioni i Punonjësit të Përputhshmërisë/PPP/FT është përcaktuar qartë

Manuali i Mbikëqyrjes për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimin e Terrorizmit

dhe detyrat janë kryer në mënyrën e duhur.

Procedura e Inspektimit

1. Zhvillohet një intervistë e shkurtër me **punonjës**in e përputhshmërisë, përgjegjës për përputhshmërinë e zbatimit dhe monitorimit të programit PPP/FT të subjektit . Në qoftë se punonjësi i përputhshmërisë delegon përgjegjësi të caktuara tek punonjësit e tjerë, mund të jetë e përshtatshme gjithashtu të zhvillohet intervistë me ta. Temat e intervistës duhet të përfshijnë sa vijon, por pa u kufizuar vetëm tek ato:
 - Vështrimi i përgjithshëm çdo ditë, i përputhshmërisë me kriteret PPP/FT;
 - Përmbajtja e programit PPP/FT të subjektit , vlerësimi i rrezikut , i programit të trajnimit dhe planet e testimit të pavarur; dhe
 - Si e monitoron dhe kontrollon subjekti aktivitetin e agjentëve/punonjësve të saj.
2. Inspektimi duhet të mbulojë gjithashtu rolin e Punonjësit të Përputhshmërisë PPP/FT në lidhje me zbulimin, monitorimin dhe raportimin e aktivitetit të dyshimtë. Kjo përfshin politikat vendimmarrëse të subjektit për raportimin e aktivitetit të dyshimtë kur identifikohen “red flags”.
3. Përfundimisht, inspektori duhet të sigurojë që subjekti zbaton procedura për të raportuar transaksionet në para fizike në shumën e përcaktuar në dispozitat e Ligjit PPP/FT.

Faktorë të tjerë për t’u rishikuar:

1. Përcaktohet nëse bordi i drejtorëve ka emëruar një person ose persona të përgjegjshëm për programin e përgjithshëm të përputhshmërisë PPP/FT. Përcaktohet nëse zyrtari i përputhshmërisë ka autoritetin dhe burimet për të realizuar me efektivitet të gjitha detyrat;
2. Vlerësohet kompetenca e zyrtarit të përputhshmërisë dhe të stafit të tij/saj, sipas nevojës.¹¹ Përcaktohet nëse zona e përputhshmërisë PPP/FT është me staf të mjaftueshëm për nivelin e përgjithshëm të rrezikut të subjektit (bazuar në produktet, shërbimet, konsumatorët, entet dhe vendndodhjet gjeografike), madhësinë dhe nevojat e përputhshmërisë PPP/FT. Në vazhdim, sigurohet që nuk ka konflikt interesash dhe që stafit i është dhënë koha e mjaftueshme për të kryer të gjitha detyrat;
3. Gjatë intervistës, inspektori duhet të ketë parasysh nëse punonjësi: (a) nuk është mjaftueshëm i sigurtë, (b) ka dhënë informacion të rremë ose të gabuar, (c) duket se i mungojnë njohuritë për rreziqet e subjektit ndaj aktiviteteve të pastrimit të parave ose (d) ka lënë jashtë informacion, material përkatës për parandalimin e pastrimit të parave, i cili duhet t’i ishte bërë i ditur Drejtorisë së Përgjithshme për vlerësime të mëtejshme.

¹¹ Faktorët e kompetencës përfshijnë: eksperiencë, trajnim (arsimim, kurse etj...). Rishikoni CV-në e Punonjësit të Përputhshmërisë PPP dhe vlerësoni nëse individit ka eksperiencë të mjaftueshme dhe formim arsimor në përputhje me kërkesat e funksionit.

Manuali i Mbikëqyrjes për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit

5.5 Trajnimi

Objekti: Përcaktimi nëse elementet e rëndësishëm të një programi trajnues PPP/FT janë drejtuar në mënyrë të përshtatshme në programin dhe në materialet e trajnimit dhe nëse trajnimi është realizuar dhe dokumentuar dhe nëse është ndjekur mospjesëmarrja.

Vërejtje paraprake

Elementet tipikë, në vijim përfshihen në një program trajnues PPP/FT:

1. Rëndësia e rolit të Bordit Mbikëqyrës dhe e menaxhimit të lartë në zhvillimin e arsimit, trajnimit dhe përputhshmërisë;
2. Llogaridhënia e punonjësve për të siguruar përputhshmërinë PPP/FT;
3. Gjithëpërfshirja e trajnimit, duke marrë në konsideratë rreziqet specifike të linjave individuale të biznesit;
4. Trajnimi i stafit nga të gjitha fushat e zbatueshme të subjektit;
5. Përcaktimi i frekuencës së nevojshme të pjesëmarrjes në trajnimin PPP/FT;
6. Dokumentacioni për të verifikuar regjistrimin e pjesëmarrjes dhe materialet e trajnimit;
7. Trajnimi në vazhdimësi;
8. Mbulimi i politikave të subjektit, procedurave, proceseve dhe rregullave e rregulloreve të reja;
9. Mbulimi i formave të ndryshme të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit sipas lidhjes së tij me identifikimin dhe shembujt e aktivitetit të dyshimtë;
10. Penalitetet për mospërputhshmërinë me politikën e brendshme dhe kërkesat rregullatore.¹²

Të gjithë punonjësit duhet të ndjekin të paktën trajnimin bazë PPP/FT, me qëllim që të kuptojnë parimet PPP/FT, legjislacionin PPP/FT dhe politikën e brendshme PPP/FT, si dhe kujt duhet t'ia drejtojnë pyetjet dhe çështjet. Funksionet e ekspozuara duhet të ndjekin një trajnim të plotë/të zgjeruar PPP/FT, në mënyrë që të kuptojnë përgjegjësitë dhe përmbytjen e kontroleve dhe procedurave PPP/FT. Në mënyrë tipike, trajnimi PPP/FT përfundon me një testim të përcaktuar në mënyrën e duhur për t'u realizuar me sukses nga pjesëmarrësit (d.m.th., nga pjesëmarrësi duhet të merret një notë kaluese ose testimi duhet të jepet përsëri).

Pjesëmarrja në trajnimin PPP/FT në përfundim të testimit duhet të regjistrohet, në mënyrë që të identifikohet nëse ndonjë punonjës nuk ka marrë pjesë në trajnim ose nuk e ka përfunduar testimin.

¹² Inspektorët duhet të shohin nëse menaxhimi ka zbatuar penalitete për punonjësit të cilët nuk arrijnë të marrin në kohë trajnimin e nevojshëm. Penalitete të tilla mund të përfshijnë, për shembull, ulje të bonuseve ose mosngritje të pagës.

Manuali i Mbikëqyrjes për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimin e Terrorizmit

Mospjesëmarrja ose moskalimi i testimit duhet të ndiqen për të siguruar që këta punonjës e kanë marrë trajnimin ose e kanë përfunduar testimin me sukses.

Procedura e Inspektimit:

Zhvillohet një intervistë e shkurtër në funksion të kryerjes së trajnimit PPP/FT dhe rishikohen programet dhe materialet e trajnimit, si dhe dokumentacionin e pjesëmarrjes. Vlerësohet nëse kryerja e trajnimit PPP/FT ka qenë e përshtatshme dhe nëse pjesëmarrja ka qenë e dokumentuar dhe e ndjekur siç duhet.

5.6 Kujdesi i duhur dhe dokumentet e nevojshme për identifikimin e konsumatorit

Objekti: Përcaktimi nëse procedurat e kujdesit të duhur për konsumatorin dhe transaksionin janë hartuar dhe zbatuar në mënyrën e duhur, si dhe nëse janë realizuar në përputhje me Ligjin PPP/FT.

Procedura e Inspektimit:

1. Zhvillohen intervista me bizneset përkatëse, funksionet e sigurimit të cilësisë dhe përputhshmërisë. Intervistat duhet të mbulojnë hartimin e procedurave dhe kontrolleve për kujdesin e duhur ndaj transaksioneve të konsumatorit, zbatimin dhe realizimin e tyre;
2. Rishikohen funksionalitetet e sistemeve që ndihmojnë punonjësit për të realizuar dhe kontrolluar me kujdesin e duhur transaksionet e konsumatorëve;
3. Nga baza prej 20,000 e konsumatorëve përkatës (d.m.th. marrëdhënie konsumatorësh të cilat janë subjekt i Ligjit PPP/FT), tërhiqet një total prej 50 dosjesh të rastësishme të konsumatorëve dhe një shtesë prej 10 dosjesh të rastësishme të konsumatorëve për bazën shtesë prej 10,000 konsumatorësh të përzgjedhur nga inspektori. Verifikohet nëse dokumentacioni dhe informacioni i nevojshëm është marrë dhe regjistruar në përputhje me Nenin 4 të Ligjit PPP/FT në kohën e kërkuar nga ligji.

Procedurat e Kujdesit të Duhur dhe kontrolleve të konsumatorëve dhe transaksioneve duhet të mbulojnë kryesisht dispozitat e Nenit 4 të Ligjit PPP/FT, për shembull:

- Procedurat janë kryer përpara vendosjes së marrëdhënieve të biznesit;
- Konsumatori është një person i zakonshëm, një ent ligjor ose një trust;
- Informacioni i kërkuar nga Neni 5 i Ligjit PPP/FT (p.sh., për personat e zakonshëm, emrat, datëlindja, vendlindja, vendbanimi, punësimi, etj.)
- Zotëruesit e përfitimeve janë identifikuar dhe identitetet e zotëruesve të përfitimeve janë identifikuar;
- Duhet të kuptohen dhe dokumentohen autorizimet ose prokurat e përfaqësimit;
- Duhet të kuptohet dhe dokumentohet struktura e zotërimit dhe kontrollit (në rastin e personave ligjorë ose të marrëveshjeve ligjore);

Manuali i Mbikëqyrjes për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimin e Terrorizmit

- Duhet të regjistrohen dokumentacionet e verifikimit të identiteteve (p.sh. kopjet e pasaportave ose të dokumenteve ligjore).

5.7 Kategorizimi i Rrezikut në lidhje me konsumatorët dhe transaksionet

Objekti: Vlerësimi nëse subjekti ka zhvilluar në mënyrë të mjaftueshme kategoritë e rrezikut ndaj konsumatorëve dhe transaksioneve dhe nëse, në përputhje me këto kategori, janë identifikuar konsumatorët dhe transaksionet me rreziqe më të mëdha për qëllimet e rritjes së kujdesit të duhur.

Vërejtje paraprake:

Në përputhje me Nenin 4/1(e) të Ligjit PPP/FTP, subjekti duhet të zhvillojë në vazhdimësi monitorimin e marrëdhënieve të konsumatorëve/klientëve, duke përfshirë analizën e transaksioneve të realizuara gjatë marrëdhënies, për të siguruar që ato janë në përputhje me njohuritë e subjektit të klientit, natyrës së biznesit, profilit të rrezikut dhe burimit të fondeve.¹³

Në përputhje me Nenin 7 të Ligjit PPP/FT, kujdesi i duhur për marrëdhëniet e biznesit dhe transaksionet që paraqesin rreziqe të rritura të pastrimit të parave, do të përfshijë masa shtesë (krahas nivelit të kujdesit të duhur të treguar për marrëdhëniet dhe transaksionet që përfshijnë një nivel të ulët të rreziqeve). Ligji PPP/FT parashikon që subjektet, minimalisht duhet të përcaktojnë kategoritë e mëposhtme të konsumatorëve që kanë rreziqe të rritura për pastrimin e parave:

- Personat e ekspozuar politikisht ("PEP-të"), shih Nenin 8, paragrafi 1(f) të Ligjit PPP/FT;
- Organizatat jofitimprurëse (Neni 8, paragrafi 3, i Ligjit PPP/FT);
- Konsumatorët jorezidentë (Neni 8, paragrafi 4, i Ligjit PPP/FT);
- Konsumatorët që banojnë ose ushtrojnë aktivitetet e biznesit në vende të cilat nuk zbatojnë standardet përkatëse FATF për parandalimin dhe luftën për parandalimin e pastrimit të parave (Neni 8 paragrafi 5, Ligji PPP/FT).

Në lidhje me transaksionet, Ligji PPP/FT kërkon një ent:

- Për të treguar kujdes të veçantë për të gjitha transaksionet komplekse, d.m.th. transaksionet me vlera të mëdha dhe jo të zakonshme, të cilat nuk kanë qëllim të dukshëm ekonomik ose ligjor (Neni 9, paragrafi 1, Ligji PPP/FT Nr. 9917);
- Për të verifikuar dhe ushtruar kujdesin e duhur në rritje ndaj marrëdhënieve të biznesit dhe transaksioneve me të gjitha llojet e konsumatorëve që banojnë ose zhvillojnë aktivitetin e tyre në vende të cilat nuk i zbatojnë ose i zbatojnë pjesërisht standardet ndërkombëtare përkatëse, për

¹³ Në prill të vitit 2008, Drejtoria e Përgjithshme ka publikuar një raport analitik strategjik, i cili jep informacion në lidhje me disa tendenca të pastrimit të parave, modeleve dhe tipologjive në lidhje me produktet e sigurimeve. Duke iu referuar Raportimit të Aktivitetit Dyshues në Industrinë e Sigurimeve: Një Vlerësim i Shkresave të Paraqitura për Raportimin e Aktivitetit të Dyshimtë në *ëëë.generaldirectorate.gov. al*

Manuali i Mbikëqyrjes për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit

parandalimin dhe luftën për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit (Neni 8, paragrafi 5, Ligji PPP/FT Nr. 9917).

Subjekti duhet të përcaktojë më tej kategoritë e marrëdhënieve me konsumatorët dhe transaksionet me rreziqe të rritura, por duhet të zhvillojë procedura në mënyrë që të identifikohen këto marrëdhënie të konsumatorëve dhe të transaksioneve.

Në lidhje me marrëdhëniet PEP, referojuni seksionit të veçantë më poshtë.

Procedura e Inspektimit:

- Zhvillohen intervista me bizneset përkatëse dhe funksionet e përputhshmërisë. Intervistat e lejojnë Inspektorin të kuptojë kategoritë e rrezikut të zhvilluara nga subjekti dhe se si janë identifikuar marrëdhëniet dhe transaksionet e konsumatorit me rreziqe të rritura ndaj pastrimit të parave në fillim dhe gjatë marrëdhënies së konsumatorit si dhe të vlerësojë nëse kategoritë ekzistuese të rrezikut janë të mjaftueshme dhe nëse punonjësit kanë një njohje të mirë të çështjes;
- Verifikohet nëse subjekti ka përcaktuar kategoritë minimale të rrezikut, të kërkuara nga rregulloret, d.m.th. Nenet 7 dhe 8 të Ligjit PPP/FT (shih më sipër);
- Verifikohet dokumentacioni në lidhje me identifikimin e marrëdhënieve dhe transaksioneve të konsumatorit me rreziqe të rritura dhe vlerësohet përshtatshmëria e tyre;
- Verifikohen sistemet IT ose mjetet e përdorura për qëllimet e identifikimit të marrëdhënieve dhe transaksioneve të konsumatorit me rreziqe të rritura dhe vlerësohet nëse ato janë të mjaftueshme për t'u përputhur me Ligjin PPP/FT;
- Nga lista e transaksioneve të konsumatorëve të subjektit (duhet zgjedhur periudha e përshtatshme e kohës), verifikohet nëse ka transaksione të cilat bien në kategorinë me rrezik të rritur dhe verifikohet nëse subjekti ka shënuar rregullisht transaksionet përkatëse si përfshirëse të rreziqeve të rritura.

5.8 Kujdes i duhur dhe i zgjeruar

Objektivi: Të vlerësohet nëse subjekti ka marrë dokumentacion apo informacion të mëtijshëm në lidhje me marrëdhëniet e konsumatorëve me rreziqe të rritura ose të transaksioneve me rreziqe të rritura. Vlerësohet nëse subjekti, nëpërmjet dokumentacionit dhe informacionit të marrë, kupton në mënyrë të përshtatshme mjedisin e këtyre marrëdhënieve dhe/ose transaksioneve të konsumatorit.

Përmbledhje

Neni 7 i Ligjit PPP/FT parashikon që në rastet e konsumatorëve dhe transaksioneve që përfshijnë rreziqe të rritura (të larta) për pastrimin e parave, subjekti duhet të realizojë një nivel të lartë të kujdesit të duhur, d.m.th., të marrë informacion shtesë për mjedisin, si më poshtë:

Manuali i Mbikëqyrjes për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimin e Terrorizmit

- Në lidhje me marrëdhëniet e konsumatorit, informacion shtesë për mjedisin e konsumatorit, p.sh. curriculum vitae, asetet (paratë fizike, investime, pasuri të paluajtshme, pjesëmarrës) familjen, informacion në thellësi për burimin e fondeve të vendosura në shoqëri, etj.
- Në lidhje me transaksionet, informacion për arsyen, palët e interesuara, burimin e fondeve dhe në rast të një transaksioni tregtar, qëllimet e biznesit të tij, një kopje të kësaj kontrate, etj.

Sasia dhe lloji i informacionit dhe dokumentave që do të merren varion nga njëri rast në tjetrin, në varësi të faktorëve të rrezikut si sasia, pazakonshmëria, vendet e përfshira, etj. Informacioni dhe dokumentat shtesë të marra, duhet të lejojnë subjektin që të gjykojë nëse marrëdhëniet ose transaksionet e konsumatorit janë të dyshueshme apo jo. Për këtë qëllim, subjekti nuk duhet vetëm të grumbullojë informacionin dhe dokumentat shtesë të nevojshme, por të verifikojë nëse vërtet, në total, ato kanë kuptim dhe shpjegojnë në mënyrë të mjaftueshme mjedisin e marrëdhënies ose transaksionit të konsumatorit.

Procedura e Inspektimit

- Nga lista e subjektit për konsumatorët/klientët dhe transaksionet që përfshijnë rreziqet e rritura, përzgjidhet një numër i përshtatshëm i pozicioneve, merren dosjet e konsumatorëve/klientëve ose transaksioneve përkatëse; dhe
- Verifikohet nëse informacioni/dokumentat e marra janë të mjaftueshme për të gjykuar nëse mjedisi i marrëdhënies dhe/ose transaksionit të konsumatorit/klientit është kuptuar në mënyrë të mjaftueshme dhe nëse ai është apo duket si i dyshimtë.

5.9 Personat e Ekspozuar Politikisht (Neni 8, paragrafi 1, i Ligjit PPP/FT)

Përmbledhje

Objekti: Të vlerësohet nëse subjekti ndjek dispozitat e Ligjit PPP/FT për marrëdhëniet me personat e lartë të ekspozuar politikisht, të referuar shpesh si “persona të ekspozuar politikisht” (PEP-të) dhe mjaftueshmërinë e sistemeve të subjektit për të menaxhuar rreziqet e lidhura me këto figura të politikës vendase ose të huaj dhe aftësinë e menaxhimit për të zbatuar kujdesin e duhur të bazuar në rrezik, verifikimin, monitorimin dhe sistemet e raportimit.¹⁴

Subjekti duhet të ndërmarrë të gjithë hapat e nevojshëm për të siguruar që ajo nuk ndihmon me dashje apo pa dashje në fshehjen ose lëvizjen e të ardhurave nga korrupsioni i figurave të jashtme të larta politike, familjet e tyre dhe personat e lidhur me ta. Për shkak të rreziqeve të paraqitura nga PEP-të, do të variojë sipas konsumatorit, produktit/shërbimit, vendit dhe industrisë, identifikimi, monitorimi dhe hartimi i kontroleve për këto llogari dhe transaksione duhet të jetë i bazuar në rrezik.

Përkufizimi i PEP-ve

¹⁴ AMF do të bashkërendojë me DPShPPP-në kur të jetë e nevojshme për vlerësimin e PEP-ve.

Manuali i Mbikëqyrjes për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimin e Terrorizmit

Në përputhje me Ligjin PPP/FT, “PEP” nënkupton persona që janë të detyruar të deklarojnë pronat e tyre në përputhje me Ligjin nr. 9049, datë 10.04.2013 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë.”, i ndryshuar¹⁵ Ligji nr.9049 kërkon që zyrtarët e qeverisë, familjet e tyre dhe personat e lidhur me ta në punë personale të afërta ose marrëdhëniet e biznesit (duke përjashtuar menaxhimin e ulët ose të mesëm, në përputhje me dispozitat e legjislacionit për shërbimin civil) të deklarojnë asete të caktuara si dhe burimet e krijimit të tyre.¹⁶

Kjo kategori përfshin gjithashtu individë të cilët kanë ose kanë pasur funksione të rëndësishme në një qeveri dhe/ose në një vend të huaj, të tillë si: kryetar shteti dhe/ose qeverie, politikanët e lartë, zyrtarët e lartë të qeverisë, gjykatës ose ushtarakë, drejtues të lartë të shoqërive publike, zyrtarë kryesorë të partive politike, duke përfshirë anëtarët e familjes ose personat që lidhen me të në marrëdhënie të afërta personale, pune ose biznesi. Duke pasur parasysh sa më sipër, është e rekomandueshme që shoqëritë të kategorizojnë zyrtarët dhe personat e lidhur me ta njësoj si ata që janë ose kanë qenë në detyrë me dokumentacionin e duhur.

Faktorët e Rrezikut PEP

Në rastet me profil të lartë, gjatë viteve të fundit, PEP-të i kanë përdorur shoqëritë si përcjellësa të aktiviteteve të tyre, duke përfshirë korrupsionin, mitmarrjen dhe pastrimin e parave. Megjithatë, jo të gjithë PEP-të paraqesin të njëjtin nivel rreziku. Ky rrezik do të variojë në varësi të faktorëve të shumtë, duke përfshirë vendndodhjen gjeografike të PEP-ve, industrinë ose sektorin, pozicionin dhe nivelin ose natyrën e influencës ose autoritetit. Rreziqet mund të variojnë në varësi të faktorëve si qëllimi i llogarisë, aktiviteti aktual ose i parashikuar, produktet dhe shërbimet e përdorura dhe madhësia ose kompleksiteti i marrëdhënies së llogarisë.

Si rezultat i këtyre faktorëve, disa PEP mund të jenë me rrezik të ulët dhe disa mund të jenë me rrezik të lartë për korrupsionin e jashtëm ose pastrimin e parave. Subjektet të cilat zhvillojnë biznese me PEP-të e pandershëm përballen me rrezik të konsiderueshëm të reputacionit, ekzaminim rregullator shtesë dhe veprime të mundshme mbikëqyrëse. Red flags mund të tregojnë transaksione në lidhje me të ardhurat nga nga korrupsioni i jashtëm. **Shënim:** Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoriatit të Lartë për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive paraqet jo më pak se dy herë në vit një listë të plotë dhe të përditësuar të PEP-ve në përputhje me dispozitat e vendosura në Ligjin Shqiptar Nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin

¹⁵ **Shënim:** “Persona të ekspozuar politikisht” janë personat të cilët janë të detyruar të deklarojnë pronat e tyre, në përputhje me Ligjin nr.9049, date 05.10.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar duke përfshirë anëtarët e familjeve ose personat e lidhur në marrëdhënie të ngushta personale, pune ose biznesi, duke përjashtuar punonjësit e nivelit të mesëm ose ulët menaxherial, në përputhje me dispozitat e legjislacionit për shërbimin civil. Kjo kategori përfshin gjithashtu individë të cilët kanë ose kanë pasur funksione të rëndësishme në një qeveri dhe/ose në një vend të huaj, të tillë si: kryetar shteti dhe/ose qeverie, politikanët e lartë, zyrtarët e lartë të qeverisë, gjykatës ose ushtarakë, drejtues të lartë të shoqërive publike, zyrtarë kyç të partive politike, duke përfshirë anëtarët e familjes ose personat që lidhen me të në marrëdhënie të afërta personale, pune ose biznesi.

¹⁶ Ndërkohë që ligji nuk është i qartë se nga çfarë përbëhen “personat e lidhur” AMF do të bashkërendohet me DPShPPP-në për rishikimin/dispozitat përfundimtare të PEP-ve.

Manuali i Mbikëqyrjes për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimin e Terrorizmit

dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë.”, i ndryshuar. Shoqëritë gjithashtu duhet të jenë vigjilente për aksesin e PEP-ve dhe kontrollin ose ndikimin mbi llogaritë qeveritare ose të korporatave; niveli i përfshirjes së ndërmjetësve, shitësve, transportuesve dhe agjentëve në industrinë ose sektorin në të cilin operojnë PEP-të; dhe në përdorimin abuziv të mjeteve të korporatës dhe të enteve të tjera me pronësi të paqartë.

Zbutja e Rrezikut PEP

Subjektet në hartimin dhe zbatimin e politikave, procedurave e proceseve në lidhje me PEP-të, duhet të ushtrojnë një gjykim të arsyeshëm. Subjektet duhet të marrin informacionin e kujdesit të duhur mbi bazë rreziku për PEP-et dhe përcaktojnë politikën, procedurat e proceset për shqyrtimin dhe monitorimin e duhur. Është kritike ekzistenca e procedurave të përshtatshme të bazuara në rrezik për hapjen e llogarive për produktet me shuma të mëdha në valutë ose me rrezik të lartë. Hapja e një llogarie është mundësia kryesore për subjektin që të grumbullojë informacion për të gjithë konsumatorët/klientët, duke përfshirë PEP-të.

Në raport (përpjestimisht) me nivelin e identifikuar të rrezikut, procedurat mbi kujdesin e duhur duhet të përfshijnë sa më poshtë vijojnë, por pa u kufizuar vetëm tek to vijon:

- Identifikohet mbajtësi i llogarisë dhe zotëruesi i përfitimeve, duke përfshirë zotëruesit nominalë dhe përfituesit e shoqërive, trusteve, partneriteteve, shoqërive private të investimeve ose enteve të tjera ligjore të cilat janë mbajtëse të llogarive;
- Kërkohet informacion drejtpërdrejt nga mbajtësi i llogarisë dhe zotëruesi i përfitimeve në lidhje me statusin e mundshëm të PEP-ve;
- Identifikohet/en vendi(et) i/e banimit të mbajtësit të policës dhe zotëruesit të përfitimeve dhe nivelin e rrezikut për korrupsion dhe pastrim të parave lidhur me këto juridiksione;
- Merret informacion në lidhje me punësimin, duke përfshirë industrinë, sektorin dhe nivelin e rrezikut për korrupsion, në lidhje me industrinë dhe sektorët;
- Kontrollohen referencat, sipas rastit, për të përcaktuar nëse mbajtësi i llogarisë dhe zotëruesi i përfitimeve është apo ka qenë një PEP;
- Identifikohet burimi i pasurisë dhe fondet e mbajtësit të llogarisë dhe zotëruesit të përfitimeve;
- Merret informacion për anëtarët e familjes ose të afërm qoftë nëse kanë të drejta për të kryer transaksione nëpërmjet llogarisë apo përfitime nëpërmjet transaksioneve të kryera nëpërmjet llogarisë;
- Përcaktohet qëllimi i llogarisë, volumi i pritshëm dhe natyra e aktivitetit të llogarisë; dhe
- Bëhen përpjekje të arsyeshme për të riparë burimet publike të informacionit. Këto burime do të variojnë në varësi të çdo shtate; megjithatë, subjektet duhet të kontrollojnë mbajtësin e llogarisë dhe çdo zotërues të përfitimeve të enteve ligjore kundrejt burimeve publike të informacionit të aksesueshme në mënyrë të pranueshme (p.sh., bazat e të dhënave qeveritare, publikimet në

Manuali i Mbikëqyrjes për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimin e Terrorizmit

mediat më të rëndësishme, bazat e të dhënave tregtare dhe baza të tjera të dhënash në internet, sipas rastit).

Llogaritë PEP nuk janë të kufizuara në shoqëritë e mëdha ose të fokusuara ndërkombëtarisht. Një PEP mund të hapë një llogari në çdo shoqëri, pavarësisht përmasës ose vendndodhjes së saj. Subjektet duhet të kenë procedura të bazuara në rrezik për identifikimin e llogarive PEP dhe për vlerësimin e nivelit të risqeve përfshira, të cilat do të variojnë. Menaxhimi duhet të përfshihet në vendimet për të pranuar një llogari PEP. Në qoftë se menaxhimi përcakton pasi ka ndodhur, se një llogari është llogari PEP, ajo duhet të vlerësojë risqet dhe të ndërmarrë hapat e duhur.

Subjekti duhet të ushtrojë kujdesin e duhur në mënyrë të pranueshme në lidhje me këto llogari. Për shembull, mund të rrisë kërkesat referuese, të marrë informacion shtesë për PEP-et nga degët ose korrespondentët që operojnë në vendin e banimit të konsumatorit dhe të bëjnë përpjekje të pranueshme për të konsultuar publikisht burimet e disponueshme të informacionit. Monitorimi i PEP-ve i bazuar në rrezik në vazhdimësi është kritik për të siguruar se llogaritë janë përdorur sipas parashikimit.

Procedura e Inspektimit

Të përgjithshme

1. Rishikohen politikat e bazuara në rrezik, procedurat dhe proceset në lidhje me PEP-të. Vlerësohet përshtatshmëria e politikave, procedurave dhe proceseve në lidhje me PEP-të. Vlerësohet përshtatshmëria e politikave, procedurave dhe proceseve duke pasur parasysh llogaritë e PEP-ve të shoqërisë dhe rreziqet që ata paraqesin. Vlerësohet nëse kontrollet e bazuara në rrezik janë të përshtatshme për të mbrojtur në mënyrë të pranueshme subjektin nga përdorimi si një kanal për pastrimin e parave, korrupsionit dhe financimit të terrorizmit.
2. Rishikohen procedurat për hapjen e llogarive PEP. Identifikohet roli i menaxhimit në miratimin dhe monitorimin e vazhdueshëm të bazuar në rrezik të llogarive PEP.
3. Nga rishikimi i SMI-së dhe faktorëve të brendshëm të klasifikimit të rrezikut, përcaktohet nëse shoqëria identifikon me efektivitet dhe monitoron marrëdhëniet PEP, në veçanti ato që kanë rrezik të lartë për korrupsion, pastrim parash dhe financim të terrorizmit.
4. Përcaktohet nëse sistemi i shoqërisë për monitorimin e PEP-ve për aktivitetet e dyshimta dhe për raportimin e aktiviteteve të dyshimta është i përshtatshëm, duke pasur parasysh madhësinë e shoqërisë, kompleksitetin, vendndodhjen dhe llojet e marrëdhënieve të konsumatorit.
5. Kur është e përshtatshme, përcaktohet nëse subjekti ka verifikuar se personi është në ndonjë listë sanksionesh.

Testimi i Transaksioneve

6. Në bazë të vlerësimit të rrezikut të shoqërisë për marrëdhëniet PEP-ve të saj, si dhe inspektimit paraprak dhe raporteve të auditimit, përzgjidhet një mostër e llogarive PEP. Mbi mostrën e përzgjedhur kryhen procedurat e mëposhtme të inspektimit:

Manuali i Mbikëqyrjes për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimin e Terrorizmit

- Përcaktohet përputhshmëria me kërkesat rregullatore dhe me politikat, procedurat dhe proceset e krijuara të kompanisë në lidhje me PEP-të;
- Rishikohet aktiviteti i transaksioneve për llogarinë e përzgjedhur. Nëse është e nevojshme, kërkojnë dhe rishikohen transaksionet;
- Nëse analiza e aktivitetit dhe informacioni mbi kujdesin e duhur ndaj konsumatorit paraqet shqetësime, bëhen diskutime me menaxhimin e shoqërisë.

Bazuar në procedurën e përfunduar të inspektimit, përfshirë testimin e transaksioneve, krijohet një konkluzion për përshtatshmërinë e politikave, procedurave dhe proceseve me PEP-të.

5.10 Monitorimi nga Punonjësi PPP/FT/Përputhshmërisë

Objektivi: Vlerësimi nëse funksioni i Përputhshmërisë PPP/FT harton dhe realizon një set të mjaftueshëm të detyrave monitoruese për të siguruar menaxhimin se funksionet e biznesit tregojnë në mënyrë të përshtatshme, kujdesin e duhur PPP/FT.

Vërejtje paraprake

Një detyrë tipike e Punonjësit të Përputhshmërisë PPP/FT, është të monitorojë nëse funksionet e biznesit ushtrojnë në mënyrë të përshtatshme kujdesin e duhur e kontrollet e procedurat e kujdesit të duhur në rritje , me qëllim që të sigurojnë menaxhimin se dispozitat e Ligjit PPP/FT janë zbatuar siç duhet. Punonjësi i Përputhshmërisë PPP/FT, rrjedhimisht duhet të krijojë dhe të zbatojë një set detyrash monitoruese të cilat mbulojnë dispozitat e rëndësishme të Ligjit PPP/FT.

Shembujt përfshijnë:

- Rishikime periodike (frekuenca varet nga niveli i rrezikut të përfshirë) të një numri të përshtatshëm dosjesh të marrëdhënieve të reja të konsumatorëve dhe gjykimin kujdesi i duhur bazë (identifikimi dhe verifikimi i identitetit të konsumatorit dhe zotërimi i përfitimeve, dokumentacioni i të dhënave bazë të konsumatorit dhe informacioni i mjedisit) është kryer në mënyrë të rregullt;
- Kontrole periodike (frekuenca varet nga niveli i rrezikut të përfshirë) nëse konsumatorët dhe transaksionet me rreziqe të rritura janë identifikuar dhe shënuar (“red flag” të mundshëm) në rregull;
- Kontrole nëse informacioni për sfondin/historikun e konsumatorit është përditësuar sipas nevojës.

Të gjitha këto kontrole duhet të dokumentohen.

Procedura e Inspektimit:

Manuali i Mbikëqyrjes për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimin e Terrorizmit

1. Intervistohet Punonjësi i Përputhshmërisë PPP/FT dhe përcaktohet nëse ai/ajo ka përgatitur dhe dokumentuar setin e nevojshëm të detyrave monitoruese dhe nëse detyrat janë realizuar në përputhje me periodicitetin e caktuar;
2. Merret një numër i rasteve të modeleve nga dosjet e monitorimit të Punonjësit të Përputhshmërisë PPP/FT dhe verifikohet nëse kontrollet/rishikimet kanë qenë të realizuara dhe të dokumentuara siç duhet.

5.11 Raportet e Transaksioneve Para fizike (RTPF-të)

Objektivi: Vlerësimi nëse subjekti zbaton rregullat e Ligjit PPP/FT për raportimin e transaksioneve në para fizike *në shumën e përcaktuar në dispozitat e Ligjit PPP/FTP.*

Procedura e Inspektimit:

Për një periudhë të përshtatshme kohore, merret lista e transaksioneve në para fizike të të ardhurave dhe shpenzimeve të kompanisë dhe verifikohet nëse këto janë raportuar siç duhet në Drejtorinë e Përgjithshme.

5.12 Detyrimi për të ruajtur të dhënat – Mbajtja e Regjistrimeve

Objektivi: Vlerësimi nëse subjekti zbaton siç duhet dispozitat e Nenit 16 të Ligjit PPP/FT në lidhje me detyrimin për të mbajtur të dhënat që i përkasin detyrimeve PPP/FT.

Vërejtje paraprake

Në përputhje me Nenin 16 të Ligjit PPP/FT, siguruesit duhet të mbajnë për të paktën 5 vjet* që nga data e kryerjes së transaksionit të fundit financiar (të një marrëdhënieje biznesi) ose pasi të ketë përfunduar marrëdhënia e biznesit, dokumentat dhe informacionin e mëposhtëm në lidhje me:

- Identifikimin e marrëdhënieve të biznesit;
- Dosjet (skedarët) e llogarisë;
- Korrespondencën e konsumatorit / biznesit; dhe
- Transaksionet financiare (d.m.th., regjistrat, raportet dhe dokumentat në lidhje me to).¹⁷

Procedura e Inspektimit

- Merret një numër i përshtatshëm i dosjeve të marrëdhënieve aktuale të konsumatorit dhe të transaksioneve të biznesit dhe verifikohet nëse nga shoqëria janë mbajtur të gjitha dokumentat dhe të dhënat e nevojshme ;

¹⁷ Entet duhet të mbajnë dokumentacionin në lidhje me identifikimin, llogaritë dhe korrespondencën me konsumatorin për 5 vjet nga data e mbylljes së llogarisë ose përfundimit të marrëdhënieve të biznesit me konsumatorin dhe/ose entin. Me kërkesën e pranueshme të autoritetit përgjegjës, një shoqërie mund t'i kërkojë ta mbajë dokumentacionin për më shumë se 5 vjet.

Manuali i Mbikëqyrjes për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimin e Terrorizmit

- Merret një numër i përshtatshëm i dosjeve të marrëdhënieve të përfunduara të konsumatorit dhe të transaksioneve të biznesit dhe verifikohet nëse nga shoqëria janë mbajtur të gjitha të dhënat e nevojshme dhe dokumentat.

5.13 Vlerësimi Paraprak

Pasi inspektori të ketë përfunduar rishikimin e të katër elementëve të kërkuar për programin e përputhshmërisë PPP/FT të subjektit, inspektori duhet të dokumentojë një vlerësim paraprak të programit të subjektit. Në këtë pikë, inspektori duhet të rishqyrtojë planin e inspektimit fillestar, në mënyrë që të përcaktojë nëse janë identifikuar pikat e forta ose të dobëta gjatë rishikimit të programit të përputhshmërisë PPP/FT të institucionit, për të justifikuar rregullimet në fushën fillestare të planifikuar. Inspektori duhet të dokumentojë dhe të mbështesë të gjitha ndryshimet në fushën e inspektimit, e më pas të procedojë me thelbin dhe, nëse është e justifikuar, të zgjerojë procedurat e inspektimit. Në qoftë se nuk ka ndryshime në fushën e inspektimit, inspektori duhet të procedojë me procedurat kryesore të inspektimit, “Përgatitja e Konkluzioneve dhe Përfundimi i Inspektimit,” më poshtë.

5.14 Përgatitja e Konkluzioneve dhe Finalizimi i Inspektimit

Objektivi: Formulimi i konkluzioneve, komunikimi i rezultateve tek menaxhimi, përgatitja e komenteve të raportit, hartimi i një përgjigjeje të përshtatshme mbikëqyrëse dhe mbyllja e inspektimit.

Formulimi i Konkluzioneve

- Grumbulloni të gjitha rezultatet përkatëse nga procedurat e kryera të inspektimit PPP/FT. Vlerësoni përpikmërinë dhe besueshmërinë e të gjitha vlerësimeve të rrezikut të bëra nga shoqëria. Arrini në një konkluzion paraprak nëse janë përmbushur kërkesat e mëposhtme:
 - Programi i përputhshmërisë PPP/FT është i monitoruar dhe i mbikëqyrur në mënyrë efektive, në lidhje me profilin e rrezikut të subjektit, sipas përcaktimit nga vlerësimi i rrezikut. Inspektori duhet të përcaktojë nëse programi i përputhshmërisë PPP/FT është efektiv në lehtësimin e rrezikut të përgjithshëm të subjektit;
 - Bordi Mbikëqyrës dhe menaxhimi i lartë (a) janë në dijeni të kërkesave rregullatore PPP/FT, (b) mbikëqyrin në mënyrë efektive përputhshmërinë PPP/FT dhe (c) angazhohen, sipas nevojës, për të rregulluar veprimet (p.sh. inspektimet rregullatore dhe të auditimit);
 - Politikat PPP/FT, procedurat dhe proceset janë të mjaftueshme për të siguruar përputhshmërinë me ligjet dhe rregulloret e zbatueshme dhe i drejtojnë siç duhet operacionet me rrezik të lartë (produktet, shërbimet, konsumatorët, entet dhe vendndodhjet gjeografike).
- Kontrollat e brendshme sigurojnë në mënyrë të përshtatshme përputhshmëri me PPP/FT-në dhe bëjnë menaxhim të mjaftueshëm të rrezikut, veçanërisht për operacionet me rrezik të lartë (produktet, shërbimet, konsumatorët, entet dhe vendndodhjet gjeografike).

Manuali i Mbikëqyrjes për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimin e Terrorizmit

- Testimi i pavarur (auditimi) është i përshtatshëm dhe teston në mënyrën adekuate përputhshmërinë me ligjet, rregulloret dhe politikat e kërkuara. Mbulimi dhe frekuenca e përgjithshme janë të mjaftueshme në lidhje me profilin e rrezikut të shoqërisë. Testimi i transaksioneve është adekuat, veçanërisht për operacionet me rrezik të lartë të shoqërive dhe sistemet e monitorimit të aktiviteteve të dyshimta.
- Personi i caktuar, i përgjegjshëm për koordinimin dhe monitorimin e përditshëm të përputhshmërisë është kompetent (d.m.th., trajnimi, eksperiencia dhe arsimimi) dhe ka burimet e nevojshme.
- Stafi është i trajnuar në mënyrë të mjaftueshme për t'ju përmbajtur kërkesave ligjore, rregullatore dhe të politikave.
- Politikat, procedurat dhe proceset e informacionit dhe të komunikimit janë të mjaftueshme dhe të sakta.

Të gjitha përcaktimet përkatëse duhet të dokumentohen dhe shpjegohen.

Përcaktimi i Shkakut Kryesor

Përcaktohet shkaku kryesor i mangësive në politika, procedura ose të procese, nëse mund të identifikohet. Këto mangësi mund të jenë si rezultat i një sërë faktorësh, duke përfshirë, por pa u kufizuar në sa vijon:

- Menaxhimi nuk i ka vlerësuar ose nuk i ka vlerësuar në mënyrë ta saktë rreziqet PPP/FT të subjektit;
- Menaxhimi nuk ka dijen i për çështjet përkatëse;
- Menaxhimi nuk ka dëshirë të krijojë ose të përmirësojë politikat, procedurat dhe proceset e bazuara në rreziqet e rritura;
- Menaxhimi ose punonjësit i shpërfillin politikat, procedurat dhe proceset;
- Menaxhimi ose punonjësit janë të painformuar ose i kanë keqkuptuar kërkesat rregullatore, politikat, procedurat ose proceset;
- Operacionet me rrezik të lartë (produktet, shërbimet, konsumatorët, entet dhe vendndodhjet gjeografike) janë rritur më shpejt se kapacitetet e programit të përputhshmërisë PPP/FT;
- Ndryshimet në politikat e brendshme, procedurat dhe proceset janë komunikuar në mënyrë të dobët.

Përcaktohet nëse mangësitë apo shkeljet kanë qenë të identifikuar më parë nga menaxhimi ose auditimi ose kanë qenë të identifikuar vetëm si rezultat i këtij inspektimi.

Manuali i Mbikëqyrjes për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimin e Terrorizmit

5.15 Diskutoni Konkluzionet me Inspektorin Përgjegjës dhe Identifikoni Veprimet e Nevojshme

Procedura e Inspektimit

- Diskutohen rezultatet paraprake me inspektorin përgjegjës për rishikimin e përputhshmërisë së përgjithshme PPP/FT të kompanisë. Shkresat dokumentohen në mënyrë të përshtatshme me informacionin e mëposhtëm:
- Konkluzioni në lidhje me mjaftueshmërinë e programit të përputhshmërisë PPP/FT dhe nëse ai përputhet me të gjitha kërkesat rregullatore duke dhënë sa vijon:
 - a. Një sistem për kontrollet e brendshme;
 - b. Testim të pavarur për përputhshmërinë;
 - c. Një person për të bashkërenduar dhe monitoruar programin e përputhshmërisë PPP/FT;
 - d. Trajnimin e personelit të duhur;
 - e. Një konkluzion, nëse Programi i Identifikimit të Konsumatorit (PIK), nëse aplikohet, është i përshtatshëm për madhësinë e kompanisë, vendndodhjen dhe llojin e biznesit;
 - f. Të gjitha shkeljet e identifikuara dhe një vlerësim për ashpërsinë e këtyre shkeljeve;
 - g. Identifikimi i veprimeve të nevojshme për të korrigjuar mangësitë ose shkeljet;
 - h. Nëse është e nevojshme, rekomandimet për veprimet e mbikëqyrjes. Në vazhdim, sipas nevojës, diskutohet me menaxhimin e mbikëqyrjes së agjencisë dhe me stafin ligjor të agjencisë;
 - i. Një normë të përshtatshme, të bazuar në rezultatet dhe konkluzionet e përgjithshme;
 - j. Rezultatet të cilat kanë qenë ose do të diskutohen me menaxhimin e subjektit dhe, nëse është e zbatueshme, të gjitha komitetet e subjektit/shoqërisë për përmirësimet ose veprimet korrigjuese.

5.16 Përgatitja e komenteve për Raportin e Inspektimit PPP/FT

Dokumentohen konkluzionet tuaja në lidhje me përputhshmërinë e programit PPP/FT të subjektit. Diskutohet efektshmëria e secilit prej këtyre elementeve të programit të përputhshmërisë së subjektit. Tregohet nëse programi i përputhshmërisë PPP/FT përputhet me të gjitha kërkesat e Ligjit PPP/FT.

Inspektori nuk ka nevojë të bëjë koment me shkrim për cilëndo nga zërat (a-j) e diskutuar më lart. Komentet me shkrim duhet të mbulojnë vetëm fushat ose subjektet që i përkasin rezultateve dhe konkluzioneve të inspektorit. Të gjitha rezultatet e rëndësishme duhet të përfshihen në Raportin e Inspektimit. Inspektori duhet të sigurojë që shkresat janë përgatitur me detajet e mjaftueshme për të mbështetur çështjet e diskutuara në Raportin e Inspektimit.

Manuali i Mbikëqyrjes për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit

Deri në masën që zërat 1-8 më poshtë janë diskutuar në shkresa, por jo në Rel, inspektori duhet të sigurojë që shkresat dokumentojnë në tërësi dhe në mënyrën e duhur çdo rishikim, si dhe çdo aspekt tjetër të programit të përputhshmërisë PPP/FT i cili meriton vëmendje, por mund të mos jetë në lartësinë e e duhur për t'u përfshirë në Rel. Inspektori duhet të organizojë dhe të referojë konkluzionet e shkresave dhe të dokumentit si dhe informacionin mbështetës brenda bazave të brendshme të të dhënave, sipas nevojës. Sipas rastit, inspektori duhet të përgatisë një diskutim për pikat e mëposhtme.

Përkshkruhet angazhimi i Bordit Mbikëqyrës dhe i menaxhimit të lartë për përputhshmërinë PPP/FT. Merret në konsideratë nëse menaxhimi ka si vijon:

1. Një program i fortë përputhshmërie PPP/FT, i mbështetur plotësisht nga Bordi Mbikëqyrës, menaxhimi i lartë ose një organ i ngjashëm;
2. Kushtin që Bordi Mbikëqyrës dhe menaxhimi i lartë janë mbajtur të informuar për përpjekjet e përputhshmërisë PPP/FT, raportet e auditimit, çdo mosrealizim të përputhshmërisë dhe që statusin e veprimeve korrigjuese, nëse funksioni i Përputhshmërisë PPP/FT ka staf të mjaftueshëm;
3. Përkshkruhet nëse politikat e kompanisë, procedurat dhe proceset përputhen me kërkesat rregullatore dhe janë efektive;
4. Përkshkruhet nëse politikat, procedurat dhe proceset e kompanisë për transaksionet e mëdha monetare përmbushin kërkesat e Ligjit PPP/FT Nr. 9917, Neni 13, (*"Për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit"*) dhe janë efektive. Nëse është e aplikueshme, përkshkruhet nëse politikat, procedurat dhe proceset e kompanisë për përjashtimet RTPF përputhen me kërkesat rregullatore për raportimin, bëjnë përjashtimet në mënyrën e duhur dhe përdorin format e duhura;
5. Përkshkruhet nëse politikat, procedurat dhe proceset e shoqërisë përmbushin kërkesat e ligjit të zbatueshëm. Diskutohet nëse politikat, procedurat dhe proceset përfshijnë kontrolle të brendshme efektive (p.sh., ndarjen e detyrave, autorizimin e duhur) dhe sigurojnë mënyrat për monitorimin e transfertave për qëllime të raportimit RTPF. Ligji PPP/FT Nr. 9917, Neni 11, dhe aktivitetet dyshuese;
6. Përkshkruhen politikat, procedurat dhe proceset e mbajtjes së regjistrave të kompanisë. Tregohet nëse ato përputhen me kërkesat e Ligjit PPP/FT Nr. 9917, Nenet 6, 11 & 16;
7. Përkshkruhet nëse kontrollet dhe procedurat PPP/FT të vendosura janë duke punuar në mënyrë efektive dhe çojnë në një rezultat të duhur dhe në përputhje me të gjitha dispozitat e Ligjit Shqiptar PPP/FT;

Manuali i Mbikëqyrjes për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimin e Terrorizmit

8. Përkshkruhet nëse politikat dhe procedurat e kompanisë për kërkesat detyruese ligjore për informacion nga autoritetet e huaja të zbatimit të ligjit për Prokurorin e Përgjithshëm të Shqipërisë përputhen me kërkesat rregullatore.¹⁸

6. FAZA IV: Draft Raportet e Inspektimeve dhe Letra për Drejtuesit

6.1 Draft Raporti i Inspektimit

Raporti i inspektimit duhet të përmbajë çdo rezultat të rëndësishëm të zbuluara gjatë inspektimit. Ai duhet të përcaktojë vëzhgimet, rezultatet, konkluzionet dhe rekomandimet që do të bëhen për kompaninë, në mënyrë që të mbështetë në mënyrë të qartë përmbajtjen e letrës për drejtuesit. Një model i letrës për drejtuesit është përfshirë në Tabelën 6. Përmbajtja e raportit të inspektimit, nga ana tjetër duhet të mbështetet plotësisht dhe të konfirmohet nga shkresat e inspektimit, nga shënimet e inspektimit dhe nga dokumentacioni tjetër përkatës.

6.2 Letra për Drejtuesit

Letra për drejtuesit është përdorur për të paraqitur rezultatet e inspektimit në menaxhimin e shoqërisë. Ajo duhet të jetë koncize dhe e përpiktë, duke trajtuar vetëm çështjet të cilat kërkojnë veprime korrigjuese nga menaxhimi. Letrat për drejtuesit nuk duhet të kenë asnjë dykuptimësi apo paqartësi dhe të jenë të lehta për t'u lexuar dhe kuptuar. Ka katër pika të cilat duhet të trajtohen në të gjitha letrat për drejtuesit:

1. Rezultatet (çështjet). Duhet të ketë përshkrime të qarta të çështjeve të gjetura nga inspektorët, të cilat duhet të evidentohen, p.sh: "Regjistrimet e subjektit për ndjekjen e trajnimit PPP/FT janë të pamjaftueshme. Gjithashtu, mospjesëmarrja nuk është ndjekur për punonjësit që kanë munguar.";
2. Pse duhet të evidentohen rezultatet (efekti për subjektin). Letra për drejtuesit duhet të përcaktojë efektin e çështjes për subjektin, p.sh: "Mungesa e mbajtjes së regjistrimeve në aspektin e ndjekjes së trajnimit PPP/FT, si dhe mungesa e ndjekjes së mospjesëmarrjes çon në rrezikun që disa punonjës nuk kanë formimin e përgjithshëm PPP/FT dhe strukturën PPP/FT të subjektit.";
3. Çfarë duhet bërë (d.m.th, rekomandimet)? Drejtuesve të subjektit, duhet t'i thuhet se çfarë pret AMF të ndërmerret me qëllim zgjidhjen e çështjes, p.sh.: "Duhet të ketë pjesëmarrje në trajnimet

¹⁸ Kërkesat për informacion, të dërguar nga autoritetet e huaja për Prokurorin e Përgjithshëm të Shqipërisë me Letër Porosie, duhet të dërgohen nëpërmjet Ministrisë së Drejtësisë ose drejtpërdrejt nëpërmjet Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm në rast urgjence. Pasi prokurori merr kërkesën, ai do të kërkojë nga gjykata që të lejohet ekzekutimi i Letrës së Porosisë. Me miratimin me shkrim nga Gjykata, prokurori mund të marrë çdo informacion dhe dokumentacion të nevojshëm nga shoqëria e sigurimeve.

Manuali i Mbikëqyrjes për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimin e Terrorizmit

PPP/FT dhe mospjesëmarrja duhet të ndiqet dhe të korrigohet." Në këtë shembull, veprimi që do të merret është i qartë, por është më mirë t'i kërkohet subjektit që të korrigojë këtë çështje dhe të këshillohet me inspektorin se si synohet ta bëjë atë. Nëse korrigjimi më vonë vërteton se është i papërshtatshëm, subjekti mund të argumentojnë se ka bërë atë që i ishte thënë të bëhej;

4. Korniza kohore Asnjë rekomandim nëpërmjet të cilit subjekti duhet të përgjigjet për rregullatorin, nuk duhet të bëhet pa një afat kohor. Praktikë normale është kthimi i përgjigjes për 30 ditë, megjithatë mund të jetë e vështirë që të arrihet, kur për shembull, subjekti ka nevojë të përcaktojë dhe të instalojë sistemet e reja të IT-së. "Ju lutemi, konfirmoni me [data] se: (a) subjekti ka ndërmarrë hapa të arsyeshëm për të siguruar që të dhënat e frekuentimit të trajnimit PPP/FT janë mbajtur; dhe (b) janë zbatuar procese dhe kontrole të arsyeshme për të siguruar që punonjësit të cilët nuk kanë ndjekur një seancë trajnimi PPP/FT të ndjekin trajnimin në vijim dhe se është mbajtur regjistri i këtyre ndjekjeve të trajnimit.";
5. Letra për drejtuesit duhet të lëshohet dhe t'ju dërgohet drejtorit ekzekutiv dhe kryetarit të këshillit mbikëqyrës nga rregullatorët, me kusht që një kopje t'i dërgohet audituesit të jashtëm të kompanisë dhe punonjësit të përputhshmërisë.

Në qoftë se përgjigja e subjektit është e kënaqshme, (d.m.th., veprimi(et) i bërë, ose që do të bëhet është i pranueshëm), inspektori duhet të përgjigjet duke pranuar se veprimi(et) i subjektit duket i pranueshëm, por do të rishikohet në ose përpara inspektimit të ardhshëm të planifikuar.

Në rastet kur çështjet e ngritura janë të një kompleksiteti domethënës ose nevojiten disa veprime afatmesme deri afatgjata, subjektit në letrën për drejtuesit duhet t'i kërkohet të paraqitë një plan të detajuar të projektit, duke emërtuar palët përgjegjëse, për mënyrën sesi synojnë ata të zgjidhin çështjen.

7. FAZA V: Inspektimi i vijueshmërisë

Në rastin kur çështjet e ngritura, të cilat paraqesin rreziqe të larta apo kompleksitet domethënës, subjekti duhet të vizitohet pas një periudhe të pranueshme kohore për të realizuar një Inspektim pas zbatimit (ndjekjes), me qëllim që të verifikojë dhe sigurojë që çështja është reale dhe duhet të zgjidhet. Inspektimi në vazhdimësi duhet të përcaktohet në letrën për drejtuesit. Performanca dhe programi i saj varen nga çështja që është ngritur. Ajo përgjithësisht do të përsërisë Inspektimin në lidhje me çështjen përkatëse dhe të japë siguri të plotë se subjekti ka marrë hapat e duhur për të zgjidhur çështjen.

8. Ilustrime

Ilustrim 1: Dokumentacioni i Inspektimit

Inspektori duhet të përgatisë dokumentacionin për çdo inspektim, me detaje të mjaftueshme për të siguruar një kuptim të qartë të punës së kryer, provat e inspektimit të marrë dhe burimin e tij, si dhe përfundimet e arritura. Shkresat e inspektimit duhet të përfshijnë:

Manuali i Mbikëqyrjes për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimin e Terrorizmit

- Titullin, i cili përfshin emrin e siguruesit, titullin ose përshkrimin e shkresave, përmbajtjen e tyre dhe datën e hyrjes në fuqi të pasqyrave financiare të inspektuara;
- Procedurën, duke përshkruar qëllimin e shkresave me përshkrimet e testeve që do të kryhen;
- Burimin, duke vënë në dukje nga është marrë informacioni i dhënë dhe testuar në shkresa;
- Konkluzionin në lidhje me rezultatet e testimit të inspektimit dhe konkluzionet që mund të arrihen nga këto rezultate;
- Përmbylljen nga personi që e ka përgatitur, duke vënë në dukje datën kur ka përfunduar puna;
- Përmbylljen nga personi që e ka rishikuar, duke vënë në dukje datën kur është rishikuar puna.

Dokumentacioni i inspektimit mund të përfshijë, por nuk kufizohet me, programet e provimeve, analizat, problemet e memorandumëve, përmbledhjet e rezultateve apo çështjeve të rëndësishme, shkresat e konfirmimit dhe të përfaqësimit, listat e kontrollit, fragmentet ose kopjet e dokumentave të rëndësishëm, korrespondencën (duke përfshirë e-mail-et) në lidhje me rezultatet apo çështjet e rëndësishme dhe programet e punës së kryer nga ekzaminuesi.

Pjesë apo kopjet e regjistrave të entit (për shembull, kontrata dhe marrëveshje të rëndësishme dhe specifike) mund të përfshihen si pjesë e dokumentacionit, nëse ato janë të nevojshme për të mbështetur punën e kryer dhe konkluzionet e arritura. Çdo informacion i dhënë nga konsumatori duhet të shënohet si i tillë. Shpjegimet verbale në vetvete nuk janë mbështetje e mjaftueshme për të dokumentuar provat e inspektimit ose arritjen e konkluzioneve, por mund të përdoren nga inspektori për të sqaruar ose shpjeguar informacionin që gjendet në dokumentacionin.

Në përfundim, inspektori duhet të përgatisë dokumentacionin i cili i mundëson rishikuesit për të kuptuar:

- Natyrën, kohëzgjatjen dhe shtrirjen e procedurave të inspektimit të kryera në përputhje me standardet e inspektimit dhe kërkesat ligjore dhe rregullatore në fuqi;
- Pritshmëritë dhe rezultatet e procedurave të inspektimit të kryera dhe provat e marra;
- Konkluzionet e arritura për çështjet e rëndësishme;
- Se regjistrimet e siguruesit pranojnë ose pajtohen me pasqyrat financiare ose me informacionet e tjera të inspektimit.

Ilustrim 2: Qëllimi dhe Planifikimi i Inspektimit

Objektivi: Identifikimi i rreziqeve PPP/FT të subjektit, hartimi i fushës së inspektimit, dhe dokumentimi i planit. Ky proces përfshin përcaktimin e nevojave të stafit të inspektimit dhe ekspertizën teknike si dhe përzgjedhjen e procedurave të inspektimit që do të kryhen.

Profili Përmbledhës PPP/FT i Siguruesit

Profili Përmbledhës PPP/FT i Siguruesit do të derivojë nga regjistrimet e bazës së të dhënave, të grumbulluara brenda AMF-së.

Kuptimi i Strukturës PPP/FT të Drejtimit të Korporatës

Manuali i Mbikëqyrjes për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimin e Terrorizmit

Profili Përmbledhës PPP/FT i Siguruesit do të derivojë nga regjistrimet e bazës së të dhënave, të grumbulluara brenda AMF-së.

Për të lehtësuar kuptimin e një inspektori për profilin e rrezikut të subjektit dhe për të përcaktuar në mënyrë të përshtatshme qëllimin e inspektimit PPP/FT, inspektori duhet të përfundojë hapat e mëposhtëm, në lidhje me rishikimin e vlerësimit të rrezikut PPP/FT të subjektit:

1. Të rishikojë paraprakisht ekzaminimin ose raportet e inspektimit, shkresat e lidhura dhe përgjigjet e drejtuesve për të gjitha çështjet PPP/FT të identifikuar më parë; të identifikojë procedurat e përfunduara të inspektimit; të marrë informacionin e kontaktit PPP/FT; të identifikojë raportet dhe proceset që përdor subjekti për të zbuluar aktivitetin e pazakontë; të identifikojë operacionet e vëna më parë në dukje si me rrezik më të lartë në lidhje me shoqërinë; të rishikojë rekomandimet për inspektimin e ardhshëm. Përveç kësaj, të kontaktojë me drejtimin e shoqërisë, sipas rastit, për të diskutuar sa më poshtë:

- Programin e përputhshmërisë PPP/FT;
- Vlerësimin e rrezikut PPP/FT;
- Sistemet e monitorimit dhe të raportimit të aktiviteteve të dyshimta;
- Nivelin dhe shtrirjen e sistemeve të automatizuara PPP/FT.

Për temat e mësipërme, për udhëzime referojuni përmbledhjeve të duhura dhe seksioneve për procedurat e inspektimit në manual.

2. Hartohet lista e zërave PPP/FT, të cilët do të përfshihen në shkresën për kërkesën e integruar të inspektimit. Nëse pjesa PPP/FT e inspektimit është inspektim më vete, subjektit i dërgohet shkresa e kërkesës. Rishikohen dokumentet e shkresës së kërkesës të dhëna nga subjekti. *Referojuni Zërave të Shkresës së Kërkesës.*

3. Rishikohet korrespondenca që shoqëria apo AMF ka marrë nga ose ka dërguar në agjencitë e jashtme rregullatore dhe të zbatimit të ligjit në lidhje me përputhshmërinë PPP/FT. Komunikimet, veçanërisht ato të marra nga DPPP/FTP mund të dokumentojnë çështje në lidhje me inspektimin, të tilla si në vijim:

- Depozitohen gabimet për RAD-të, RTPF-të dhe përjashtimet RTPF të marra në formë elektronike nga DPPP;
- Penalitetet monetare civile të lëshuara ose në proces nga DPPP ose nga ndonjë ent tjetër qeveritar;
- Fletë thirrjet për zbatimin e ligjit ose konfiskimet;
- Rishikohen informacionet për RAD-të, RTPF-të dhe përjashtimet RTPF të marra nga baza e të dhënave të raportimit. Numri i RAD-ve, RTPF-ve dhe përjashtimet RTPF të depozituara duhet të merren për një periudhë kohore, sipas përcaktimit nga ekzaminuesi. Merret në konsideratë informacioni në vijim dhe analizohen të dhënat për modelet jo të zakonshme, si:

Manuali i Mbikëqyrjes për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimin e Terrorizmit

- Volumi i aktivitetit dhe nëse ai korrespondon me profesionin e konsumatorit ose me llojin e biznesit;
- Numri dhe volumi i transaksioneve në dollarë që përfshijnë konsumatorë me rrezik më të lartë;
- Volumi i RTPF-ve në lidhje me volumin e përjashtimeve (d.m.th., nëse përjashtimet shtesë të cilat rezultojnë në rënie të konsiderueshme të depozitimeve RTPF);
- Volumi i RAD-ve dhe RTPF-ve në lidhje me madhësinë e kompanisë, asetet ose rritjen e depozitave dhe vendndodhjen gjeografike.

4. Kontrolluesit nuk duhet të kritikojnë një kompani vetëm për shkak se numri i RAD-ve dhe RTPF-ve të depozituara është më i ulët se SAR-të dhe RTPF-të e depozituara nga kompanitë e "njëjta". Megjithatë, si pjesë e inspektimit, kontrolluesit duhet të rishikojnë ndryshimet domethënëse në volumin ose natyrën e SAR-ve dhe RTPF-ve të depozituara dhe të vlerësojnë arsyet e mundshme për këto ndryshime.

5. Rishikimi i raporteve të brendshme dhe të jashtme të auditimit dhe shkresat për përputhshmërinë PPP/FT, sipas nevojës, për të përcaktuar tërësinë dhe cilësinë e auditimeve, rezultatet, përgjigjet e menaxhimit dhe veprimin(et) korrigjues(e). Rishikimi i fushës së pavarur të auditimit, procedurat, dhe kualifikimet do të japin informacion të vlefshëm mbi përshtatshmërinë e programit të përputhshmërisë PPP/FT.

6. Edhe pse sanksionet e rregulloreve nuk janë pjesë e vlerësimit PPP/FT të sanksioneve, përputhshmëria e sanksioneve është përfshirë shpesh në inspektimet PPP/FT. Roli kryesor i AMF-së nuk është që të identifikojë shkeljet e sanksioneve, por që të vlerësojë mjaftueshmërinë e një subjekti për të zbatuar politikat, procedurat dhe proceset, për të siguruar përputhshmërinë me sanksione ligjore dhe me rregulloret. Për të lehtësuar kuptimin e inspektorit për profilin e rrezikut të subjektit dhe për të përcaktuar në mënyrën e duhur qëllimin e inspektimit të sanksioneve, inspektori duhet të kryejë hapat e mëposhtëm:

- Rishikohet vlerësimi i rrezikut të subjektit për sanksione. Vlerësimi i rrezikut, i cili mund të përfshihet në vlerësimin e përgjithshëm të rrezikut PPP/FT të shoqërisë, duhet të marrë parasysh llojet e ndryshme të produkteve, shërbimeve, konsumatorëve, subjekteve, transaksioneve dhe vendndodhjet gjeografike në të cilat subjekti është i angazhuar, duke përfshirë edhe ato që janë përpunuar nga ajo, nëpërmjet saj ose për subjektin, për të identifikuar ekspozimin e mundshëm ndaj sanksioneve;
- Rishikohet testimi i pavarur i subjektit për programin e saj të sanksioneve;
- Rishikohet korrespondenca e marrë nga lista e sanksioneve dhe, sipas nevojës, zona e penaliteteve civile për sanksione faqen e internetit të OKB-së, për të përcaktuar nëse subjekti ka pasur ndonjë shkresë paralajmëruese, gjoba ose penalitete të vendosura nga sanksionet që nga inspektimi më i fundit;
- Rishikohet korrespondenca ndërmjet subjektit dhe sanksioneve (p.sh, raportimi periodik i transaksioneve të ndaluara dhe, nëse zbatohet, sanksionet vjetore për pronat e bllokuara).

Manuali i Mbikëqyrjes për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimin e Terrorizmit

Përveç sa më sipër, në organizatat më të mëdha, më komplekse, inspektorët mund të kryejnë lloje të ndryshme të inspektimeve në të gjithë planin e mbikëqyrjes ose ciklit për të vlerësuar përputhshmërinë me sanksionet. Këto rishikime mund të përqendrohen në një ose më shumë linja të biznesit.

7. Në bazë të procedurave të mësipërme të inspektimit, në lidhje me rishikimin e vlerësimit të rrezikut PPP/FT të subjektit, zhvillohet një plan fillestar inspektimi. Inspektori duhet të dokumentojë planin në mënyrën e duhur, si dhe ndonjë ndryshim që mund të ndodhë në plan gjatë inspektimit. Procesi i studimit dhe planifikimit duhet të sigurojë që inspektori ka dijeni për programin e përputhshmërisë PPP/FT të shoqërisë, programin e përputhshmërisë me sanksionet, historikun e përputhshmërisë dhe profilin e rrezikut (p.sh.: produktet, shërbimet, konsumatorët, entet, transaksionet, dhe vendndodhjet gjeografike).

Sipas nevojës, mund të kryejnë procedurat kryesore dhe shtesë të zgjeruara të inspektimit. Ndërkohë që plani i inspektimit mund të ndryshojë në çdo kohë, për shkak të rezultateve në vend, vlerësimi fillestar i rrezikut do t'i mundësojë inspektorit që të krijojë një fushëveprim të pranueshëm për rishikimin PPP/FT. Me qëllim që procesi i inspektimit të jetë i suksesshëm, inspektorët duhet të mbajnë komunikim të hapur me menaxhimin e shoqërisë dhe të diskutojnë shqetësimet e rëndësishme që do të lindin.

Ilustrim 3: Memorandumi i Planifikimit të Inspektimit

Nga AMF mund të kryhet inspektim në bashkëpunim me DPPP, por edhe, inspektim i plotë, veçmas nga Autoriteti, për PPP/FT. Inspektimi duhet të përfshijë procedurat e mëposhtme të drejtuara për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit:

1. Kryerja e një interviste të shkurtër me punonjës in e përputhshmërisë përgjegjës për zbatimin dhe monitorimin e përputhshmërisë me programin PPP/FT të subjektit. Nëse punonjësi i përputhshmërisë delegon përgjegjësi të caktuara te punonjësit e tjerë, mund të jetë e përshtatshme kryerja e intervistave edhe me ata;

Temat e intervistës duhet të përfshijnë, megjithëse nuk do të kufizohen vetëm me mbikëqyrjen e përputhshmërisë së përditshme me kërkesat e PPP/FT, përmbajtjen e programit PPP/FT të subjektit, vlerësimin e rrezikut, programin e trajnimit dhe planet e pavarura të testimit, dhe se si e monitoron dhe e kontrollon subjekti veprimtarinë e agjentëve të tij. Intervista duhet gjithashtu të mbulojë politikat dhe procedurat për zbulimin, monitorimin dhe raportimin e aktivitetit të dyshimtë. Kjo përfshin politikat vendim-marrëse të subjektit për raportimin e aktivitetit të dyshimtë kur identifikohen “red flags”. Përfundimisht, kontrolluesi duhet të sigurojë që subjekti i ka vendosur procedurat për raportimin e marrjes së pagesave në para fizike, të cilat kalojnë vlerën e përcaktuar në Ligjin PPP/FT. Subjekti mund të raportojë te DPPP Form _____ (*Shih: ëëë.generaldirectorate.gov.al ëëë.fint.gov.al*) kur ai (ose agjentët e tij) marrin para të cilat kalojnë vlerën e përcaktuar në Ligjin PPP/FT, në një transaksion të vetëm apo dy ose më shumë transaksione të lidhura. Inspektori, për të verifikuar që ata janë adresuar në vlerësimin e rrezikut të subjektit duhet të dokumentojë çdo rrezik të rëndësishëm që lidhet me aktivitetet e pastrimit të parave. Gjatë intervistës, inspektori duhet të verë re nëse Punonjësi i Përputhshmërisë është bërë më pak i sqartë, ka dhënë informata të rreme ose të gabuara, duket se i mungon kuptimi i rreziqeve të subjektit në lidhje me aktivitetet e pastrimit të parave apo ka lënë pas dore informacionet materiale në lidhje me parandalimin e pastrimit të parave që duhet të zbulohen në

Manuali i Mbikëqyrjes për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimin e Terrorizmit

Drejtorinë e Përgjithshme për shqyrtim të mëtejshëm;

2. Merret një kopje e programit të shkruar PPP/FT dhe verifikohet që ai përfshin përbërësit e nevojshëm të diskutuar në pikat e mësipërme. Gjithashtu, verifikohet që menaxhimi i lartë e ka miratuar programin;
3. Merren kopje të vlerësimit të rrezikut të subjektit, të planeve të pavarura të testimit dhe rezultatet e testimit të kryer dhe rishikohen për ndonjë çështje të rëndësishme. Megjithatë programi PPP/FT duhet të jetë me shkrim, subjekteve nuk ju kërkohet me rregullore të bëjnë vlerësim me shkrim të rrezikut. Megjithatë, menaxhimi është i nxitur për të dokumentuar me shkrim vlerësimin e tij të rrezikut, me qëllim që të japë një bazë të qartë për politikën dhe procedurat e subjektit. Inspektorët duhet të marrin në konsideratë nëse procesi i shoqërisë për rishikimin dhe përditësimin periodik të vlerësimit të rrezikut të saj është i përshtatshëm. Programi PPP/FT i subjektit duhet të jetë konform me:
 - Rreziqet e paraqitura nga madhësia e subjektit;
 - Natyra dhe volumi i produkteve të mbuluara që ofron; dhe
 - Kanalet e shpërndarjes që përdor ajo për të tregtuar produktet e mbuluara. Në vlerësimin e saj të rrezikut, çdo subjekt duhet të identifikojë dhe të vlerësojë rreziqet e pastrimit të parave të cilat mund të shoqërohen me kategoritë e saj të rrezikut (d.m.th., kombinimin unik të produkteve të mbuluara, shërbimeve, konsumatorëve/klientëve dhe vendndodhjet gjeografike të tyre, kanalet e shpërndarjes, kontrollet e brendshme, etj.).

Subjekti duhet të zhvillojë një analizë më të detjuar të këtyre kategorive, ashtu si zbatohen ato për subjektin me qëllim që të vlerësohen rreziqet e shoqëruara me çdo kategori të rrezikut. Inspektori duhet të rishikojë vlerësimin e rrezikut në tërësi, për të përcaktuar nëse menaxhimi ka marrë në konsideratë dhe ka vlerësuar të gjitha kategoritë e përshtatshme të rrezikut. Racionalja për frekuencën e testimit të pavarur duhet të përfshihet në vlerësimin e rrezikut.

Ilustrim 4: Matrica e rrezikut PPP/FT të Subjektit

Nr.	Faktori	Klasifikimi		
		I ulët	I mesëm	I lartë

Manuali i Mbikëqyrjes për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimin e Terrorizmit

Nr.	Faktori	Klasifikimi		
		I ulët	I mesëm	I lartë
1	PShB¹⁹ i Përgjithshëm	PShB i ulët	PShB i mesëm	PShBi lartë
2	Rreziku i Produktit	Mundësia që produktet janë ofruar për pastrimin e parave është e ulët, psh, nuk ka asnjë element paraje fizike, nuk ka fleksibilitet, nuk ka përdorim si kolateral, etj.	Produkti përfshin disa rreziqe për pastrimin e parave, megjithatë rreziqet janë të kufizuara, dmth, ato ofrojnë fleksibilitet të kufizuar (mundësi të kufizuar dorëzimi), dhe nuk mund të përdoren si kolateral, për pagesa ose për vetë-shërbim të konsumatorëve	Produktet përfshijnë rrezik të lartë për pastrimin e parave (d.m.th., ato ofrojnë fleksibilitet të investimeve dhe të dorëzimit, pagesave, përdorimit si kolateral, vetë-shërbimit të konsumatorëve)
3	Paqëndrueshmëria me bazë konsumatorin	Baza e qëndrueshme, e njohur mirë e konsumatorit në një mjedis të lokalizuar.	Baza e konsumatorit ndryshon për shkak të degëzimit, bashkimit ose blerjes në tregun e brendshëm	Një bazë e madhe, e luhatshme e konsumatorit në një mjedis ndërkombëtar.
4	Bazë ndërkufitare e konsumatorit	Bazë tërësisht vendase e konsumatorit ose numër i parëndësishëm i konsumatorëve jo-vendas. Portofoli i konsumatorëve jo-vendas nuk është i rëndësishëm	Bazë përgjithësisht vendase e konsumatorëve, me një numër përjashtimesh. PShB e konsumatorëve jo-vendas është e pakonsiderueshme në krahasim me PShB -në e përgjithshme.	Një numër i konsiderueshëm i konsumatorëve është jo-vendas. PShB e konsumatorëve jo-vendas është e konsiderueshme.

¹⁹ Vetëm për shoqëritë/agjentët e sigurimit të Jetës.

Manuali i Mbikëqyrjes për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimin e Terrorizmit

Nr.	Faktori	Klasifikimi		
		I ulët	I mesëm	I lartë
5	PShB nga konsumatorët me rrezik të lartë	Përqindje e parëndësishme e PShB -së (krahasuar me regjistrin e plotë të siguruesit) nga konsumatorët me rrezik të lartë (sipas kategorve të rrezikut të siguruesit)	Përqindje mesatare të PShB -së nga konsumatorët me rrezik të lartë.	Përqindje të rëndësishme të PShB -së nga konsumatorët me rrezik të lartë.
6	Zërat e raportit të Auditit të Brendshëm	Nuk ka gjetje të rëndësishme në termat PPP/FT dhe në sanksionet që nga raportet e auditimeve të mëparshme të brendshme.	Disa gjetje të rëndësishme në termat PPP/FT dhe në sanksionet që nga raportet e auditimeve të mëparshme të brendshme.	Numër i lartë i gjetjeve të rëndësishme në termat PPP/FT dhe në sanksionet që nga raportet e auditimeve të mëparshme të brendshme.
7	Zërat e raportit të Auditit të Jashtëm	Nuk ka gjetje të rëndësishme në termat PPP/FT dhe në sanksionet që nga raportet e auditimeve të mëparshme të jashtme.	Disa gjetje të rëndësishme në termat PPP/FT dhe në sanksionet që nga raportet e auditimeve të mëparshme të jashtme.	Numër i lartë i gjetjeve të rëndësishme në termat PPP/FT dhe në sanksionet që nga raportet e auditimeve të mëparshme të jashtme.
8	Rezultatet e inspektimeve të mëparshme nga AMF ose DPPPPja	Nuk ka gjetje të rëndësishme në termat PPP/FT dhe në sanksione që nga raportet e auditimeve të mëparshme rregullatore.	Disa gjetje të rëndësishme në termat PPP/FT dhe në sanksionet që nga raportet e auditimeve të mëparshme rregullatore.	Numër i lartë i gjetjeve të rëndësishme në termat PPP/FT dhe në sanksionet që nga raportet e auditimeve të mëparshme rregullatore.
9	Numri i SAR-ve	Në 12 muajt e fundit nuk ka RAD	Numër mesatar i RAD-ve në 12 muajt e fundit	Numër i lartë i RAD-ve në 12 muajt e fundit
10	Numri i RTPF-ve (transaksione në para fizike > 1 milion Lekë)	Në 12 muajt e fundit nuk ka RTPF	Numër mesatar i RTPF-ve në 12 muajt e fundit	Numër i lartë i RTPF-ve në 12 muajt e fundit

Manuali i Mbikëqyrjes për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimin e Terrorizmit

Nr.	Faktori	Klasifikimi		
		I ulët	I mesëm	I lartë
11	Niveli i kontrolleve të automatizuara	Një sasi e madhe kontrollesh të brendshme për termat PPP/FT dhe të sanksioneve janë automatizuar	Një sasi kontrollesh të brendshme për termat PPP/FT dhe të sanksioneve janë automatizuar	Nivel i ulët i automatizimit të kontrolleve për termat PPP/FT dhe sanksionet
12	Niveli i stafit PPP/FT / Sanksioneve	Nivel i lartë i Përputhshmërisë / EKP-të Ligjore (që i përkasin PPP/FT-së dhe sanksioneve) krahasuar me stafin në total.	Nivel mesatar i Përputhshmërisë / EKP-të Ligjore (që i përkasin PPP/FT-së dhe sanksioneve) krahasuar me stafin në total.	Nivel i ulët i Përputhshmërisë / EKP-të Ligjore (që i përkasin PPP/FT-së dhe sanksioneve) krahasuar me stafin në total.

Ilustrim 5: Lista e Plotë e Planifikimit të Inspektimit – On site/në terren

	Po/ Jo	Inspektori	Data
1. Drejtimi			
a. Tre Linja për Justifikim, si model			
b. Punonjësi i caktuar për Parandalimin e Pastrimit të Parave (PPP/FTPP)			
c. Akses i PPP/FTP -së tek CEO-ja i Njesisë së Biznesit			
d. Pavarësia e Përputhshmërisë nga Biznesi (Linja e 1 ^{re} e Mbrojtjes)			
e. Roli & përgjegjësitë e Biznesit (Linja e 1 ^{re} e Mbrojtjes)			
f. Roli & përgjegjësitë e Përputhshmërisë (Linja e 2 ^{te} e Mbrojtjes)			
2. Trajnimi & Njohuritë			
a. Trajnim i përgjithshëm për të gjithë punonjësit			

Manuali i Mbikëqyrjes për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimin e Terrorizmit

	Po/ Jo	Inspektori	Data
b. Trajnim i përgatitur për punonjësit me ekspozim të veçantë ndaj PPP/FT-së			
c. Mbikëqyrja & mbajtja e regjistrimeve për pjesëmarrjen në trajnim			
d. Testimi i përfshirë në trajnim			
e. Mbajtja e regjistrimeve për rezultatet e testimit			
3. Vlerësimi i Rrezikut & Kategorizimi i Rrezikut			
a. Vlerësimi i rreziqeve PPP/FT të pandara nga Njësia e Biznesit) rreziqet që vijnë nga llojet e konsumatorëve, produktet dhe shërbimet, kanalet e shpërndarjes, gjeografisë etj.)			
b. Kategorizimi i Rreziqeve të marrëdhënieve të konsumatorëve (bazuar në faktorët e pandarë të rrezikut)			
c. Kategorizimi i Rreziqeve të transaksioneve (bazuar në faktorët e pandarë të rrezikut)			
d. Dokumentimi i vlerësimit të rrezikut dhe arsyetimi për kategorizimin e rrezikut			
4. Kujdesi i Duhur			
a. Identifikimi dhe verifikimi i identitetit të konsumatorit			
b. Verifikimi i zotëruesit të përfitimeve ose përfituesit			
c. Personat e Ekspozuar Politikisht (PEP-të): kontrolli i emrave, kategorizimi i rrezikut, lista e PEP-ve			
d. Zbatimi i faktorëve të rrezikut në marrëdhëniet e konsumatorit			
e. Kujdesi i duhur në rritje për marrëdhëniet e konsumatorit / transaksionet me rrezik të rritur			
f. Miratimi i Menaxhimit Lokal për marrëdhëniet e konsumatorit që zhvillojnë disa kategori të rrezikut të rritur (p.sh. PEP-të)			
g. Kujdesi i duhur në vazhdimësi për marrëdhëniet e konsumatorit			

Manuali i Mbikëqyrjes për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimin e Terrorizmit

	Po/ Jo	Inspektori	Data
h. Dokumentimi i NKT-ve			
i. Dokumentimi i kujdesit të duhur në rritje			
j. Dokumentimi i kujdesit të duhur në vazhdimësi			
k. Kujdesi i duhur / kontrollet në lidhje me ndërmjetësit			
l. Transferimet e kufizuara të fondeve në përputhje me Politikën ekzistuese PPP/FT			
m. Monitorimi i transaksionit të konsumatorit			
n. Shqyrtimet e përmirësuara për transaksionet me rrezik të rritur			
5. Kontrollet			
a. Struktura e kontrolleve (politikat & procedurat)			
b. Kontrollet PPP/FT të kryera nga Biznesi (executed by the Business (Linja e 1 ^{re} e Mbrojtjes)			
c. Kontrollet PPP/FT të kryera nga Përputhshmëria (Linja e 2 ^{te} e Mbrojtjes)			
6. Shkallëzimi & Raportimi			
a. Raportimi i rregullt për një vështrim të përgjithshëm të Përputhshmërisë			
b. Raportimi i rregullt për Menaxhimin lokal dhe global të Biznesit			
c. Procesi i shkallëzimit në rast se punonjësit marrin njohuri për aktivitetet e dyshimta			
d. Raportimi i RAD/RTD për AMF-në/DPPP/FTP-në			
e. Dokumentimi i shkallëzimit/raportimit të SAR-ve			
7. Dokumentimi & Ruajtja e Regjistrimeve			
a. Dokumentimi			

Manuali i Mbikëqyrjes për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit

	Po/ Jo	Inspektori	Data
b. Ruajtja e Regjistrimeve			
8. Mbikëqyrja			
a. Vetëvlerësimi i strukturës së Përputhshmërisë			
b. Dokumentimi i vetëvlerësimit			
Komente Shtesë:			

Ilustrim 6: Draft-Letra për Drejtuesit

I Nderuar [emri i Menaxherit të Lartë]

Ne kemi përfunduar inspektimin tonë për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe financimit të terrorizmit në [vendosni emrin e Shoqërisë së Sigurimeve] në [Datën] dhe informacionin tjetër përkatës në lidhje me Subjektin. Ne kemi identifikuar çështjet dhe shqetësimet e mëposhtme në lidhje me operacionet ose praktikatat specifike ose praktikave të subjektit për të cilat kërkojmë që të merrni veprimet korrigjuese.

Për çdo zë/çështje, theksohet:

- Përcaktohet çështja duke përdorur një paraqitje koncize të problemit të identifikuar;
- Ilustrohet efekti i kësaj çështjeje duke përfshirë rëndësinë e ndikimit dhe çfarë ndikimi ka pasur ose mund të ketë në pasqyrat financiare, në gjendjen financiare të shoqërisë ose në operacionet e saj;
- Përcaktohet se çfarë duhet bërë (rekomandimet). Subjekti duhet të udhëzohet që të ndërmarrë veprimet [brenda një kuadri kohor të përcaktuar] për të zgjidhur çështjen(t);
- Jepni një afat për përgjigjen e subjektit, p.sh., “ju lutemi njoftoni AMF-në në [datën] sesi e keni zgjidhur ose synoni të zgjidhni këtë çështje(t) me planin e propozuar për konsideratën tonë.

Sinqerisht,

Inspektori

cc: Kryetar, Këshilli Mbikëqyrës

Manuali i Mbikëqyrjes për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit

Ilustrim 7: Lista e Plotë e Inspektimit PPP/FTFAZA I: Vlerësimi i Rrezikut, Mbledhja e Informacioneve përpara Inspektimit dhe Analiza Paraprake

Faza e parë është faza që ezaurohet me përmbushjen e detyrimit që rrjedh nga Rregullorja nr. 58, datë 30.06.2015 “Mbi masat e vigjilencës së duhur dhe të zgjeruar nga subjektet e ligjit mbi parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, e ndryshuar. Referuar Nenit 11, paragrafit 2, të rregullores 58/2015, subjektet kanë detyrimin të raportojnë pranë Autoritetit mbi baza vjetore të dhënat e kërkuara sipas Aneksve 4 dhe 5, brenda 30 ditëve pas mbylljes së vitit kalendarik.

- Aneks-i 4 ka të bëjë me kategorizimin e klientëve sipas rrezikut, kategorizimin e transfertave si dhe çdo të dhënë shtesë mbi subjektet që i nënshtrohen ligjit mbi pastrimin e parave;
- Aneks-i 5 është “Pyetësor për Parandalimin e Pastrimit të Parave (PPP)/ Parandalimin e Financimit të Terrorizmit (PFT)”. Ky pyetësor ndahet në dy pjesë. Pjesa e parë përfshin informacion të përgjithshëm për subjektin, ndërsa pjesa e dytë është pyetësori “Njih klientin tënd (NKT) / kërkesa për Parandalimin e Pastrimit të Parave (PPP) / për Parandalimin e Financimit të Terrorizmit (PFT).

Tabelat ilustruese të matjes së riskut sipas formularëve të vetëvlerësimit depozituar pranë AMF-s, gjendet në Udhëzuesin “Për matjen e rrezikut nga pastrimi i parave dhe financimi i terrorizmit”, bashkëngjitur Rregullores.

Udhëzuesi “Për matjen e rrezikut nga pastrimi i parave dhe financimi i terrorizmit”, përcakton mënyrën e matjes së rreziqeve përkatëse, duke u bazuar mbi faktorët e jashtëm dhe të brendshëm, nivelin e rrezikut për secilin faktor. Nëpërmjet këtij udhëzuesi synohet përcaktimi i nivelit të përgjithshëm të rrezikut për secilin subjekt, duke u bazuar në një matricë të riskut neto, i cili përcaktohet si një kombinim i nivelit të riskut të jashtëm dhe atij të brendshëm.

Tabela : Matrica e vlerësimit të kriterit

Risku i Jashtëm	Raportim në DPPP	I Lartë	Rapotim në DPPP	Rapotim në DPPP
	I Lartë	I Mesëm	I Lartë	I Lartë
	I Mesëm	I Ulët	I Mesëm	I Lartë
	I Ulët	I Ulët	I Ulët	I Mesëm
	I Ulët		I Mesëm	I Lartë
Risku i Brendshëm				

Manuali i Mbikëqyrjes për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimin e Terrorizmit

FAZA II: Qëllimi dhe Planifikimi i Inspektimit

		Inspektori	Data
Objekti: Identifikimi i rreziqeve PPP/FT të kompanisë dhe zhvillimi i fushëveprimit të inspektimit.			
Hapat:			
1.	Rishikimi paraprak i raporteve të inspektimit, shkresave përkatëse dhe përgjigjet e menaxhimit për çdo çështje të identifikuar paraprakisht me AMF-në ose me Drejtorinë e Përgjithshme; identifikimi i procedurave të përfunduara të inspektimit; marrja e informacionit të kontaktit; identifikimi i raporteve dhe proceseve që shoqëria përdor për të zbuluar aktivitetin e pazakontë; identifikimi i operacioneve me rrezik të lartë për kompaninë, të konstatuara më përpara. Në vazhdim, kontaktohet me Shefin e Përputhshmërisë të Siguruesit dhe/ose Menaxhimin si e përshtatshme për të diskutuar sa më poshtë:		
	• Vlerësimi i rrezikut PPP/FT;		
	• Programi i përputhshmërisë PPP/FT;		
	• Ndryshimet në politikat, procedurat dhe kontrollet PPP/FT të kompanisë;		
	• Ndjekja e çështjeve të identikuara më përpara nga AMF dhe/ose Drejtoria e Përgjithshme;		
	• Ndryshimet në panoramën/tablonë dhe në shifrat e produktit të Siguruesit në lidhje me konsumatorët, Primet e Shkruara Bruto, konsumatorët me rrezikshmëri të lartë, etj.;		
	• Monitorimi i aktivitetit të dyshimtë dhe sistemet e raportimit;		
	• Niveli dhe shtrirja e sistemeve PPP/FT të automatizuara.		
2.	Zhvillohet një listë e zërave PPP/FT, të cilët do të përfshihen në shkresën e kërkesës për inspektim të integruar. Në qoftë se pjesa e inspektimit PPP/FT është një inspektim i veçantë, shkresa e kërkesës i dërgohet Zyrtarit të Përputhshmërisë ose zyrtarit të caktuar subjektivit. Rishikohen dokumentat e shkresës së kërkesës të dhëna nga subjektivit.		
3.	Rishikohet korrespondenca midis kompanisë dhe AMF-së, nëse tashmë nuk është kompletuar nga inspektori në detyrë ose nga personeli tjetër i dedikuar për inspektimin. Në vazhdim, rishikohet korrespondenca që subjekti ka marrë nga ose ka dërguar në agjencitë e tjera rregullatore dhe të zbatimit të ligjit, në lidhje me përputhshmërinë PPP/FT. Komunikimet, në veçanti ato që janë marrë nga Drejtoria e Përgjithshme mund të dokumentojnë çështje në lidhje me inspektimin, si këto më poshtë:		
	• Depozitohen gabimet për RAD (SAR-të) dhe RTPF-të e marra në formë elektronike nga Drejtoria e Përgjithshme;		
	• Penalitetet monetare civile të lëshuara ose në proces nga Drejtoria e Përgjithshme;		
	• Fletëthirrjet në zbatim të ligjit ose konfiskimet.		
4.	Rishikohet informacioni i RADve dhe i RTPF-ve, i marrë nga baza e të dhënave të raportimit PPP/FT brenda AMF-së. Kërkohen të dhënat përkatëse nga Drejtoria e Përgjithshme, nëse është e mundur. Numri i SAR-ve dhe RTPF-ve të depozituara duhet të merret për një periudhë kohore të caktuar, sipas përcaktimit nga inspektori. Merrni në konsideratë informacionin e mëposhtëm dhe analizonitë të dhënat për modelet jo të zakonshme:		
	• Volumi i aktivitetit dhe nëse ai është i përpjesëtueshëm me profesionin e konsumatorit ose me llojin e biznesit;		
	• Numri dhe volumi i transaksioneve ku përfshihen konsumatorë me rrezik të lartë;		
	• Volumi i RAD (SAR-ve) dhe RTPF-ve në lidhje me madhësinë e kompanisë, asetet ose rritjen e		

Manuali i Mbikëqyrjes për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimin e Terrorizmit

	depozitave dhe vendndodhjen gjeografike.		
	Si pjesë e inspektimit, inspektorët duhet të rishikojnë ndryshimet e rëndësishme në volumin ose natyrën e RAD (SAR-ve) dhe RTPF-ve të depozituara dhe të vlerësojnë arsyet e mundshme për këto ndryshime		
5.	Rishikohen raportet e auditit të brendshëm e të jashtëm dhe shkresat për përputhshmërinë PPP/FT, sipas nevojës, për të përcaktuar gjithëpërfshirjen dhe cilësinë e auditimeve, rezultateve dhe përgjigjet e menaxhimit dhe veprimet korrigjuese. Një rishikim i fushëveprimit të pavarur të auditimit, procedurave dhe kualifikimeve do të japë informacion të vlefshëm për përshtatshmërinë e programit të përputhshmërisë PPP/FT.		
6.	Sanksionet: Ndërkohë që rregulloret e sanksioneve nuk janë pjesë e vlerësimit PPP/FT, përputhshmëria e sanksioneve është e përfshirë rregullisht në inspektimet PPP/FT. Për të lehtësuar kuptueshmërinë e profilit të rrezikut të kompanisë nga inspektori dhe për të vendosur në mënyrë të përshtatshme fushëveprimin e inspektimit të sanksioneve, inspektori duhet të plotësojë hapat e mëposhtëm:		
	Rishikohet vlerësimi i rrezikut të sanksioneve të kompanisë. Vlerësimi i rrezikut, i cili mund të jetë i inkorporuar në vlerësimin e përgjithshëm PPP/FT të kompanisë, për të identifikuar ekspozimin e mundshëm ndaj sanksioneve duhet të marrë në konsideratë llojet e ndryshme të produkteve, shërbimeve, konsumatorëve, enteve, transaksioneve dhe vendndodhjeve në të cilat është e angazhuar subjekti, duke përfshirë ato të cilat janë përpunuar nga ajo, nëpërmjet saj ose në kompani;		
	Rishikohet testimi i pavarur i kompanisë për programin e saj të përputhshmërisë me sanksionet;		
	Rishikohet korrespondenca e marrë në lidhje me përputhshmërinë me sanksionet dhe, sipas nevojës, zona e penaliteteve civile në Faqen e internetit të Kombeve të Bashkuara për sanksionet http://ëëë.un.org/sc/committees/list_compand.shtml për të përcaktuar nëse shoqëria ka ndonjë shkresë paralajmëruese, gjopa ose penalitete të vendosura nga sanksionet që nga inspektimi më i fundit.		
7.	Në bazë të procedurave të përmendura më sipër, në ndërthurje me rishikimin evlerësimit të rrezikut PPP/FT të shoqërisë, zhvillohet një plan fillestar inspektimi. Inspektori duhet të dokumentojë në mënyrë të përshtatshme planin, si dhe të gjitha ndryshimet që kanë ndodhur në plan gjatë inspektimit.		
	Procesi i planifikimit dhe i përcaktimit të fushëveprimit duhet të sigurojë që inspektori është i njohur me programin e përputhshmërisë PPP/FT të kompanisë, programin e përputhshmërisë me sanksionet, historinë e përputhshmërisë dhe profilin e rrezikut (d.m.th., produktet, shërbimet, konsumatorët, entet, transaksionet dhe vendndodhjet gjeografike).		
	Sipas nevojës, duhet të kryhen procedura shtesë dhe të zgjeruara të inspektimit kryesor. Ndërkohë që plani i inspektimit mund të ndryshojë në çdo kohë si rezultat i konstatimeve në vend, vlerësimi fillestar i rrezikut do t'i mun dësojë inspektorit të krijojë një fushëveprim të arsyeshëm për rishikimin e PPP/FT-së.		
	Me qëllim që procesi i inspektimit të jetë i suksesshëm, inspektorët duhet të mbajnë komunikim të hapur me menaxhimin e kompanisë dhe të diskutojnë shqetësimet përkatëse sipas rastit.		

FAZA III: Inspektimi *On site/në terren*

	Inspektori	Data
Kuadri i Punës dhe Politika e Përputhshmërisë PPP/FT Objekti: Të vlerësohet mjaftueshmëria e kuadrit të punës për përputhshmërinë PPP/FT të subjektit. Përcaktohet nëse subjekti ka zhvilluar, administruar dhe mbajtur një kuadër pune efektiv për përputhshmërinë me PPP/FT-në dhe të gjitha rregulloret për zbatimin e saj.		

Manuali i Mbikëqyrjes për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimin e Terrorizmit

<u>Procedurat e Inspektimit:</u>			
1.	Zhvillohet një intervistë e shkurtër me Zyrtarin e Përputhshmërisë ose me personin tjetër, përgjegjës për zbatimin dhe monitorimin e përputhshmërisë me programin PPP/FT të kompanisë. Në qoftë se Zyrtari i Përputhshmërisë delegon disa përgjegjësi te punonjësit e tjerë, është e përshtatshme që gjithashtu të zhvillohen intervista me ta.		
2.	Rishikohet politika e përputhshmërisë PPP/FT, e miratuar me shkrim nga bordi ose menaxhimi i kompanisë për të siguruar që përmban elementet e mëposhtëm të kërkuar: • “Rëndësia në krye”, d.m.th., deklarata e përgjithshme për parimet e subjektit në luftën për parandalimin e pastrimit të parave & aktiviteteve terroriste; • Përkufizimi i përgjegjësive të CEO-s (për udhëzime të detajuara referohuni në seksionin përkatës në Manualin e Inspektimit PPP/FT); • Përkufizimi i përgjegjësive të Bordit të Mbikëqyrjes (për udhëzime të detajuara referohuni në seksionin përkatës në Manualin e Inspektimit PPP/FT); • Përkufizimi i përgjegjësive të Zyrtarit të Përputhshmërisë PPP/FT (për udhëzime të detajuara referohuni në seksionin përkatës në Manualin e Inspektimit PPP/FT); • Sistemi i procedurave dhe kontrolleve të brendshme për të siguruar përputhshmërinë PPP/FT në vijim, në veçanti në lidhje me: ▪ Nenet 4 – 5: Kujdesi i Duhur dhe dokumentacioni i nevojshëm për identifikimin e konsumatorit; ▪ Nenet 8 – 9: Kategorizimi i rrezikut në lidhje me konsumatorët dhe transaksionet; ▪ Neni 7: Kujdesi i Duhur në rritje; ▪ Monitorimi nga Punonjësi i Përputhshmërisë PPP/FT; ▪ Nenet 12 – 15: Detyrimet për të Raportuar; ▪ Nenet 16: Detyrimi për mbajtjen e të dhënave. • Trajnimi dhe arsimimi periodik për personelin e duhur • Raportimi i përshtatshëm PPP/FT në Bordin e Mbikëqyrjes ose në menaxhimin e lartë		
3.	Merret një kopje e shkruar e programit PPP/FT dhe verifikohet nëse përfshihen përbërësit e nevojshëm të diskutuar më sipër. Verifikohet gjithashtu që edhe Bordi i Mbikëqyrjes edhe menaxhimi i lartë e kanë miratuar programin.		
4.	Merren kopjet e vlerësimit të rrezikut të kompanisë, planet e pavarura të testimit dhe rezultatet e testimit të kryer dhe rishikohen për të gjitha çështjet e rëndësishme. Inspektori duhet të rishikojë vlerësimin e rrezikut në tërësi, me qëllim që të përcaktojë nëse menaxhimi ka marrë në konsideratë dhe ka vlerësuar në mënyrën e duhur të gjitha kategoritë e duhura të rrezikut (produktet, shërbimet, konsumatorët, entet dhe vendndodhjet gjeografike).		
5.	Përgjegjësitë Zhvillohet intervistë me Bordin e Mbikëqyrjes të kompanisë, CEO-n dhe Zyrtarin e Përputhshmërisë PPP/FT. Vlerësohet nëse këta kanë kuptueshmërinë e duhur të: • Rreziqet PPP/FT të subjektit; • Kërkesat rregullatore sipas përcaktimit në Ligjin PPP/FT të Shqipërisë; • Politikat PPP/FT të subjektit; • Kontrollat dhe procedurat e subjektit, përfshirë trajnimin. Nëse ndonjë nga këto funksione delegon përgjegjësi të caktuara te punonjësit e tjerë, mund të jetë e përshtatshme që të zhvillojë intervista edhe me këta. Temat e intervistës duhet të përfshijnë, por pa u kufizuar me: • Vështrimin përgjithshëm të përditshëm të përputhshmërisë me kërkesat PPP/FT; • Përmajtjet e programit PPP/FT të subjektit, vlerësimin e rrezikut, programin e trajnimit dhe		

Manuali i Mbikëqyrjes për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit

	planet e pavarura të testimit; dhe Si e monitoron dhe e kontrollon subjekti aktivitetin e agjentëve të saj.		
	Inspektimi duhet të mbulojë gjithashtu rolin e Punonjësit të Përputhshmërisë PPP/FT në lidhje me zbulimin, monitorimin dhe raportimin e aktivitetit të dyshimtë. Kjo përfshin politikat e vendim-marrjes të kompanisë për raportimin e aktivitetit të dyshimtë kur identifikohen “red flags”.		
	Inspektimi duhet të mbulojë gjithashtu rolin e Punonjësit të Përputhshmërisë PPP/FT në lidhje me zbulimin, monitorimin dhe raportimin e aktivitetit të dyshimtë. Kjo përfshin politikat e vendim-marrjes të kompanisë për raportimin e aktivitetit të dyshimtë kur identifikohen “red flags”. Përfundimisht, inspektori duhet të sigurojë që shoqëria ka vendosur procedura për të raportuar transaksionet në para fizike në një shumë më të madhe ose të barabartë me shumën e caktuar në Ligjin PPP/FT <i>Faktorë të mëtejshëm për rishikim:</i>		
	Përcaktohet nëse bordi i drejtorëve ka përcaktuar një person ose persona përgjegjës për programin e përgjithshëm të përputhshmërisë PPP/FT. Përcaktohet nëse zyrtari i përputhshmërisë ka autoritetin dhe burimet e nevojshme për të kryer me efikasitet të gjitha detyrat;		
	Vlerësohet kompetenca e zyrtarit të përputhshmërisë stafit të tij/saj, sipas nevojës. Përcaktohet nëse zona e përputhshmërisë PPP/FT është me stafin e mjaftueshëm për nivelin e përgjithshëm të rrezikut të kompanisë (bazuar në produktet, shërbimet, konsumatorët, entet dhe vendndodhjet gjeografike), madhësinë dhe nevojat e përputhshmërisë PPP/FT. Në vazhdim, sigurohet që nuk ekzistojnë konflikte interesi dhe që stafit i është dhënë koha e mjaftueshme për të kryer të gjitha detyrat;		
	Gjatë intervistës, inspektori duhet të ketë parasysh nëse zyrtari i përputhshmërisë: (a) nuk është mjaftueshëm i sigurtë, (b) ka dhënë informacion të rremë ose të gabuar, (c) duket se i mungojnë njohuritë për rreziqet e shoqërisë ndaj aktiviteteve të pastrimit të parave ose (d) ka lënë jashtë informacion material të lidhur për parandalimin e pastrimit të parave, i cili duhet t'i ishte bërë i ditur Drejtorisë së Përgjithshme për konsideratë të mëtejshme.		
Trajnimi <u>Objekti:</u> Të përcaktohet nëse elementet e rëndësishëm të një programi trajnues PPP/FT janë drejtuar në mënyrë të përshtatshme në programin dhe në materialet e trajnimit dhe nëse trajnimi është realizuar dhe dokumentuar dhe nëse është ndjekur mos-pjesëmarrja. <u>Procedura e Inspektimit:</u>			
1.	Verifikohet nëse subjektit i mbështet kërkesat e mëposhtme tipike të një programi trajnues PPP/FT: - Rëndësia e Bordit të Mbikëqyrjes dhe vendi i menaxhimit të lartë në zhvillimin e arsimit, trajnimin dhe përputhshmërinë; - Llogaridhënia e punonjësve për të siguruar përputhshmërinë PPP/FT; - Gjithëpërfshirja e trajnimit, marrja në konsideratë e rreziqeve specifike të linjave individuale të bizneseve; - Trajnimi i stafit nga të gjitha fushat e zbatueshme të subjektit; - Përcaktimi i frekuencës së nevojshme të pjesëmarrjes në trajnimet PPP/FT; - Dokumentacioni për të verifikuar regjistrimet e pjesëmarrjes dhe materialet e trajnimit; - Trajnimi PPP/FT është në vazhdimësi / i vazhdueshëm; - Materiale të trajnimit mbulon politikat e subjektit, procedurat, proceset dhe rregullat e rregulloret e reja; - Materiale të trajnimit mbulon format e ndryshme të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit sipas lidhjes së tij me identifikimin dhe shembujt e aktivitetit të dyshimtë; - Materiale të trajnimit mbulon penalitetet për mospërputhshmërinë me politikat e brendshme		

Manuali i Mbikëqyrjes për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimin e Terrorizmit

	dhe kërkesat rregullatorë.		
2.	Verifikohet nëse të gjithë punonjësit kanë ndjekur trajnimin bazë PPP/FT.		
3.	Verifikohet nëse stafi i ekspozuar ka ndjekur trajnimin e plotë / të përmirësuar PPP/FT.		
4.	Zhvillohet një intervistë e shkurtër në funksion të kryerjes së trajnimit PPP/FT dhe rishikoni programet dhe materialet e trajnimit, si dhe dokumentacionin e pjesëmarrjes. Vlerësimi nëse kryerja e trajnimit PPP/FT ishte e përshtatshme dhe nëse pjesëmarrja ishte e dokumentuar dhe e ndjekur siç duhet.		
Kujdesi i Duhur dhe dokumentat e kërkuara për identifikimin e konsumatorit Objekti: Të përcaktohet nëse elementet e rëndësishëm të një programi trajnues PPP/FT janë drejtuar në mënyrë të përshtatshme në programin dhe në materialet e trajnimit nëse trajnimi është realizuar e dokumentuar dhe nëse është ndjekur mos-pjesëmarrja.			
<u>Procedura e Inspektimit:</u>			
1.	Zhvillohen intervista me bizneset përkatëse, funksionet e sigurimit të cilësisë dhe përputhshmërisë. Intervistat duhet të mbulojnë hartimin e procedurave dhe kontrolleve për kujdesin e duhur ndaj transaksioneve të konsumatorit, zbatimin dhe realizimin e tyre;		
2.	Rishikohen funksionalitetet e sistemeve që ndihmojnë punonjësit për të realizuar dhe kontrolluar me kujdesin e duhur transaksionet e konsumatorëve		
3.	Përcaktohet një numër i mjaftueshëm i dosjeve të modeleve dhe të konsumatorëve dhe verifikohet nëse dokumentat dhe informacioni i nevojshëm në përputhje me Nenin 4 të Ligjit PPP/FT janë mbajtur dhe regjistruar në kohën e kërkuar nga ligji.		
Kategorizimi i rrezikut në lidhje me konsumatorët dhe transaksionet Objekti: Të vlerësohet nëse subjekti ka zhvilluar në mënyrë të mjaftueshme kategoritë e rrezikut ndaj konsumatorëve dhe transaksioneve dhe nëse, në përputhje me këto kategori, janë identifikuar konsumatorët dhe transaksionet me rreziqe të rritura për qëllimet e rritjes së kujdesit të duhur.			
<u>Procedura e Inspektimit:</u>			
1.	Zhvillohen intervista me bizneset përkatëse dhe funksionet e përputhshmërisë. Intervistat e lejojnë Inspektorin të kuptojë kategoritë e rrezikut të zhvilluara nga subjekti si janë identifikuar marrëdhëniet dhe transaksionet e konsumatorit me rreziqe të rritura ndaj pastrimit të parave si në fillim dhe gjatë marrëdhënies së konsumatorit të vlerësojë nëse kategoritë ekzistuese të rrezikut janë të mjaftueshme dhe nëse punonjësit kanë një njohje të mirë të çështjes		
2.	Verifikohet nëse subjekti ka përcaktuar kategoritë minimale të rrezikut, sipas Rregullores 58/2015 • Personat e ekspozuar politikisht ("PEP-të") • Organizatat jofitimprurëse • Konsumatorët jorezidentë • Konsumatorët rezidentë ose që kryejnë aktivitete biznesi në vendet të cilat nuk ndjekin standardet përkatëse FATF për parandalimin dhe luftën për parandalimin e pastrimit të parave. Dhe për transaksionet: • Transaksionet komplekse, d.m.th. transaksionet me vlera të mëdha dhe jo të zakonshme të cilat nuk kanë qëllim të dukshëm ekonomik ose ligjor; • Transaksionet e bëra nga konsumatorët që banojnë ose zhvillojnë aktivitete biznesi në vende të cilat nuk zbatojnë standardet përkatëse FATF për parandalimin dhe luftën për parandalimin e pastrimit të parave.		
3.	Verifikohet dokumentacioni në lidhje me identifikimin e marrëdhënieve të konsumatorëve dhe transaksionet me rrezik të rritur dhe vlerësohen përshtatshmëritë e tyre		
4.	Verifikohen sistemet IT ose mjetet e përdorura për qëllimin e identifikimit të marrëdhënieve të konsumatorëve dhe transaksioneve me rrezik të rritur dhe vlerësohet nëse ato janë të mjaftueshme për tu përputhur me Ligjin PPP/FT		

Manuali i Mbikëqyrjes për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimin e Terrorizmit

5.	Nga lista e transaksioneve të konsumatorëve të kompanisë (duhet të zgjidhet periudha e përshtatshme kohore), verifikohet nëse ka transaksione të cilat bien në kategorinë e rrezikut të rritur dhe verifikohet nëse subjekti ka shënuar me korrektësi transaksionet përkatëse si mbartëse të rreziqeve të rritura		
Kujdesi i Duhur në Rritje <u>Objekti:</u> Të vlerësohet nëse subjekti ka marrë dokumentacion apo informacion të mëtijshëm në lidhje me marrëdhëniet e konsumatorëve me rreziqe të rritura ose të transaksioneve me rreziqe të rritura. Vlerësohet nëse subjekti, nëpërmjet dokumentacionit dhe informacionit të marrë, kupton në mënyrë të përshtatshme mjedisin e këtyre marrëdhënieve dhe/ose transaksioneve të konsumatorit. <u>Procedura e Inspektimit:</u>			
1.	Nga lista e klientëve dhe transaksionet që përfshijnë rreziqet e rritura, përzgjidhet një numër i përshtatshëm i pozicioneve, merren dosjet e konsumatorëve ose transaksioneve përkatëse; dhe		
2.	Verifikohet nëse informacioni/dokumentat e marra janë të mjaftueshme për të gjykuar nëse mjedisi i marrëdhënies dhe/ose transaksionit të konsumatorit është kuptuar në mënyrë të mjaftueshme dhe nëse ai është apo duket si i dyshimtë.		
Marrëdhëniet me PEP <u>Objekti:</u> Të vlerësohet nëse shoqëria ndjek dispozitat e Ligjit PPP/FT për marrëdhëniet me personat e lartë të ekspozuar politikisht, të referuar shpesh si “persona të ekspozuar politikisht” (PEP-të) dhe mjaftueshmërinë e sistemeve të shoqërisë për të menaxhuar rreziqet e lidhura me këto figura të politikës vendase ose të huaj dhe aftësinë e menaxhimit për të zbatuar kujdesin e duhur të bazuar në rrezik, verifikimin, monitorimin dhe sistemet e raportimit. <u>Procedura e Inspektimit:</u>			
1.	Rishikohen politikat e bazuara në rrezik, procedurat dhe proceset në lidhje me PEP-të. Vlerësohet përshtatshmëria e politikave, procedurave dhe proceseve në lidhje me PEP-të. Vlerësohet përshtatshmëria e politikave, procedurave dhe proceseve duke pasur parasysh llogaritë e PEP-ve të kompanisë dhe rreziqet që ata paraqesin. Vlerësohet nëse kontrollet e bazuara në rrezik janë të përshtatshme për të mbrojtur në mënyrë të pranueshme shoqërinë nga të qënurit e përdorur si një kanal për pastrimin e parave, korrupsionit dhe financimit të terrorizmit.		
2.	Rishikohen procedurat për hapjen e llogarive PEP. Identifikohet roli i menaxhimit në miratimin dhe monitorimin e vazhdueshëm të bazuar në rrezik të llogarive PEP.		
3.	Nga rishikimi i SMI-së dhe faktorëve të brendshëm të klasifikimit të rrezikut, përcaktohet nëse shoqëria identifikon me efektivitet dhe monitoron marrëdhëniet PEP, në veçanti ato që kanë rrezik të lartë për korrupsion, pastrim parash dhe financim të terrorizmit.		
4.	Përcaktohet nëse sistemi i subjektit për monitorimin e PEP-ve për aktivitetet e dyshimta dhe për raportimin e aktiviteteve të dyshimta është i përshtatshëm, duke pasur parasysh madhësinë e subjektit, kompleksitetin, vendndodhjen dhe llojet e marrëdhënieve të konsumatorit/klientit.		
5.	Nëse është e përshtatshme, përcaktohet nëse subjekti ka verifikuar nëse personi është në ndonjë listë sanksionesh.		
6.	Në bazë të vlerësimit të rrezikut të subjektit për marrëdhëniet PEP-ve të saj, si dhe inspektimit paraprak dhe raporteve të auditimit, përzgjidhet një shembull i llogarive PEP. Nga shembulli i përzgjedhur, kryhen procedurat e mëposhtme të inspektimit:		
	Përcaktohet përputhshmëria me kërkesat rregulatore dhe me politikat, procedurat dhe proceset e krijuara të subjektit në lidhje me PEP-të;		
	Rishikohet aktiviteti i transaksioneve për llogarinë e përzgjedhur. Nëse është e nevojshme, kërkohen dhe rishikohen transaksionet;		
	Nëse analiza e aktivitetit dhe informacioni me kujdesin e duhur ndaj konsumatorit ngre shqetësime, mbahen diskutime me menaxhimin e subjektit.		
Monitorimi nga Zyrtari i Përputhshmërisë PPP/FT <u>Objekti:</u> Vlerësimi nëse funksioni i Përputhshmërisë PPP/FT harton dhe realizon një set të mjaftueshëm të detyrave monitoruese për të siguruar menaxhimin se funksionet e biznesit tregojnë kujdesin e duhur			

Manuali i Mbikëqyrjes për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimin e Terrorizmit

PPP/FT në mënyrë të përshtatshme. <u>Procedura e Inspektimit:</u>			
1.	Intervistohet Zyrtari i Përputhshmërisë PPP/FT dhe përcaktohet nëse ai/ajo ka përgatitur dhe dokumentuar setin e nevojshëm detyrave monitoruese dhe nëse detyrat janë realizuar në përputhje me periodicitetin e caktuar;		
2.	Merret një numër i rasteve të modeleve nga dosjet e monitorimit të Zyrtarit të Përputhshmërisë PPP/FT dhe verifikohet nëse kontrollet/rishikimet kanë qenë të realizuara dhe të dokumentuara siç duhet.		
Raportimet e transaksioneve në para fizike (RTPF-ve) <u>Objekti:</u> Të vlerësohet nëse shoqëria zbaton rregullat e Ligjit PPP/FT për raportimin e transaksioneve në para fizike mbi vlerën e caktuar në Ligjin PPP/FT. <u>Procedura e Inspektimit:</u>			
1.	Për një periudhë të përshtatshme kohore, merret lista e transaksioneve në para fizikë të ardhurave dhe shpenzimeve të kompanisë;		
2.	Verifikohet nëse këto transaksione janë raportuar siç duhet në Drejtorinë e Përgjithshme.		
Detyrimi për mbajtjen e të dhënave – Mbajtja e Regjistrave <u>Objekti:</u> Të vlerësohet nëse shoqëria zbaton siç duhet dispozitat e Nenit 16 të Ligjit PPP/FT në lidhje me detyrimin për të mbajtur të dhënat që i përkasin detyrimeve PPP/FT. <u>Procedura e Inspektimit:</u>			
1.	Merret një numër i përshtatshëm i dosjeve të marrëdhënieve aktuale të konsumatorit/klientit dhe të transaksioneve të biznesit dhe verifikohet nëse nga Shoqëria janë mbajtur të gjitha të dhënat e nevojshme dhe dokumentat.		
2.	Merret një numër i përshtatshëm i dosjeve të marrëdhënieve të përfunduara të konsumatorit dhe të transaksioneve të biznesit dhe verifikohet nëse nga subjekti janë mbajtur të gjitha të dhënat e nevojshme dhe dokumentat.		
Vlerësimi Paraprak			
	Pasi inspektori të ketë përfunduar rishikimin e të katër elementëve të kërkuar për programin e përputhshmërisë PPP/FT të kompanisë, inspektori duhet të dokumentojë një vlerësim paraprak të programit të kompanisë. Në këtë pikë, inspektori duhet:		
	Të rishqyrtojë planin e inspektimit fillestar, me qëllim që të përcaktojë nëse janë identifikuar pika të forta ose të dobëta gjatë rishikimit të programit të përputhshmërisë PPP/FT të institucionit, për të përligjur rregullimet në fushën fillestare të planifikuar.		
	Të dokumentojë dhe të mbështesë të gjitha ndryshimet në fushën e inspektimit, pastaj të procedojë me bërthamën kryesore dhe, nëse është e përligjur, të zgjerojë procedurat e inspektimit.		
	Në qoftë se nuk ka ndryshime në fushën e inspektimit, inspektori duhet të procedojë me seksionin tjetër të procedurës.		
Zhvillimi i konkluzioneve dhe Finalizimi i Inspektimit <u>Objekti:</u> Të formulohen konkluzionet, komunikohen rezultatet e menaxhimit, përgatiten komentet e raportit, hartohet një përgjigje e përshtatshme mbikëqyrëse dhe mbyllet inspektimi.			
1.	Formulimi i Konkluzioneve		
	Grumbullohen të gjitha rezultatet përkatëse nga procedurat e kryera të inspektimit PPP/FT. Vlerësoni përpikërinë dhe besueshmërinë e të gjitha vlerësimeve të rrezikut të bëra nga subjekti. Arrini në një konkluzion paraprak nëse janë përmbushur kërkesat e mëposhtme:		
	Programi i përputhshmërisë PPP/FT është i monitoruar dhe i mbikëqyrur në mënyrë efektive, në lidhje me profilin e rrezikut të shoqërisë, sipas përcaktimit nga vlerësimi i rrezikut. Inspektori duhet të përcaktojë nëse programi i përputhshmërisë PPP/FT është efektiv në lehtësimin e rrezikut të përgjithshëm të kompanisë.		
	Bordi Mbikëqyrës dhe menaxhimi i lartë (a) janë në dijeni të kërkesave rregullatore PPP/FT, (b)		

Manuali i Mbikëqyrjes për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimin e Terrorizmit

	mbikëqyrin në mënyrë efektive përputhshmërinë PPP/FT dhe (c) angazhohen, sipas nevojës, për të rregulluar veprimet (p.sh. inspektimet rregullatore dhe të auditimit).		
	Politikat PPP/FT, procedurat dhe proceset janë të mjaftueshme për të siguruar përputhshmërinë me ligjet dhe rregulloret e zbatueshme dhe i drejtojnë siç duhet operacionet me rrezik të lartë (produktet, shërbimet, konsumatorët, entet dhe vendndodhjet gjeografike).		
	Kontrollet e brendshme të përshtatshme sigurojnë përputhshmëri me PPP/FT-në dhe bëjnë menaxhim të mjaftueshëm të rrezikut, veçanërisht për operacionet me rrezik të lartë (produktet, shërbimet, konsumatorët, entet dhe vendndodhjet gjeografike).		
	Testimi i pavarur (auditimi) është i mjaftueshëm dhe teston në mënyrë të duhur dhe të përshtatshme përputhshmërinë me ligjet, rregulloret dhe politikat e kërkuara. Mbulimi dhe frekuenca e përgjithshme janë të mjaftueshme në lidhje me profilin e rrezikut të shoqërisë. Testimi i transaksioneve është i përshtatshëm, veçanërisht për operacionet me rrezik të lartë të kompanive dhe sistemet e monitorimit të aktiviteteve të dyshimta.		
	Personi i caktuar, përgjegjës për koordinimin dhe monitorimin e përditshëm të përputhshmërisë është kompetent (d.m.th., trajnimi, eksperiencia dhe arsimimi) dhe ka burimet e nevojshme.		
	Stafi është i trajnuar në mënyrë të mjaftueshme për t'ju përmbajtur kërkesave ligjore, rregullatore dhe kërkesave të politikave.		
	Politikat, procedurat dhe proceset e informacionit dhe të komunikimit janë të mjaftueshme dhe të sakta.		
2.	Përcaktimi i Shkakut Kryesor		
	Përcaktohet shkaku kryesor i mangësive të politikave, procedurave ose të proceseve, nëse mund të identifikohet. Këto mangësi mund të jenë si rezultat i një sere faktorësh, duke përfshirë, por pa u kufizuar me sa vijon:		
	Menaxhimi nuk i ka vlerësuar ose nuk i ka vlerësuar në mënyrë të saktë rreziqet PPP/FT të kompanisë;		
	Menaxhimi nuk është i informuar për çështjet përkatëse;		
	Menaxhimi nuk ka dëshirë të krijojë ose të përmirësojë politikat, procedurat dhe proceset e bazuara në rreziqet e rritura;		
	Menaxhimi ose punonjësit i shpërfillin politikat, procedurat dhe proceset;		
	Menaxhimi ose punonjësit janë të painformuar ose i kanë keqkuptuar kërkesat rregullatore, politikat, procedurat ose proceset;		
	Operacionet me rrezik të lartë (produktet, shërbimet, konsumatorët, entet dhe vendndodhjet gjeografike) janë rritur më shpejt se kapacitetet e programit të përputhshmërisë PPP/FT;		
	Ndryshimet në politikat e brendshme, procedurat dhe proceset janë komunikuar në mënyrë të dobët.		
	Përcaktohet nëse mangësitë apo shkeljet kanë qenë të identifikuar nga menaxhimi ose auditimi ose kanë qenë të identifikuar vetëm si rezultat i këtij inspektimi.		
Diskutohen rezultatet me Inspektorin Përgjegjës dhe Identifikohet Veprimi i Nevojshëm			
Diskutohen rezultatet paraprake me inspektorin përgjegjës për rishikimin e përputhshmërisë së përgjithshme PPP/FT të subjektit. Shkresat dokumentohen në mënyrë të përshtatshme me informacionin e mëposhtëm:			
	Konkluzioni në lidhje me mjaftueshmërinë e programit të përputhshmërisë PPP/FT dhe nëse ai përputhet me të gjitha kërkesat rregullatore duke dhënë sa vijon:		
	Një sistem për kontrollet e brendshme;		
	Testim të pavarur për përputhshmërinë;		
	Një person të veçantë për të bashkërenduar dhe monitoruar programin e përputhshmërisë PPP/FT;		
	Trajnimin e personelit të duhur;		
	Një konkluzion, nëse Programi i Identifikimit të Konsumatorit (PIK), nëse aplikohet, është i		

Manuali i Mbikëqyrjes për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimin e Terrorizmit

	përshtatshëm për madhësinë e kompanisë, vendndodhjen dhe llojin e biznesit;		
	• Të gjitha shkeljet e identifikuar dhe një vlerësim për ashpërsinë e këtyre shkeljeve;		
	• Identifikimi i veprimeve të nevojshme për të korrigjuar mangësitë ose shkeljet;		
	• Nëse është e nevojshme, rekomandimet për veprimet e mbikëqyrjes. Në vazhdim, sipas nevojës, diskutohet me menaxhimin e mbikëqyrjes së subjektit dhe me stafin ligjor të subjektit;		
	• Një normë të përshtatshme, të bazuar në rezultatet dhe konkluzionet e përgjithshme;		
	• Rezultatet të cilat kanë qenë ose do të diskutohen me menaxhimin e shoqërisë dhe, nëse është e zbatueshme, të gjitha komitetet e subjektit për përmirësimet ose veprimet korrigjuese.		
Përgatitja e komenteve për Raportin e Inspektimit PPP/FT			
Inspektori duhet të organizojë dhe të referojë konkluzionet e shkresave dhe të dokumentojë konkluzionet dhe informacionin mbështetës brenda bazave të brendshme të të dhënave, sipas nevojës. Sipas rastit, inspektori duhet të përgatisë një diskutim për pikat e mëposhtme. Përkrahë angazhimi i Bordit Mbikëqyrës dhe i menaxhimit të lartë për përputhshmërinë PPP/FT. Merret në konsideratë nëse menaxhimi ka si vijon:			
	• Një program të fortë për përputhshmërinë PPP/FT, të mbështetur plotësisht nga Bordi Mbikëqyrës, menaxhimi i lartë ose një organ i ngjashëm;		
	• Kushtin që Bordi Mbikëqyrës dhe menaxhimi i lartë janë mbajtur të informuar për përpjekjet e përputhshmërisë PPP/FT, raportet e auditimit, çdo mosrealizim të përputhshmërisë dhe për statusin e veprimeve korrigjuese, nëse funksioni i Përputhshmërisë PPP/FT ka staf të mjaftueshëm;		
	• Përkrahë nëse politikat e subjektit, procedurat dhe proceset përputhen me kërkesat rregullatore dhe janë efektive. Përkrahë nëse politikat, procedurat dhe proceset e kompanisë për transaksionet e mëdha monetare përputhen me kërkesat e Ligjit PPP/FT Nr. 9917, Neni 13, ("Për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit") dhe janë efektive. Nëse është e aplikueshme, përkrahë nëse politikat, procedurat dhe proceset e shoqërisë për përjashtimet RTPF përputhen me kërkesat rregullatore për raportimin, bëjnë përjashtimet në mënyrën e duhur dhe përdorin format e duhura;		
	• Përkrahë nëse politikat, procedurat dhe proceset e kompanisë përputhen me kërkesat e ligjit të zbatueshëm. Diskutohet nëse politikat, procedurat dhe proceset përfshijnë kontrolle të brendshme efektive (p.sh., ndarjen e detyrave, autorizimin e duhur) dhe japin një mënyrë për monitorimin e transfertave për qëllime të raportimit RTPF. Ligji PPP/FT nr. 9917, Neni 11, dhe aktivitetet dysuese;		
	• Përkrahë politikat, procedurat dhe proceset e mbajtjes së regjistrave të subjektit. Tregohet nëse ato përputhen me kërkesat e Ligjit PPP/FT Nr. 9917, Nenet 6, 11 & 16;		
	• Përkrahë nëse kontrollet dhe procedurat PPP/FT të vendosura janë duke punuar në mënyrë efektive dhe çojnë në rezultatin e duhur i cili përputhet me të gjitha dispozitat e Ligjit Shqiptar PPP/FT;		
	• Përkrahë nëse politikat dhe procedurat e subjektit për kërkesat detyruese ligjore për informacion nga autoritetet e huaja të zbatimit të ligjit për Prokurorin e Përgjithshëm të Shqipërisë përputhen me kërkesat;		

FAZA IV: Draft Raporti i Inspektimit dhe Letra për Drejtuesit

	Inspektori	Data
Projekti i Raportit të Inspektimit		
Raporti i inspektimit duhet të përmbajë të gjitha rezultatet e rëndësishme të gjetura gjatë inspektimit.		
Letra e Menaxhimit		

Manuali i Mbikëqyrjes për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimin e Terrorizmit

Letra e menaxhimit është përdorur për të paraqitur rezultatet e inspektimit në menaxhimin e subjektit. Ka katër pikat të cilat duhet të trajtohen në të gjitha shkresat e menaxhimit:			
	• Rezultatet (çështjet). Duhet të ketë përshkrime të qarta të çështjeve të gjetura nga inspektori, të cilat duhet të fiksohen;		
	• Pse duhet të fiksohen rezultatet (efekti për shoqërinë). Shkresa e menaxhimit duhet të përcaktojë efektin e çështjes për subjektin;		
	• Çfarë duhet bërë (d.m.th, rekomandimet)? Menaxhimit të subjektit duhet t'i thuhet se çfarë pret AMF të ndërmerret me qëllim zgjidhjen e çështjes;		
	• Struktura. Asnjë rekomandim nëpërmjet të cilit shoqëria duhet të përgjigjet për rregullatorin, nuk duhet të bëhet pa një afat kohor.		
Shkresa e menaxhimit duhet të lëshohet dhe t'ju dërgohet shefit ekzekutiv dhe kryetarit të këshillit mbikëqyrës nga rregullatorët, me kusht që një kopje t'i dërgohet audituesit të jashtëm të subjektit dhe zyrtarit të përputhshmërisë.			

PHASE V: Inspektimi i vijueshmërisë

		Inspektori	Data
	Në rastin kur çështjet e ngritura, të cilat paraqesin rreziqe të larta apo kompleksitet të rëndësishëm, subjekti duhet të vizitohet pas një periudhe të pranueshme kohore për të realizuar një Inspektim pas zbatimit (ndjekjes), me qëllim që të verifikojë dhe sigurojë që çështja është zgjidhur me të vërtetë dhe siç duhet.		
	Inspektimi i ndjekjes duhet të përcaktohet në shkresën e Menaxhimit.		
	Performanca dhe programi i tij varen nga çështja që është ngritur. Ajo përgjithësisht do të përsëritë Inspektimin në lidhje me çështjen përkatëse dhe të japë siguri të plotë se subjekti ka marrë hapat e duhur për të zgjidhur çështjen.		

Ilustrim 8: Shënimet/Gjetjet e Inspektimit

INSTITUCIONI:			
LËNDA:			
PËRGATITUR NGA:		DATA:	
RISHIKUAR NGA:		DATA:	

Historiku dhe analiza e përgjithshme

Llojet, Kombinimet dhe Rentabiliteti i Biznesit

Manuali i Mbikëqyrjes për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimin e Terrorizmit

Jepet një pamje e përgjithshme e llojeve të rreziqeve të siguruara dhe të gjithë tregjet e reja apo pjesët e tregut në të cilët institucioni ka hyrë ose është duke marrë parasysh që të hyjë. Komentohet për çdo ndryshim në kombinimet dhe vendndodhjen e biznesit, dhe për çdo tendencë të pazakontë që vihet re.

Pozicioni i Tregut dhe Strategjia

Jepet një pamje e përgjithshme e pozicionit të institucionit në treg, çdo ndryshim në atë pozicion, konkurrentët e tij kryesorë dhe nëse është një lojtar i pjesshëm apo një tregtues i përgjithshëm. Komentohet shkurtimisht për vendosjen e çmimeve të produktit – është agresive, konkurruese apo pasive? Komentohet për performancën, në krahasim me atë të homologëve të tij dhe se si strategjia e produktit përshtatet me strategjinë e përgjithshme të korporatës. Komentohet për faktin nëse strategjia ka ndryshuar në krahasim me vitin/inspektimin e kaluar dhe nëse strategjia në vetvete dhe ndryshimi në veçanti paraqesin një rrezik të rritur për Pastrimin e Parave.

Rreziqet PPP/FT

Jepet një pamje e përgjithshme e rreziqeve PPP/FT në përputhje me Matricën e Rrezikut PPP/FT (Pasqyra 3) më sipër.

Cilësia e Kuadrit të punës PPP/FT

Vlerësohet nëse institucioni ka vendosur dhe vepron me efektivitet Kuadrin e Punës PPP/FT, d.m.th. më e rëndësishmja në fillim, politikat e brendshme, përkufizimin e roleve dhe përgjegjësi, takimet me një ZPPP, trajnimin dhe ndërgjegjësimin.

Struktura Organizative dhe Personeli

Jepet një përshkrim i nivelit të lartë i mënyrës se si është organizuar aktiviteti, d.m.th. i centralizuar, i decentralizuar dhe përshtatshmërinë e organizimit të tij në lidhje me profilin e rrezikut PPP/FT.

Identifikimi i Rrezikut

Jepet një përshkrim i nivelit të lartë i metodologjive të përdorura për të identifikuar rreziqet PPP/FT në përzgjedhjen dhe në renditjen e rrezikut

Kontrolli dhe Monitorimi i Rrezikut

Jepet një vlerësim i mjaftueshmërisë së kontrolleve kryesore PPP/FT (politikat dhe praktikët) mbi rreziqet PPP/FT të aktivitetit. Identifikohet rishikimi i kontrolleve kryesore dhe komentohet për faktin nëse ato janë të përshtatshme dhe të krahasueshme me kompleksitetin e aktivitetit dhe të nivelit të rrezikut PPP/FT. Komentohet nëse kontrollet janë dokumentuar dhe komunikuar në mënyrën e duhur, janë kryer me efektivitet, janë zbatuar në praktikë dhe janë subjekt i rishikimeve të rregullta të pavarura. Përkruhet shkurtimisht efekti i çdo dobësie apo mangësie të identifikuar nga kontrolli i aktivitetit.

Raportimi

Komentohet nëse përmbajtja dhe shpeshtësia e raportimit të rregullt të Menaxhimit të Lartë dhe të Bordit janë në mënyrën e duhur. Aty ku vihen re dobësi ose mangësi, përkruhet shkurtimisht se si mund të

Manuali i Mbikëqyrjes për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimin e Terrorizmit

ndikojë aftësia e Menaxhimit për të menaxhuar rreziqet në mënyrën e përshtatshme, mbi një bazë të përditshme.

Funksionet e biznesit që mbartin kontrollet PPP/FT

Jepet një vlerësim për mënyrën se sa me efektivitet veprojnë funksionet e biznesit dhe kryerja e kontrolleve PPP/FT, nëse janë të dokumentuar siç duhet në përputhje me Ligjin Shqiptar PPP/FT dhe me dispozitat e AMF-së. Vlerësohet nëse rastet e mbetura pezull dhe boshllëqet materiale ose formale ndiqen kur është e nevojshme dhe mbyllen.

Përputhshmëria PPP/FT

Jepet një vlerësim për mënyrën se sa me efektivitet funksioni i Përputhshmërisë PPP/FT mbikëqyr në mënyrë të pavarur menaxhimin e përputhshmërisë së aktivitetit me Ligjin Shqiptar PPP/FT. Merret në konsideratë, ndër të tjera, fushëveprimi dhe shpeshtësia e mbikëqyrjes, nëse ajo fokusohet në zonat kyçe të rrezikut PPP/FT, nëse rezultatet dhe konkluzionet e saj janë në lidhje me operimin efektiv të aktivitetit, janë komunikuar dhe përshkallëzuar, sipas bazës përkatëse të rëndësisë së tyre, mbi një bazë kohore dhe janë ndjekur në mënyrë aktive. Kur në karakteristikat e funksionit vihen re dobësi ose mangësi, komentohet në lidhje me faktin nëse ato ndikojnë në performancën e funksionit në lidhje me këtë aktivitet apo mund të ndikojnë në performancë në të ardhmen.

Auditi i Brendshëm

Nëse është e nevojshme, jepet një vlerësim në lidhje me sa mirë i mbikëqyr Auditi i Brendshëm në mënyrë të pavarur efektshmërinë dhe zbatimin e kontrolleve kryesore të aktivitetit PPP/FT. Ndër të tjera merret në konsideratë nëse ai është i fokusuar në rreziqet kryesore dhe në kontrollet kryesore, nëse fushëveprimi dhe shpeshtësia e mbikëqyrjes së tij është e mjaftueshme për rrethanat që të përcaktojnë nëse rreziqet kryesore janë menaxhuar me efektivitet dhe në bazë të vazhdueshme, nëse rezultatet dhe konkluzionet e tij kanë lidhje me operimin efektiv të aktivitetit dhe janë të bazuara në një nivel të përshtatshëm të vlerësimit dhe nëse ato janë komunikuar dhe përshkallëzuar si duhet në bazë të rëndësisë së tyre, në bazë kohore dhe ndiqen në mënyrë aktive. Kur në karakteristikat e funksionit vihen re dobësi ose mangësi, komentohet në lidhje me faktin nëse ato ndikojnë në performancën e funksionit në lidhje me këtë aktivitet apo mund të ndikojnë në performancë në të ardhmen.

Menaxhimi i Lartë

Jepet një vlerësim se sa mirë Menaxhimi i Lartë e mbikëqyr efektivitetin me të cilin menaxhohet aktiviteti në terma të kontrolleve monitorimeve dhe raportimeve PPP/FT. Merret në konsideratë, ndër të tjera, efektiviteti i mbikëqyrjes së tij për aktivitetin e rreziqeve PPP/FT, burimeve, ndjekjes së politikave, kontrolleve dhe standardeve etike dhe zgjidhja në kohë e çështjeve.

Bordi/Komitetet

Jepet një vlerësim se sa mirë Bordi dhe/ose komitetet e tij mbikëqyrin menaxhimin dhe operacionet e aktivitetit në termat e kuadrit PPP/FT dhe kontrolleve PPP/FT. Merret në konsideratë, ndër të tjera, sa mirë i kupton Bordi rreziqet e tij kryesore PPP/FT, përshtatshmërinë e natyrës dhe shpeshtësinë e

Manuali i Mbikëqyrjes për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimin e Terrorizmit

raportimit që kërkon nga aktiviteti, duke pasur parasysh natyrën, fushëveprimin, kompleksitetin dhe profilin e rrezikut, si dhe mjedisin e tij operues.

Shfrytëzimi i Punës së Palëve të Treta

Shkurtimisht përshkruhet se si është përdorur në rishikim (sipas rastit) puna me palët e treta dhe racionalja për përdorimin e saj. Identifikohet fushëveprimi i rishikimit të palës së tretë, rezultatet dhe rekomandimet e ngritura prej saj. Referenca mund të bëhet për informacionin e dhënë nga palët e treta për të shmangur dokumentacionin e tepërt.

Rekomandimet për Institucionin

Përcaktohet rezultati(et) dhe rekomandimi(et)/kushti(et)/sugjerimi(et) që do t'i bëhen institucionit, në bazë të rishikimit të aktivitetit. Çdo rezultat duhet të përshkruhet si çështje e veçantë, të identifikohet qartë materialiteti i çështjes për aktivitetin dhe të diskutohen pasojat e mosadresimit të tij. Rekomandimi(et)/kërkesa(t) duhet të përcaktojnë se çfarë pret AMF që të bëjë institucioni për të adresuar shqetësimet e tij. Veprimi(et) e pritura duhet të jenë në përputhje me ndikimin e rezultatit(eve) për aktivitetin e profilin e rrezikut.

Për Inspektimet e Ardhshme

Identifikohet rekomandimet për punët e ardhshme në zonat që kërkojnë mbikëqyrje të vazhdueshme, si dhe rekomandimet për përmirësimin e efikasitetit dhe efektshmërisë së punës mbikëqyrëse të AMF-së në të ardhmen.

Ilustrim 9: Hartimi i Konkluzioneve & Finalizimi i Shënimeve të Inspektimit

Objekti: Të formulohen konkluzionet, komunikohen rezultatet tek menaxhimi, përgatiten komentet e raporteve, hartohet një përgjigje e përshtatshme për mbikëqyrjen dhe mbyllet inspektimi.

Hartimi i Konkluzioneve

1. Grumbulloni të gjitha çështjet përkatëse nga procedura e kryer e inspektimit PPP/FT. Të vlerësohet gjithëpërfshirja dhe besueshmëria e të gjitha vlerësimeve të rrezikut, të kryera nga banka. Të arrihet në një konkluzion paraprak nëse janë përmbushur kushtet e mëposhtme:

- Programi i përputhshmërisë PPP/FT është monitoruar me efektivitet dhe është mbikëqyrur në lidhje me profilin e rrezikut të bankës, sipas përcaktimit nga vlerësimi i rrezikut. Kontrollori duhet të sigurojë nëse programi i përputhshmërisë PPP/FT është efektiv për lehtësimin e rrezikut të përgjithshëm të siguruesit;
- Bordi i drejtorëve dhe menaxhimi i lartë është i ndërgjegjshëm për kërkesat rregullatore PPP/FT, mbikëqyr me efektivitet përputhshmërinë PPP/FT dhe angazhohet, sipas nevojës, me veprimet korrigjuese (p.sh. inspektimet e auditit dhe rregullatore);

Manuali i Mbikëqyrjes për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimin e Terrorizmit

- Politikat PPP/FT, procedurat dhe proceset janë të përshtatshme për të siguruar përputhshmërinë me ligjet dhe rregulloret e zbatueshme dhe adresojnë siç duhet operacionet me rrezik të lartë (produktet, shërbimet, konsumatorët, entet dhe vendndodhjet gjeografike);
- Kontrollat e brendshme sigurojnë përputhshmërinë me Ligjin dhe ofrojnë menaxhim të mjaftueshëm të rrezikut, veçanërisht për operacionet me rrezik të lartë (produktet, shërbimet, konsumatorët, entet dhe vendndodhjet gjeografike);
- Testimi i pavarur (auditimi) është i përshtatshëm dhe teston në mënyrën e duhur për përputhshmërinë me ligjet, rregulloret dhe politikat e kërkuara. Mbulimi dhe shpeshtësia e auditimit të përgjithshëm janë të përshtatshme në lidhje me profilin e rrezikut të bankës. Testimi i transaksioneve është i duhuri, veçanërisht për operacionet bankare me rrezik të lartë dhe sistemet monitoruese të aktivitetit të dyshimtë;
- Personi i caktuar përgjegjës për bashkërendimin dhe monitorimin e përditshëm të përputhshmërisë është kompetent dhe ka burimet e nevojshme;
- Personeli është trajnuar mjaftueshëm për t'ju përmbajtur kushteve ligjore, rregullatore dhe të politikave;
- Politikat e informacionit dhe të komunikimit, procedurat dhe proceset janë të përshtatshme dhe të duhurat.

Të gjitha përkufizimet përkatëse duhet të dokumentohen dhe të shpjegohen.

Përcaktoni Shkakun Themelor

2. Përcaktoni shkaku themelor të politikës, procedurës, ose përpunoni mangësitë, nëse identifikohen. Këto mangësi mund të jenë rezultati i një sërë faktorësh, duke përfshirë, por duke mos u kufizuar në sa vijon:

- Menaxhimi nuk ka vlerësuar ose nuk ka vlerësuar me saktësi, rreziqet PPP/FT të bankës;
- Menaxhimi nuk është në dijeni të çështjeve përkatëse;
- Menaxhimi nuk synon të krijojë apo përmirësojë politikat, procedurat dhe proceset;
- Menaxhimi ose punonjësit nuk marrin parasysh politikat, procedurat dhe proceset e përcaktuara;
- Menaxhimi ose punonjësit nuk janë në dijeni ose keqkuptojnë kriteret rregullatore, politikat, procedurat, ose proceset;
- Operacionet me rrezik më të lartë (produktet, shërbimet, konsumatorët, entet dhe vendndodhjet gjeografike) janë përhapur më shpejt sesa kapacitetet e programit të përputhshmërisë PPP/FT;
- Ndryshimet në politikat, procedurat dhe proceset e brendshme nuk komunikohen siç duhet.

3. Përcaktoni nëse mangësitë apo shkeljet u identifikuan nga menaxhimi ose auditimi apo u identifikuan vetëm si rezultat i këtij inspektimi.

Diskutoni Konkluzionet me Supervizorin e ngarkuar/përgjegjës dhe Identifikoni Veprimin e Nevojshëm

Manuali i Mbikëqyrjes për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimin e Terrorizmit

4. Diskutoni konkluzionet paraprake me inspektorin ose inspektorin përgjegjës për shqyrtimin e përpunueshmërisë së përgjithshme të PPP/FT. Dokumentoni shkresat e punës ashtu siç duhet me informacionin vijues:

- Një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e programit të përpunueshmërisë PPP/FT dhe nëse ai i plotëson të gjitha kriteret rregullatore duke dhënë sa vijon:
 - a. Një sistem kontrollesh të brendshme;
 - b. Testim të pavarur për përpunueshmëri;
 - c. Një person specifik për të koordinuar dhe monitoruar programin e përpunueshmërisë PPP/FT.
- Trajnimin e personelit të duhur;
- Një konkluzion nëse PIK i shkruar është i përshtatshëm për përmasat e siguruesit, vendndodhjen dhe llojin e biznesit;
- Të gjitha shkeljet e identifikuar dhe një vlerësim të shkallës së atyre shkeljeve;
- Identifikimi i veprimeve të nevojshme për të korrigjuar mangësitë ose shkeljet;
- Nëse është e nevojshme, rekomandimet për veprimet mbikëqyrëse. Gjithashtu, sipas nevojës, këshillohuni me menaxhimin mbikëqyrës dhe stafin ligjor të subjektit;
- Një klasifikim i duhur bazuar në gjetjet dhe konkluzionet e përgjithshme;
- Gjetjet që janë diskutuar dhe do të diskutohen me menaxhimin e bankës dhe, nëse aplikohet, çdo angazhim bankar për përmirësime ose veprime korrigjuese.

Përgatitja e Komenteve PPP/FT për Raportin e Inspektimit

5. Dokumentoni konkluzionin tuaj në lidhje me përshtatshmërinë e programit të përpunueshmërisë PPP/FT të siguruesit. Diskutoni efikasitetin e secilit prej këtyre elementëve të programit të përpunueshmërisë PPP/FT të siguruesit. Tregoni nëse programi i përpunueshmërisë PPP/FT plotëson të gjitha kriteret rregullatore duke dhënë sa vijon:

- Një sistem kontrollesh të brendshme, duke përfshirë politikat dhe procedurat aktuale të duhura.
- Testim të pavarur për përpunueshmëri;
- Një person specifik për të koordinuar dhe monitoruar programin e përpunueshmërisë PPP/FT;
- Trajnimi i personelit të duhur.

Programi i përpunueshmërisë PPP/FT duhet të përfshijë gjithashtu një Program të shkruar për Identifikimin e Konsumatorit/ klientit(PIK) të përshtatshëm për përmasat, vendndodhjen dhe llojin e biznesit.

Shënim: Inspektori nuk duhet të bëjë asnjë koment me shkrim për asnjë nga zërat që vijnë nga 6 në 11. Komentet e shkruara duhet të mbulojnë hapësira ose subjekte që i përkasin gjetjeve dhe konkluzioneve të inspektorit. Të gjitha gjetjet e rëndësishme duhet të përfshihen në ROE. Inspektori duhet të sigurojë se dokumentat përgatiten me detaje të mjaftueshme për të mbështetur çështjet e diskutuara në ROE. Deri në masën që zërat vijues diskutohen në shkresa, por jo ROE, inspektori duhet të sigurojë se shkresat në mënyrë të plotë dhe të përshtatshme dokumentojnë çdo shqyrtim, si dhe çdo aspekt tjetër të programit të përpunueshmërisë së PPP/FT që meriton vëmendje, por nuk ngrihet në nivelin e përfshirjes në ROE. Inspektori duhet të organizojë, referojë dokumenta dhe dokumentojë konkluzione dhe informacione

Manuali i Mbikëqyrjes për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit

mbështetëse në kuadrin e bazave të brendshme të të dhënave, sipas rastit. Si të jetë e aplikueshme, inspektori duhet të përgatisë një diskutim për pikat që vijnë.

6. Përshkruani nëse politikat dhe procedurat e kompanisë për zbatimin e ligjit kërkojnë informacione sipas seksionit 6 të Ligjit Shqiptar Nr. 9917 në vijim të kriterëve rregullatore.

7. Përshkruani angazhimin e bordit të drejtorëve dhe menaxhimit të lartë për përputhshmërinë PPP/FT. Merrni në konsideratë nëse menaxhimi ka sa vijon:

- Një program përputhshmërie PPP/FT i mbështetur plotësisht nga bordi i drejtorëve;
- Një kriter që bordi i drejtorëve dhe menaxhimi i lartë të mbahen të informuar për përpjekjet e përputhshmërisë PPP/FT, raportet e auditimit, çdo mospërputhje dhe statusi e veprimeve korrigjuese.

8. Përshkruani nëse politikat, procedurat dhe proceset e bankës për depozitimet RAD (SAR) përmbushin kriteret rregullatore dhe janë efikase.

9. Përshkruani nëse ka politika, procedura dhe procese të siguruesit për transaksionet të mëdha në para fizike. 10. Përshkruani nëse politikat, procedurat dhe proceset përfshijnë kontrolle të brendshme efikase (p.sh.: ndarjen e detyrimeve, autorizimin e duhur për dërgim dhe marrje, si dhe postimin në llogari), dhe jepni një mënyrë për të monitoruar transfertat për qëllimet e raportimit RTPF.

11. Përshkruani politikat, procedurat dhe proceset e regjistrimit të siguruesit. Tregoni nëse ato plotësojnë kriteret e 31 CFR Kapitulli X.

Ilustrim 10: Fjalori i termave

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare ("AMF") është një ent qeveritar përgjegjës për rregullimin dhe mbikëqyrjen e sistemit financiar jo-bankar të Shqipërisë dhe operatorët e sektorit. Ai është gjithashtu autoriteti mbikëqyrës për kompanitë e përfshira në sigurimin dhe risigurimin e Jetës, agjentët dhe ndërmjetësit e tyre, si dhe fondet e pensioneve dhe fondet e investimeve.

Ligji për Parandalimin e Pastrimit të Parave ("Ligji PPP/FT") i referohet Ligjit Shqiptar Nr. 9917, në fuqi që nga data 19 maj 2008 "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit" kërkon nga institucionet financiare që të zhvillojnë një formë programi për parandalimin e pastrimit të parave.

Për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit ("PPP/FT") – Pastrimi i Parave është procesi nëpërmjet të cilit kriminelët përpigjen të fshehin origjinën e vërtetë dhe pronësinë e të ardhurave nga aktivitetet kriminale. Për Parandalimin dhe Pastrimit të Parave (PPPP) është shuma e masave për të parandaluar dhe frenuar pastrimin e parave. Financimi i terroristëve është mbështetja financiare ose sponsorizimi, në çdo lloj forme, i terrorizmit ose i atyre që inkurajojnë, planifikojnë, ose angazhohen në

Manuali i Mbikëqyrjes për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit

terrorizëm. Parandalimi i Financimit të Terrorizmit (PFT) është shuma e masave për të parandaluar financimin e terrorizmit.

Subjektet që mbikëqyren nga Autoriteti me qëllim parandalimin e pastrimit të parave dhe/ose financimit të terrorizmit²⁰ janë:

- Bursat dhe çdo subjekt tjetër (agjent, broker, shoqëri brokerimi, etj.) që ushtron veprimtari për emetimin, këshillimin, ndërmjetësimin, financimin dhe çdo shërbim tjetër që ka lidhje me tregtimin e titujve;
- Shoqëritë që merren me sigurimin e jetës ose risigurimit, agentët apo ndërmjetësit e tyre, si dhe fondet e pensionit.

Bankë - Një institucion financiar i licencuar si marrës depozitash. Ekzistojnë dy lloje bankash: banka komerciale/pakice dhe banka investimesh.

Përfitues – Çdokush që fiton një avantazh dhe/ose fitime nga diçka. Në botën financiare, një përfitues i referohet në mënyrë tipike dikujt që ka të drejtë të marrë përqindje nga një trust, testament ose policë sigurimi Jete. Përfituesit janë të shënuar me emër në mënyrë specifike në këto dokumenta ose kanë përmbushur përcaktimet që i bëjnë të papranueshëm për çfarëdo përqindje që është specifikuar. Shënim: termat *përfitues* dhe *Zotëruesi Përfitues (i fundit)* nuk janë të njëjtë.

Zotëruesi përfitues do të thotë në lidhje me një subjekt, një person (ose subjekt të dytë), i cili ka interes ekonomik, (ose ka të drejtë të ushtrojë kontroll mbi asetet e tij), mbi atë subjekt, qoftë përmes aksionit (eve), interesit (ave) të partneritetit, interesit (ave) sipas një trusti apo ndryshe. Shënim: pronari përfitues nuk është i njëjtë si një përfitues.

Broker - I referohet një ndërmjetësuesi të sigurimit të pavarur (të përcaktuar ose individual) që vepron në interes të konsumatorëve të tij. Një broker sigurimi është i gatshëm për të përzgjedhur produktet në mesin e ofruesve të ndryshëm të sigurimit, në bazë të nevojave dhe rrethanave financiare të konsumatorëve të tij. Në shumicën e vendeve, brokerat e sigurimit duhet të jenë të licencuar dhe të punojnë në bazë komisioni.

Produkt i Mbuluar - Një “produkt i mbuluar” për qëllimet e pajtueshmërisë PPP/FT përfshin: (a) Një politikë të përhershme për sigurimin e jetës, përveç një police për sigurimin e jetës në grup; (b) Çdo kontratë pensioni vjetor, përveç një kontrate pensioni vjetor në grup; dhe (c) Çdo produkt tjetër sigurimi me karakteristika të vlerës së parave të gatshme (para fizike) ose të investimit.

²⁰ përcaktohen në nenin 3, geramat e) dhe ë), të Ligjit nr. 9917, datë 19.05.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, si dhe në nenin 3 të Rregullores 58, datë 30.06.2015, “Mbi masat e vigjilencës së duhur dhe të zgjeruar nga subjektet e ligjit mbi parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, e ndryshuar.

Manuali i Mbikëqyrjes për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimin e Terrorizmit

Raporti për Transaksion në Monedhë (“RTM”) - Një raport që institucionet financiare duhet ta depozitojnë me njësinë vendore të inteligjencës financiare (FIU) për çdo depozitë, tërheqje, këmbim valute, apo pagesë tjetër ose transferim, nga, nëpërmjet ose drejtuar institucionit financiar, i cili përfshin një transaksion në monedhë që tejkalon një kufi të caktuar.

Konsumatori është një person fizik ose subjekt që blen një produkt ose shërbime të tjera nga një shoqëri .

Kujdesi i Duhur për Konsumatorin (“KDK”), shpesh i referuar si “njihni konsumatorin tuaj” (NKT), është procedura e verifikimit të identitetit të konsumatorit dhe/ose pronarit përfitues dhe qëllimit dhe rrethanave të biznesit, si dhe shqyrtimi i vazhdueshëm i transaksioneve dhe, ku të jetë e nevojshme, burimit të fondeve.

Programi për Identifikimin e Konsumatorit (“PIK”) është një kriter ku institucionet financiare duhet të verifikojnë identitetin e individëve që dëshirojnë të kryejnë transaksione financiare me ta.

Kujdesi i duhur i përmirësuar (“KDP”) – tregon një nivel më të lartë të Kujdesit të Duhur, në mënyrë specifike për konsumatorët me rrezik të lartë, që nënkupton konsumatorët, të cilët paraqesin rreziqe më të larta për parandalimin e pastrimit të parave ose rreziqe të financimit të terrorizmit; paraqesin ekspozim më të madh; politika të duhura kujdesi dhe, si rezultat, procedurat dhe proceset duhet të përmirësohen.

Task Forca e Veprimit Financiar (“TFVF”) i referohet një organi ndërqeveritar të themeluar në vitin 1989 për të vendosur standardet dhe për të nxitur zbatimin efikas të masave ligjore, rregullatore dhe operacionale për luftën për parandalimin e pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe kërcënimeve të tjera që lidhen me integritetin e sistemit financiar ndërkombëtar.

Institucioni Financiar dhe i Kreditimit do të thotë një subjekt, aktiviteti kryesor i të cilit është përvetësimi i aksioneve ose vazhdimi i aktiviteteve bankare, të kreditimit, sigurimit, investimit ose aktiviteteve të tjera të një lloji që janë zakonisht subjekt i rregulloreve nga rregullatori i shërbimeve financiare në juridiksionin në të cilin operon subjekti.

Njësia e Inteligjencës Financiare (NjIF) është një agjenci kombëtare përgjegjëse për marrjen, analizimin dhe transmetimin e informacioneve për transaksione të dyshimta tek autoritete të tjera kompetente, siç janë FinCEN (SHBA), SFO (MB). FIU në Shqipëri është Drejtoria e Përgjithshme për Parandalimin e Pastrimit të Parave (DPPPP/FTP).

Financimi – Akti i dhënies së fondeve për aktivitete biznesi, duke realizuar blerje ose investime.

Drejtoria e Përgjithshme për Parandalimin e Pastrimit të Parave (DPPPP/FTP) – Njësia Investigative Financiare e Qeverisë Shqiptare ose “FIU.”

Numri i Identifikimit i lëshuar nga Qeveria do të thotë për individët dhe subjektet numrin e një dokumenti identifikimi të vlefshëm, me foto, të lëshuar nga Qeveria, i cili vërteton ekzistencën e individit ose subjektit (p.sh. pasaportë ose patentë shoferi).

Prime të Shkruara Bruto (“PShB”) - shuma e primeve të shkruara të drejtpërdrejta dhe primeve të shkruara të presupozuara përpara efektit të risigurimit të përfunduar. Primet e shkruara të drejtpërdrejta përfaqësojnë primet në të gjitha politikat që kanë lëshuar filialet e sigurimit të kompanisë gjatë vitit. Primet e shkruara të presupozuara përfaqësojnë primet që degët e sigurimeve kanë marrë nga një rezervë e autorizuar e mandatuar nga shteti ose sipas faciliteteve të mëparshme të paraqitura.

Manuali i Mbikëqyrjes për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimin e Terrorizmit

Shoqëri sigurimi – sipas Ligjit Nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimeve dhe risigurimeve” një Shoqëri sigurimi është personi juridik i licencuar për të ushtruar veprimtari sigurimit dhe operacione të tjera të lidhura në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me veprimtarinë e sigurimit, sipas përcaktimeve të ligjit nr.52/2014

Shoqëri risigurimi.

Inspektimi – procesi i shqyrtimit të përputhjes rregullatore të shoqërisë së sigurimit nga inspektorët (ose analizuesit) e AMF-së. Ky proces ndonjëherë quhet “ekzaminim.”

Shoqata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve të Sigurimeve ("ShNMS") - Themeluar në vitin 1994, IAIS përfaqëson rregullatorët dhe mbikëqyrësit e sigurimeve të më shumë se 200 juridiksioneve në rreth 140 vende, të cilat përbëjnë 97% të primeve të sigurimit në botë. Objektivat e saj janë: (1) Nxitja e mbikëqyrjes efektive dhe të qëndrueshme, në nivel global, e industrisë së sigurimeve në mënyrë që të zhvillohen dhe të ruhen tregje të drejta, të sigurta dhe të qëndrueshme të sigurimit për përfitimin dhe mbrojtjen e të siguruarit; dhe (2) Kontributi në stabilitetin financiar global.

Njihni konsumatorin tuaj ("NjKT") është kujdesi i duhur që bankat, brokerat-distributorët, kompanitë e sigurimit dhe kompani të tjera financiare të rregulluara duhet të tregojnë për të identifikuar konsumatorët e tyre dhe për të gjetur informacionet e duhura përkatëse që lidhen me zhvillimin e biznesit me ta, në përputhje me ligjet dhe rregullat përkatëse. Politikat “Njihni konsumatorin tuaj” janë bërë gjithnjë e më të rëndësishme globalisht në mënyrë që të parandalojnë vjedhjen, mashtrimin, pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit.

Pastrimi i Parave është procesi nëpërmjet të cilit kriminelët përpiqen të fshehin origjinën e vërtetë dhe pronësinë e të ardhurave nga aktivitetet kriminale. Nëse del me sukses, paratë mund të humbasin identitetin e tyre kriminal dhe të duken legjitime. Objektivi i një pastruesi parash është vendosja e parave në sistemin financiar pa ngritur dyshime; lëvizja e parave, shpesh në një seri transaksionesh komplekse dhe/ose duke kapërcyer juridiksione të shumfishta, në mënyrë që të bëhet i vështirë identifikimi i burimit të tij fillestar; dhe më pas kthimi i parave në mjedisin financiar dhe atë të biznesit, në mënyrë që ato të duken si fonde ose asete legjitime.

Termi "pastrim parash" përcaktohet në OPMLTF dhe AMLO21 dhe nënkupton një akt që synon të ketë efektin e bërjes së çdo pasurie:

- (a) që janë të ardhurat e fituara nga komisioni i ndonjë veprë të parashikueshme sipas ligjeve të Shqipërisë, apo ndonjë sjelljeje të tillë që nëse do të kishte ndodhur në Shqipëri do të përbënte një kundërvajtje sipas ligjeve Shqiptare; ose
- b) që në tërësi ose pjesërisht, drejtpërdrejt ose tërthorazi, perfaqëson të ardhura të tilla, duke i bërë që të mos shfaqen si të tilla.

²¹ Ligji Nr. 9917, "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe Financimin e Terrorizmit ", 2008 (OPMLTF), i ndryshuar me ligjin nr. 10391, datë 03.03.2011 dhe Ligji nr. 66/2012, datë 07.06.2012. Ligji Nr.9258.2004 "Mbi Masat për Shtypjen e Financimit të Terrorizmit"; shfuqizuar me ligjin nr. 157/2013 "Për Masat kundra financimin e terrorizmit "(OPMLTF DHE AMLO).

Manuali i Mbikëqyrjes për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimin e Terrorizmit

I siguruari është një person ose kompani që kontribuon ose blen një policë sigurimi.

Polica i referohet dokumentit zyrtar që reflekton një marrëdhënie zyrtare të vendosur nga një kompani sigurimi për të ofruar produkte ose shërbime sigurimi tek klientët.

Persona të Ekspozuar Politikisht (“PEP”) i referohet individëve të cilëve u besohen ose u janë besuar funksione të rëndësishme publike (p.sh. krerët e shteteve apo të qeverisë, politikanë të lartë, qeveritarë të lartë, zyrtarët gjyqësorë apo ushtarakë, drejtuesit e lartë të korporatave shtetërore, zyrtarë të rëndësishëm të partive politike, me role udhëheqëse për direktiva në organizatat ndërkombëtare). Marrëdhëniet e biznesit me familjarët apo bashkëpunëtorët e ngushtë të PEP-ve përfshijnë rreziqe reputacioni të ngjashme me ato të vetë PEP. Përkufizimi nuk ka për qëllim të mbulojë individët e rangut të mesëm ose individët më të rinj të kategorive të mësipërme.

Termi PEP gjithashtu përfshin të ashtuquajturat Figurave të Larta Politike (shih më poshtë përkufizimin).

Primi është pagesa, ose një nga pagesat e rregullta periodike, që një i siguruar i bën një siguruesi në këmbim të detyrimit të siguruesit për të paguar përfitimet pas ngjarjes së një paparashikimi të specifikuar në kontratë.

Përqsja e Bazuar në rrezik – identifikimi i rreziqeve për pastrimin e parave lejon një përcaktim dhe zbatim të masave e kontrolleve të duhura dhe proporcionale për të lehtësuar këto rreziqe. Si rezultat, ndikimi faktik i një police PPP/FT mund të ndryshojë në varësi të rreziqeve të përcaktuara nga filialet e prekura, segmentet e biznesit, divizionet, njësitë dhe zonat funksionale.

Figurë e Lartë Politike – (Pjesë e përkufizimit të “PEP” – shih më sipër përkufizimin). Një zyrtar i lartë në degë ekzekutive, legjislative, administrative, ushtarake ose juridike të një qeverie të huaj (qoftë e zgjedhur ose jo), një zyrtar i lartë i një partie politike të huaj dhe të rëndësishme, ose një ekzekutiv i lartë i një koorporate shtetërore të huaj. Gjithashtu, një figurë e lartë politike e huaj përfshin çdo korporatë, biznes ose subjekt tjetër që është formuar nga ose për përfitimin e një figure të lartë politike të huaj.

“Anëtarët e familjes” të një figure të lartë politike të huaj përfshijnë në mënyrë tipike prindërit, motrat e vëllezërit, bashkëshortin/en, fëmijët dhe krushqit e figurës. “Persona të lidhur me të” të një figure të lartë politike të huaj është një person që është i njohur gjerësisht dhe publikisht për të ruajtur një marrëdhënie të ngushtë të pazakonshme me figura të larta politike të huaja dhe përfshin një person që është në një pozicion për të udhëhequr transaksione financiare të rëndësishme në vend dhe ndërkombëtare në emër të një figure të lartë politike të huaj.

Përkufizimi i një zyrtari të lartë ose ekzekutivi duhet të mbetet mjaft fleksibël për të kapur gamën e individëve të cilët, për shkak të detyrës apo pozitës së tyre, potencialisht përbëjnë rrezik që fondet e tyre mund të jenë të ardhurat e korrupsionit të huaj. Vetëm titujt nuk mund të japin informacion të mjaftueshëm për të përcaktuar nëse një individ është PEP për shkak se qeveritë janë të organizuara ndryshe nga juridiksioni në juridiksion. Në ato raste kur një kompani paraqet një SAR për një transaksion që mund të përfshijë të ardhurat e korrupsionit të huaj, Drejtoria e Përgjithshme ka udhëzuar kompanitë që të përfshijnë termin “korrupsion i huaj” në pjesën narrative të SAR. Shoqëritë duhet të përcaktojnë kontrolle dhe procedura që përfshijnë hapa të arsyeshëm për të konstatuar statusin e një individi si një PEP, dhe për të kryer mbikëqyrje të bazuar në rrezik të llogarive që mbahen nga ata individë. Rreziku do të variojë në varësi të faktorëve të tjerë siç janë gjeografia, produktet dhe shërbimet e përdorura dhe madhësia ose kompleksiteti i marrëdhënies së llogarisë. Kompanitë gjithashtu duhet të marrin parasysh faktorë të ndryshëm kur përcaktojnë nëse një individ është PEP, duke përfshirë:

- Përgjegjësitë e zyrtarit të zyrës së individit;

Manuali i Mbikëqyrjes për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimin e Terrorizmit

- Natyra e titullit (p.sh. honorar ose me rrogë);
- Niveli dhe natyra e autoritetit ose influenca mbi aktivitetet e qeverisë ose zyrtarëve të tjerë;
- Akses në asetet ose fondet e rëndësishme të qeverisë.

Në përcaktimin e pranueshmërisë së llogarive me rrezik më të lartë, një shoqëri duhet të shohë informacione të mjaftueshme për të përcaktuar nëse një individ është ose jo një PEP. Për shembull, kur tregohet kujdesi i duhur në një llogari me rrezik më të lartë, do të ishte e zakonshme që një kompani të shqyrtojë një burim të të ardhurave të konsumatorit, informacione financiare dhe historikun profesional. Këta faktorë kërkojnë shqyrtimin e punësimit në të kaluarën dhe punësimin aktual, si dhe referenca të përgjithshme që mund të identifikojnë statusin e një konsumatori si PEP.

SHËNIM: Një shoqëri duhet të ketë gjithmonë parasysh se identifikimi i statusit të konsumatorit si PEP nuk duhet të rezultojë automatikisht në një vendosmëri me rrezik më të lartë; është vetëm një faktor që shoqëria duhet ta marrë në konsideratë në vlerësimin e rrezikut të një marrëdhënie.

Përcaktimi nëse një konsumator ka një lidhje të ngushtë me një figurë të lartë politike të huaj mund të jetë i vështirë, edhe pse fokusimi në ato marrëdhënie që janë “gjerësisht dhe publikisht të njohura” ofron një kufizim të arsyeshëm në pritshmëritë për të identifikuar bashkëpunëtorë të ngushtë si PEP. Megjithatë, shoqëritë që kanë njohuri për një lidhje të ngushtë duhet të konsiderojnë konsumatorin e tyre një PEP, edhe në qoftë se një lidhje e tillë nuk është gjerësisht ose publikisht e njohur. Shoqëritë priten të ndjekin hapat e nevojshëm për të konstatuar statusin e një individi; agjencitë shtetërore dhe Drejtoria e Përgjithshme e pranojnë se këto hapa mund të mos zbulojnë të gjitha lidhjet e ngushta.

Transaksione të dyshimta ose të Pazakonta – Një transaksion është i dyshimtë nëse siguruesi (ose çdo ndërmjetës tjetër financiar i rregulluar) ka argumenta të pranueshme për të besuar se fondet rrjedhin nga një burim i paligjshëm. Një transaksion është i pazakontë kur ai nuk bie në skemën e zakonshme të transaksioneve që është kryer për ose nga ndërmjetësi tjetër financiar i rregulluar.

Raport Aktiviteti i Dyshimtë (“RAD”) është një raport në lidhje me aktivitete/transaksione të pazakonta (potencialisht të dyshimta) që një officer PPP/FT duhet të depozitojë tek autoritetet e duhura vendore, p.sh. Drejtoria e Përgjithshme për Parandalimin e Pastrimit të Parave (DPPP/FTP)

Raport Transaksioni i Dyshimtë (“RTD”), *Shih Raport Aktiviteti i Dyshimtë* më sipër

Financimi i Terrorizmit është mbështetja financiare ose sponsorizimi, në çfarëdo lloj forme, i terrorizmit ose i atyre që inkurajojnë, planifikojnë ose angazhohen në terrorizëm.

Termi "financimi i terrorizmit" përcaktohet në OPMLTF dhe AMLO dhe do të thotë:

(a) sigurimi ose grumbullimi, me çdo mjet, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të çdo prone:

(i) me qëllim që të përdoret prona; ose

(ii) duke ditur se prona do të përdoret, në tërësi ose pjesërisht, për të kryer një ose më shumë akte terroriste (pavarësisht nëse prona përdoret për raste të tilla);

(b) vënien në dispozicion e çdo pasurie ose shërbime financiare (të lidhura), me çfarëdo mjeti, drejtpërdrejt ose tërthorazi, në dobi të një personi që e di, ose që nuk e di nga pakujdesia, se është terrorist ose bashkëpunëtor me terroristët;

Manuali i Mbikëqyrjes për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimin e Terrorizmit

(c) grumbullimin e pasurisë ose kërkimin e shërbimeve financiare (të lidhura) në çdo mënyrë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, në dobi të një personi që e di, ose që nuk e di nga pakujdesia, se është terrorist ose bashkëpunëtor terrorist.

Sigurimi është procesi në të cilin një shoqëri sigurimi përcakton nëse dhe për çfarë primi ajo do të pranojë një aplikim për sigurim.

Shitja e policës së jetës është shitja e një police sigurimi Jete nga i siguruari përpara se të maturohet polica. Kjo shitje, me një çmim më të ulët nga çmimi i saj, por që zakonisht i tejkalon primet e paguara ose vlerën aktuale të dorëzuar të parasë fizike, i siguron shitësit një pagesë të menjëhershme në para fizike. Në përgjithësi, shitjet e policës së jetës përfshijnë individë të siguruar me një jetëgjatësi të pritshme më të shkurtër. Kjo është një mënyrë praktike për të paguar prime për sigurimin e shëndetit, që janë jashtëzakonisht të larta me të cilat përballen njerëzit e sëmurë rëndë me një jetëgjatësi të shkurtër të pritshme.

“Shoqëri administruese” është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë, veprimtaria tregtare e vetme dhe e vazhdueshme e së cilës është themelimi dhe/ose administrimi i fondeve të investimit dhe të shoqërive të investimit, në përputhje me Ligjin nr.10 198, datë 10.12.2009 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”.

“Fond investimi”, që është sipërmarrja me pjesëmarrje të hapur, e krijuar në bazë të një kontrate, nëpërmjet ofertës publike të kuotave, në përputhje me konceptin e përshkruar në nenin 54 dhe dispozitat e tjera të Ligjit nr.10 198, datë 10.12.2009 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”.

“Kujdestar” është një bankë e licencuar, e nivelit të dytë, e caktuar nga shoqëria administruese, e cila, në bazë të një marrëveshjeje me shoqërinë administruese dhe me porosi të saj, kryen veprimtarinë si kujdestar në mënyrën e parashikuar nga Ligji nr.9879, datë 21.2.2008 “Për titujt”.

“Depozitar” është një bankë e licencuar, e nivelit të dytë, e caktuar nga shoqëria administruese, e cila, në bazë të një marrëveshjeje me shoqërinë administruese dhe me porosi të saj, kryen veprimtarinë si depozitar në mënyrën e parashikuar nga Ligji nr.10 198, datë 10.12.2009. Për qëllime të këtij ligji, depozitari ka të njëjtin kuptim me kujdestarin e përcaktuar në ligjin nr.9879, datë 21.2.2008 “Për titujt”.

“Fond pensioni vullnetar” është një grup asetesh në pronësi të anëtarëve të fondit të pensionit e parashikuar nga Ligji Nr. 10 197, datë 10.12.2009 “Për fondet e pensionit vullnetar”.